

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 82-të i botimit
Nr. 01



PARTNERITET STRATEGJIK

Historike, Shqipëria dhe Kosova vendosin
gur-themelin e një strategjie të përbashkët

Përmbajtja

numri 01

BASHKËPUNIMI

- 12** Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane dhe nevoja për ri-dimensionimin e tyre

ARSIMIMI

- 20** "Masteri Shkencor" në AFA, Arritje e spikatur shkencore...

SIGURIA

- 42** Politikat e sigurisë së tre shteteve kryesore të BE-së

HISTORI

- 47** Tafil Buzi në panteonin e shqiptarizmit

STAFI

Kryeredaktor:
Albert HITOALIAJ

Gazetarë:
Alba MUSARAJ
Leonard QUKU
Ermal KAÇANIKU

Redaktore korrektore:
Elona Shimaj MAKO

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Shtypur në shtypshkronjën:
"Kristalina KH"



4 QYTETI I LIDHJES

Takimi i Prizrenit, jehonë nga e shkuara, premtim për të ardhmen

Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kanë zhvilluar në Prizren një mbledhje të përbashkët...



6 DIREKTIVA 2014

Prezantohen prioritetet e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, prezantoi në datën 7 janar 2014, Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2014...



8 KRONIKA

Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, takon gjeneralbrigade Michael Cunniff

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datë 8 janar 2014, priti në një takim komandantin e Gardës së New Jersey



30 SPECIALE

Arsimimi i ushtarakëve shqiptarë në perëndim, '13-'44

Arsimimi i oficerëve në shtetin e ri shqiptar, me orientim përëndimor

PRIZREN 2014

Dokumenti strategjik

Në mbledhjen e parë të përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, u vendos guri historik i themelimit të një strategjie politikash shtetërore të përbashkëta. Janë shqyrtuar:

1. Dokumenti për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë
2. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në Lehtësimin e Tregtisë;
3. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim në fushat e Transportit dhe Infrastrukturës
4. Propozimi për Bashkëfinancim të pajisjeve mjekësore të Maternitetit të Preshevës;
5. Propozimi për përfaqësimin e përbashkët konsullor midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë;
6. Marrëveshja për Bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë;
7. Marrëveshja për Bashkëpunim në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të energjisë;
8. Themelimi i iniciativës për Fondin Zhvillimor për Luginën e Preshevës;
9. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e kulturës dhe aktivitetet për ndërtimin e kalendarit të përbashkët kulturor
10. Propozimi për bashkëfinancimin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit DOKUFEST në Prizren;
11. Propozimi për heqjen e taksës së TVSH-së apo taksës tjetër doganore për importin e librit nga Shqipëria
12. Dorëzimi i legjislacionit të BE-së të përkthyer në gjuhën Shqipe nga Ministria e Integritimit Evropian e Republikës së Shqipërisë te Ministria e Integritimit Evropian e Republikës së Kosovës;
13. Themelimi i Komisionit të Përbashkët Teknik për përkthimin e legjislacionit të BE-së, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafritimit të legjislacionit ndërmjet Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Integritimit Evropian të Republikës së Kosovës.



Takimi i Prizrenit, jehonë nga e shkuara, premtim për të ardhmen

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë kanë zhvilluar në Prizren në datën 11 janar 2014, një mbledhje të përbashkët, ku janë diskutuar tema të rëndësishme, me synim thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror mes dy vendeve. Mbledhja është hapur me fjalimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe atë të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Edi Rama. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi në fjalën e tij në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë theksoi se “qëllimi i këtij takimi mes dy qeverive, dhe i atyre të ardhshme, ka për të qenë pikërisht përshpejtimi apo përmirësimi i zbatimit të marrëveshjeve të mëhershme dhe njëherazi zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit bilateral nëpërmjet hartimit të marrëveshjeve të reja”. Z.Thaçi potencoi se “adoptimi i praktikës së mbledhjeve të përbashkëta nga dy qeveritë, nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Shqipërisë është relativisht e vonuar, duke pasur parasysh se sa shumë herë janë organizuar këto mbledhje të përbashkëta qeveritare në rajon. Për këtë arsye lindë nevoja që mbledhjet ardhshme të përbashkëta duhet të jenë edhe më të ngjeshura e të ngarkuara me punë, për të kompensuar kohën e humbur dhe për të kapur ritmin e vendeve të tjera të rajonit”. Kryeministri Thaçi deklaroi gjithashtu se “nëpërmjet mbledhjes zotohemi jo vetëm që të bëjmë çmos për përmirësimin e marrëdhënieve mes qytetarëve të shteteve respektive, por edhe që të marrim përsipër përgjegjësinë historike për t’u kujdesur për bashkëkombësit që gjenden pakicë në rajon si dhe për të forcuar lidhjet me mbarë diasporën”. Për këtë arsye,



shtoi Z.Thaçi, edhe dy produktet më thelbësore konkrete që dolën nga mbledhja lidhen me shqiptarët e rajonit të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit. Njëra nismë ka të bëjë me miratimin e financimit të kompletimit me pajisje mjekësore të maternitetit të Preshevës, ndërsa tjetra është nisma për krijimin e një fondi zhvillimor për shqiptarët e rajonit të Luginës së Preshevës. Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, në fjalimin e tij para dy kabineteve qeveritare u shpreh se “ajo që kishte bërë bashkë sot, në një tryezë të bashkëqeverisjes strategjike, Qeverinë e Shqipërisë dhe Qeverinë e Kosovës, ishte një nismë që ka të bëjë pikë së pari, me kontributin tonë për integrimin shqiptar dhe rajonal në Evropën e bashkuar, si shprehje e vendosmërisë sonë të përbashkuar për ta jetësuar këtë integrim si hapësire evropiane të tej-kufijve”. Z.Rama e quajti këtë nismë si “pikënisje të një rrugëtimi të përbashkët institucional, drejt zhvillimit të vendeve tona; forcimit të ekonomive tona; modernizimit të shteteve tona; transformimit të arsimit shqipfolës; pasurimit të jetës sonë kulturore; ripërtëritjes së vazhdueshme të shoqërive tona dhe shtimit dhe fuqizimit të ndërlidhjeve mes tyre”. Më tej Kryeministri Edi Rama tha se dëshiron të ketë mbled-

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Kosovë

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, me ftesë të ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) z. Agim Çeku zhvilloi në datën 10 janar një vizitë zyrtare në Prishtinë. Ministrja Kodheli fillimisht është prituri në një takim të veçantë nga homologu i saj, z. Agim Çeku. Ministri Çeku, pasi i uroi mirëseardhjen në Prishtinë znj. Kodheli dhe delegacionit që ajo kryeson, vlerësoi lart punën e saj në krye të ministrisë së Mbrojtjes. Nga ana e saj ministrja Kodheli falënderoi z. Çeku për pritjen e ngrohtë që i rezervoi, duke nënvizuar se bashkëpunimi mes dy vendeve tona do të intensifikohet akoma më tej dhe oguri më i mirë është mbledhja e përbashkët e dy qeverive. Në fund të këtij takimi, dy ministrat dhanë një konferencë për shtyp, ku u ndalën tek bashkëpunimi bilateral, rajonal dhe më gjerë. Më pas, agjenda e vizitës së ministres së Mbrojtjes të Shqipërisë në Prishtinë ka vijuar me takimin me kreun e Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi. Të dy zyrtarët e lartë diskutuan për çështje të rëndësishme mes dy vendeve tona, duke e vënë theksin tek rëndësia që ka unifikimi i terminologjisë mes nesh. Në vijim, znj. Kodheli është prituri nga presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga. Presidentja e Kosovës e falënderoi znj. Kodheli për angazhimin e saj për të intensifikuar marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve. Znj. Jahjaga e ftoi ministren Kodheli që të bëjë gjithçka është e mundur për të shtuar prezencën e femrës në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Nga ana e saj, znj. Kodheli thek-



soi se mbetet e vendosur që përfaqësimin femëror ta çojë deri në nivelet më të larta drejtuese të FA. Gjithashtu ajo shprehu gatishmërinë e qeverisë së Shqipërisë për të ndihmuar në përfshirjen e Kosovës në iniciativat rajonale dhe ato ndërkombëtare të sigurisë, si dhe për shkëmbim të përvojave në procesin e integritit të Kosovës në NATO. Një takim të veçantë për ministren e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli, ka rezervuar kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi. Ministria Kodheli garanoi kryeministrin Thaçi për mbështetjen e padiskutueshme të qeverisë shqiptare në të gjitha nismat e qeverisë dhe shtetit të Kosovës. Në këtë kuadër, kryeministri i Kosovës, z. Thaçi tha se mbledhja mes dy qeverive është një hap i madh përpara, i cili nuk do të mund të ndalet nga askush në të ardhmen. Në të gjitha këto takime të rëndësishme spikati fryma e ngrohtë dhe vëllazërore e bashkëpunimit midis dy vendeve tona. Po në datën 10 janar, ministria Kodheli zhvilloi një vizitë në komandën e KFOR.

hje të përbashkëta edhe me qeveri të tjera, vende të tjera, partnere strategjike ose partnere të çmuara në rrugën tonë drejt demokratizimit, modernizimit dhe integritit tonë rajonal e evropian. Mirëpo sipas z. Rama: "do të ishte mungesë e madhe sinjeriteti që ta fshihja se mbledhja me qeverinë e Kosovës është një eksperiencë unikalë, e replikueshme në formë, por jo në thelb. Sepse gjuha jonë është një, ëndrra jonë është një, qëllimi ynë i përbashkët është vetëm një"- theksoi Kryeministri Rama.

Pas mbledhjes, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u bë nënshkrimi zyrtar i Dokumenti për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve tjera të arritura mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Kryeministri Hashim Thaçi dhe Kryeministri Edi Rama, pas ceremonisë së nënshkrimit, mbajtën një konferencë të përbashkët, ku iu përgjigjën interesimit të medias për punimet e mbledhjes, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e kabineteve qeveritare të dy vendeve, si dhe për nismat e ndërmarrja për konsolidimin e marrëdhënieve bilaterale. Kryeministri Hashim Thaçi para gazetarëve vuri në

dukje rëndësinë e çuarjes përpara të bashkëpunimit ndërshtetëror mes Kosovës dhe Shqipërisë, sidomos në sektorët strategjik, si ai ekonomik dhe energjetik, për të cilin z. Thaçi theksoi se ka një potencial të madh partneriteti dhe një nevojë të madh për integrim. Po ashtu, kryeministri Thaçi vuri në dukje se integrimi duhet të shtrihet gradualisht në të gjitha sferat e tjera të jetës dhe se ky thellimi bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kosovës i shërben edhe rritjes së stabilitetit dhe frymës së fqinjësisë së mirë në rajon. Kryeministri Edi Rama në deklarinim të tij para medias theksoi se është shumë e rëndësishme që nëpërmjet mbledhjeve të përbashkëta dy shtetet të sinkronizojnë burimet natyrore, të cilat i konsideron thelbësore për zhvillimin e dy vendeve. Po ashtu z. Rama u ndal të radhiste zhvillime të rëndësishme në kuadër të thellimit të bashkëpunimit mes dy vendeve, sikurse janë koordinimi për sa i përket përkujdesjes ndaj bashkëkombësve, e ku hapi i parë i hedhur është ai në lidhje me mbështetjen e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Gjithashtu forcimi i bashkëpunimit lidhur me shërbimet konsullore, duke nisur me krijimin e dy konsullatave dhe duke ndërmarrë veprime të tjera që do të synojnë racionalizimin dhe optimalizimin e përdorimit të burimeve të kufizuara, që të dy vendet kanë në fushën e diplomacisë.

Prezantohen prioritetet e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, prezantoi në datën 7 janar 2014, Direktivën e Mbrojtjes për vitin 2014. Në këtë prezantim ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, deputetë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, komandantët e Forcave, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Më poshtë, prezantimi i Direktivës së Mbrojtjes për vitin 2014 nga ministrja e Mbrojtjes Kodheli



Pas bilancit të 100 ditëve të qeverisjes së re, jam sot këtu për të prezantuar prioritetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura për vitin 2014.

Përpara se të kaloj tek prioritetet, dëshiroj të shpreh, që në krye të herës se, misioni i Forcave të Armatosura për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale, mbështetjen e popullsisë në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënien e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë mbetet një mision i shenjtë. Ky mision do të vijojë të realizohet duke harmonizuar të gjitha planet dhe përpjekjet me Aleancën e NATO dhe me institucionet e tjera të sigurisë së shtetit.

Në funksion të përmbushjes së këtij misioni, programi i ri i qeverisë në fushën e Mbrojtjes, përmban objektiva ambiciozë të cilat kërkojnë vijimin e reformave dhe transformimin e mëtejshëm të Forcave tona të Armatosura, krijimin e kapaciteteve të nevojshme ushtarake për përballimin e sfidave të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe vendosjen e tyre në lartësinë që meritojnë në shoqërinë shqiptare.

Si asnjëherë më parë, në qendër të këtyre reformave do të jetë lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën

e personelit, legjislacionit, promovimit në karrierë, rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

Viti 2013 shënoi një serë arritjesh në drejtim të integritetit të plotë të FA në strukturat ushtarake të NATO, pjesëmarrjes në operacionet e drejtuara nga NATO dhe BE, zgjerimit të gamës së trajnimit dhe stërvitjes, si edhe demontimit të municioneve të tepërta. Por, me gjithë rezultatet e arritura, konstatoj mosrealizime të cilat lidhen me: zhvillimin e kapaciteteve të plota operacionale; dokumentet kryesore strategjike të Sigurisë dhe Mbrojtjes; keqad-ministrim të burimeve të Mbrojtjes, të cilat kanë rezultuar në një situatë të rënduar financiare; mosinvestime e keqmbajtje të sistemeve dhe pajisjeve të mbrojtjes, si dhe problematika në procesin e vlerësimit dhe promovimit në karrierë e gradë të personelit ushtarak.

Objektivat dhe prioritetet kryesore për vitin 2014, do të jenë:

- 1.** Zbatimi i rekomandimeve të dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.
- 2.** Planifikimi i detajuar për zhvillimin e objektivave të kapaciteteve.

3. Kryerja e reformës ligjore dhe strukturore.
4. Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut.

Drejtimet kryesore të punës për vitin 2014 do të fokusohen:

1. Përfundimi i dokumenteve strategjike në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Gjatë vitit 2014, do të përfundojnë:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare, në hartimin e së cilës MM është pjesë e përpjekjeve ndër-institucionale
- Strategjia Ushtarake;
- Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura.

2. Rishikimi i Strukturës së Forcave të Armatosura, me synim ndërtimin e një strukture organizative sa më efektive, më funksionale, e aftë për të zbatuar detyrat themelore të mbrojtjes së vendit në kuadër të mbrojtjes kolektive dhe mbështetje të popullsisë civile në emergjencat civile.

3. Reforma Ligjore, në themel të së cilës të jetë rishikimi i të gjitha akteve që rregullojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura.

4. Reforma e personelit, e cila, në përputhje me rekomandimet e dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, të mbajë parasysh të gjithë ciklin jetësor të personelit. Prioritet të jetë promovimi i personelit, me kualifikimin dhe eksperiencën e duhur, integritet të plotë, dinjitet dhe përkushtim në kryerjen e detyrave të ngarkuara.

5. Batalioni i Këmbëorisë së Motorizuar do të jetë kapaciteti prioritar i Forcave të Armatosura, si dhe detyrimi ynë kryesor në kuadër të kapaciteteve të kërkuara nga NATO. Zhvillimi i këtij batalioni të konsiderohet parësor nga SHPFA dhe Forca Tokësore, duke u reflektuar në të gjitha planet e ristrukturimit, modernizimit, trajnimit dhe stërvitjes për vitin 2014.

6. Arsimimi, trajnimi, stërvitja dhe vlerësimi. Procesi i arsimimit, trajnimit, stërvitjes dhe vlerësimit të konsolidohet më tej, në përputhje me standardet më të përparuara të NATO.

- Sistemi i arsimor duhet t'i nënshtrohet një transformimi të thellë, ku prioritet të mbetet përgatitja e ushtarit profesionist, nënoficerit, kadetëve dhe oficerit të trupës dhe shtabeve për të gjitha nivelet.

- Trajnimi individual, kolektiv dhe stërvitjet duhet të planëzohet në të gjithë strukturën e Forcave të Armatosura duke përfshirë nivelin taktik deri në nivelet më të larta politike e strategjike.

7. Pjesëmarrja në operacione. Forcat tona të Armatosura mbeten tërësisht të angazhuar të kontribuojnë në përfundimin e operacionit ISAF, Afganistan, sipas motos që tashmë është deklaruar: "together in, together out". (të gjithë hymë në operacion së bashku, të gjithë përfundojmë dhe largohemi nga operacioni së bashku). Gjatë vitit 2014, FA të planifikojnë pjesëmarrjen në operacionin e ardhshëm "Resolute Support" në përputhje me direktivën e NATO, si dhe KFOR në Kosovë dhe ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë. Nuk mund të lë pa përmendur këtu zhvillimin e mëtejshëm të politikave të personelit për përzgjedhjen dhe dërgimin e tyre në operacione jashtë vendit. Dëshiroj të bëj të qartë për këdo, se këto kontingjente do të mbeten pjesa më vitale e shoqërisë dhe Forcave tona të Armatosura. Në vijën e parë të luftimit, apo në shtabe të ndryshme, të gjithë ata, ushtarë, nënoficerë apo oficerë, përfaqësojnë Shqipërinë dhe Forcat tona të Armatosura. Ndaj këtë detyrë duhet ta kryejnë me dinjitetin që u takon për të lartësuar në këtë mënyrë emrin e Shqipërisë dhe FA. Me këtë rast, shpreh mirënjohjen time më të thellë ndaj të gjithë atyre që shërbejnë, së bashku me aleatët

tanë, në misionet tona jashtë vendit, në ruajtje të paqes dhe sigurisë. Në të njëjtën kohë, mbetem tërësisht e vendosur, në zbatimin me rigorozitet të lartë të politikave më të mira, që kanë të bëjnë me përzgjedhjen e tyre, trajnimin dhe plotësimin e të gjitha kushteve për realizimin e misionit që u ngarkohet.

8. Mbështetja logjistike e mjekësore. Strukturat e mbështetjes logjistike dhe mjekësore të rrisin rolin e tyre për krijimin e kushteve më optimale të mundshme për realizimin e misionit të Forcave të Armatosura.

9. Modernizimi dhe infrastruktura.

- Modernizimi: Në kushtet e kufizimeve financiare, është e nevojshme finalizimi i të gjitha kontratave ekzistuese, duke bërë rregullimet e duhura në përputhje me kuadrin ligjor. Një vend të veçantë të zënë projektet e financuara nga NATO apo nga donatorë të tjerë. Në këtë kuadër prioritet mbetet zbatimimi i projektit NATINADS (Projekti për Integrimin e Mbrojtjes Ajrore Kombëtare me atë të NATO).

- Infrastruktura të përmirësohet duke u përqendruar investimet në krijimin e kushteve sa më optimale për realizimin e misionit të kërkuar, si dhe për jetesën e personelit të Forcave të Armatosura.

10. Demontimi i municioneve të tepërta do të vijojë edhe gjatë vitit 2014. Forcimi i masave të sigurisë në këtë proces duhet të jetë parësor për të shmangur aksidente apo ngjarje të jashtëzakonshme. Evadimi i materialeve dhe pajisjeve të tepërta do të jetë prioritet i njëjtit përkatëse të Forcave të Armatosura.

11. Menaxhimi i Burimeve Financiare. Transparenca në menaxhimin e burimeve financiare do të jetë e plotë. Në kushtet e buxhetit të kufizuar ky menaxhim merr një rendësi më të veçantë.

12. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e Mbrojtjes:

- Bashkëpunimi me NATO të përqendrohet në realizimin e objektivave të kapaciteteve, harmonizimin e mëtejshëm të procesit të planifikimit të Mbrojtjes së NATO me atë kombëtar.

- Bashkëpunimi me BE të përqendrohet në realizimin e kërkesave që rrjedhin nga procesi i integritetit të vendit në BE.

- Bashkëpunimi me OSBE të përqendrohet në realizimin e marrëveshjeve për eliminimin e kimikateve të tepërta, hotspotëve, si dhe armëve të vogla dhe të lehta.

- Bashkëpunimi rajonal, kryesimi nga vendi ynë i Iniciativës së A-5, të synojë rritjen e rolit të Shqipërisë në rajon, përmes zhvillimit të projekteve të përbashkëta, në kuadër të kësaj iniciativave dhe të iniciativave të tjera të rëndësishme rajonale.

- Bashkëpunimi dypalësh të ketë në fokus mbështetjen e Forcave të Armatosura në arritjen e objektivave të kapaciteteve.

Si ministre e Mbrojtjes, kërkoj nga Shtabi i Përgjithshëm, komandantët e Forcave dhe njëjtit, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA të detajojnë plane dhe programe veprimi në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga kjo direktivë, si dhe të marrin masa për realizimin në kohë të tyre. Inkurajoj dhe mbështes të gjithë personelin ushtarak dhe civil të FA, në përmirësimin e prioritetëve dhe objektivave të vitit 2014. Kërkoj nga të gjithë ju, të punoni me përkushtim për realizimin e kësaj direktive, për të ngritur në një shkallë më të lartë dinjitetin e Forcave tona të Armatosura, duke e renditur ato në lartësinë që e kërkojnë interesat e vendit. Sfidat janë të mëdha, i tillë duhet të jetë edhe angazhimi ynë i përbashkët për t'i përballuar ato me sukses.

Burimi: mod.gov.al

Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli, takon gjeneralbrigade Michael Cunniff

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datë 8 janar 2014, priti në një takim komandantin e Gardës së New Jersey, gjeneral brigade Michael Cunniff. Pasi i uroi mirëseardhjen z. Cunniff, ministrja Kodheli e falënderoi gjeneralin në emër të qeverisë shqiptare dhe në veçanti të Ministrisë së Mbrojtjes për kontributin e dhënë për Forcat tona të Armatosura. Znj. Kodheli tha se bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të New Jersey është shumë i rëndësishëm për FA dhe përgatitjen e oficerëve tanë. "Me arritjen e marrëveshjes së fundit me Gardën Kombëtare të New Jersey, u konkretizua edhe bashkëpunimi në kuadër të State Partnership, një program shumë i rëndësishëm për ne, por edhe për palën amerikane jo vetëm si i pari i këtij lloji, por edhe për faktin se ky program krijon një model të ri bashkëpunimi, i cili padyshim do ketë efekte pozitive në tërë ecurinë e modernizimit dhe arritjes së standardeve bashkëkohore për Forcat tona të Armatosura", u shpreh znj. Kodheli. Gjeneral Cunniff nga ana e tij, garantoj ministren për vazhdimin e programit të edukimit dhe rëndësisë që ka ai për FA. I pranishëm në këtë takim ishte edhe ambasadori amerikan z. Aleksandër Arvizu. Ky i fundit, vlerësoi punën e ministres

Kodheli në krye të Ministrisë së Mbrojtjes, duke u ndalur tek lufta kundër korrupsionit, profesionalizimi në drejtimin e FA, bashkëpunimi me Parlamentin dhe të gjithë institucionet. Sipas ambasadorit ky është një shembull i mirë edhe për institucionet e tjera. Ndërsa ministria Kodheli e garantoj ambasadorin Arvizu se ajo vetë dhe qeveria shqiptare ka vullnetin e plotë politik për të bashkëpunuar me të gjithë institucionet në të mirë të qytetarëve shqiptarë. Zonja Kodheli tha se mbetet e vendosur dhe garanton se në Ministrinë e Mbrojtjes "nuk do të përsëritet ajo çfarë ka ndodhur me qeverinë e mëparshme dhe pikërisht për këtë arsye, bashkëpunimi me Komisionin e Sigurisë Kombëtare ka qenë i ngushtë, duke i bërë pjesë të çdo aktiviteti të këtij institucioni". Më pas gjeneral-brigade Cunniff pati një takim edhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo.

Buxheti 2014, ministrja Kodheli flet në Kuvend

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, duke folur në datën 24 dhjetor 2013, në Kuvendin e Shqipërisë për buxhetin e vitit 2014, siguroi se paratë e taksapaguesve shqiptarë do të mirë-menaxhohen. Zonja Kodheli garantoj të gjithë efektivat e Forcave të Ar-





matosura dhe të gjithë qytetarët, që nuk do të lejo-
hen më sjellje të padenja për ushtrinë tonë aleatë
të NATO, siç ka qenë përdorimi i saj në funksion të
fushatës së shkuar elektorale. Ministria e Mbrojtjes
u ndal edhe tek borxhi që ka trashëguar në këtë min-
istri nga paraardhësi i saj, në vlerën 15 milionë dol-
larë, përfshirë këtu deri edhe pagesën e trupave tona
paqeruajtëse në misione të ndryshme ndërkombëtare.
"Projekti i buxhetit të vitit 2014 në MM parashikon
të jetë 14 miliard e 151 milion lekë që përfaqëson 1.2
për qind të PBB. Dhe ky është buxheti më i mirë që
harmonizon drejt interesat e taksapaguesve dhe pri-
oritetet e PS. Është një buxhet i bazuar në mundësitë
reale që gjeneron aktualisht ekonomia jonë. Në kusht-
et e rrënimt të ekonomisë së trashëguar, arritja më
e madhe që ne kemi mbërritur është pastrimi që i
bëmë buxhetit të MM nga fondi i pensioneve dhe ush-
tarakëve. Thuhet se 30% e buxhetit të deritanishëm,
ishte një artific i shtuar qëllimisht për t'i treguar
vendeve aleate që ne po i rrisim shpenzimet për ush-
trinë. Shqipëria ka nevojë të përmbushë në fakt disa
detyrime jetike ndaj aleatëve dhe njëri prej tyre është
se trupat tona duhet të modernizohen, të pajisen me
armatim modern"- tha ndër të tjera në fjalën e saj,
ministria Kodheli.

Kryeministri Rama dhe ministrja Kodheli bashkëbisedojnë me paqeruajtësit në Afganistan

Në prag të festave të fundvitit, kryeministri i ven-
dit, z. Edi Rama dhe ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi
Kodheli, në datë 23 dhjetor 2013, uruan ushtarakët
tanë në Afganistan. Përmes një video konference,
drejtuesit e qeverisë shqiptare dhe shefi i Shtabit
të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo,
shprehën mirënjohjen e tyre për kontributin e madh
që japin trupat tanë në misione të ndryshme nëpër
botë. Në këtë ceremoni ishin gjithashtu të pranishëm
drejtues të FA, prindër, bashkëshorte dhe fëmijë të
ushtarakëve që janë me mision në Afganistan. Kryemi-
nistri, z. Edi Rama duke iu drejtuar trupave tanë

paqeruajtëse në Afganistan, u shpreh: "Është krenari
që ne një vend i vogël, përmes jush, mund të jemi krah
për krah aleatëve dhe partnerëve tanë të mëdhenj dhe
njëkohësisht, është privilegj dhe nder i madh për mua
që ky pozicion më jep mundësinë të komunikoj me ju
dhe t'ju uroj sot nga zemra: gëzuar Krishtlindjet, gë-
zuar Vitin e Ril!". Në vijim ministria Kodheli theksoi se:
"Besoj që kjo është një ditë e shënuar për ju ashtu siç
është edhe për ne, për t'ju transmetuar edhe njëherë
besimin që kemi tek ju dhe mbështetjen që qeveria
shqiptare, z. Edi Rama, ka për ju, për familjet tuaja
dhe për të gjithë Forcat tona të Armatosura. Le të
urojmë që viti 2014 të jetë më i miri i të gjithë kë-
tyre viteve!" Në emër të kontingjentëve që drejtojnë
përsëritet, nënkolonel Ardian Beqaj, përfaqësuesi i
lartë pranë Shtabit të ISAF, Kabul, nënkolonel Leonard
Zhupa, komandanti i kontingjentit MAT, Kabul dhe ma-
jor Pali Dakolli, komandanti i kontingjentit "Eagle -7" në
Kandahar. Në përfundim të këtij bashkëbisedimi mjaft
emocionues, kryeministri Rama dhe ministrja Kodheli
shpërndanë për fëmijët e ushtarakëve paqeruajtës
dhurata të ndryshme për festat e fundvitit.

Turqia i dhuron 3 milionë dollarë ndihma Shqipërisë

Shqipëria ka marrë 3 milionë dollarë ndihma nga Re-
publika e Turqisë. Këto ndihma konsistojnë kryesisht
në mjete motorike ushtarake, një gjenerator dhe pa-
jisje të tjera logjistike për ushtrinë dhe policinë. Të
pranishëm në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast në
Komandën e Forcave Tokësore, në Zall-Herr, në datën
21 dhjetor 2013, ishin: ministrja e Mbrojtjes, znj.
Mimi Kodheli, zëvendësministrja e Brendshme, znj.
Elona Gjerbrea, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA,
gjeneralmajor Jeronim Bazo, ambasadori i Republikës
së Turqisë në Tiranë, z. Hydayet Bayraktar, atasheu
ushtarak i Republikës së Turqisë, kolonel Nizametin
Dogar, gjeneralë, drejtorë drejtorish nga Ministria e
Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm si dhe mjaft të
ftuar të tjerë. Në fjalën e saj ministrja e Mbrojtjes,
znj. Mimi Kodheli, pasi ka falënderuar të pranishmit



në këtë ceremoni u shpreh: "Ne, këtë ndihmë bujare të Republikës së Turqisë do të dimë ta përdorim sa më mirë të jetë e mundur, në funksion të rritjes së kapaciteteve operacionale, modernizimit të ushtrisë sonë dhe padyshim të modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve të Ministrisë së Brendshme, e cila sot përfaqësohet nga zëvendësministria znj. Elona Gjebre." Në përfundim të fjalës së saj, ministria Kodheli ka falënderuar ambasadorin dhe atashëun ushtarak të Turqisë dhe të gjithë ata që kanë bërë të mundur këtë dhuratë për Vitin e Ri ushtrisë shqiptare dhe Forcave të Policisë së Republikës së Shqipërisë. Në përfundim të aktivitetit ambasadori i Republikës së Turqisë, z. Hydayet Bayraktar i ka dhuruar në formë simbolike ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli çelsin e një makine.

Kodheli letër nga zëvendësasistentja e sekretarit të Mbrojtjes së SHBA, Evelyn Farkas

Ministria e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, në datën 20 dhjetor 2013, ka marrë një letër falënderimi nga zëvendës-asistentja e sekretarit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Evelyn Farkas. Kjo letër është shoqëruar edhe nga një telefonatë e para pak ditëve. Znj. Farkas e falënderon ministren Kodheli për punën që po bën në krye të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura. "Më lejoni t'Ju shpreh edhe një herë vlerësimin tim për përkushtimin Tuaj të vendosur përkundrejt objektivave tona reciproke si dhe për dedikimin Tuaj ndaj reformave të rëndësishme në fushën e mbrojtjes", shprehet ndër të tjera znj. Farkas në letrën e saj. Gjatë bisedës telefonike (13 dhjetor), zyrtarja amerikane u ndal veçanërisht në luftën kundër korrupsionit që ministria Kodheli dhe qeveria shqiptare po bëjnë, duke garantuar për mbështetjen e padiskutueshme të SHBA në këtë proces shumë të rëndësishëm për të ardhmen e vendit.

Mbërrin në Shqipëri "COUGAR" i tretë

Pasditën e datës 18 dhjetor 2013, në mjediset e Komandës së Forcave Ajrore në Rinas u zhvillua ceremonia e mbërritjes së helikopterit "COUGAR". Ky helikopter është i treti që i bashkohet Forcës Ajrore dhe është ndërtuar në zbatim të kontratës ndërmjet

Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe kompanisë franceze "Eurocopter", nënshkruar më 17 dhjetor të vitit 2009. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm: ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura. E pranishme ishte gjithashtu edhe ambasadorja e Republikës së Francës në Shqipëri, znj. Christine Moro si dhe përfaqësues të kompanisë "Eurocopter". Të pranishmit në ceremoni i përshëndeti edhe ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e cila, ndër të tjera, e cilësoi këtë ngjarje tepër të veçantë për të gjithë Forcat e Armatosura. "Pajisja e Forcave të Armatosura me helikopterët "COUGAR", mundëson që Forca Ajrore të rrisë kapacitetet e saj operacionale, e parë kjo edhe në raport me objektivat e kapaciteteve që kjo Forcë duhet të zhvillojë në kuadrin e gjithë objektivave dhe kapaciteteve që Forcat tona të Armatosura duhet të përmbushin si detyrim ndaj Aleancës", theksoi ministria Kodheli. Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, theksoi gjithashtu se, në arritjen e standardeve të Aleancës kemi pasur mbështetjen e aleatëve dhe miqve tanë, ku do të veçoja atë të përfaqësuesve dhe trajnuesve të vendeve mike si Franca dhe Britania e Madhe.

Ministria e Mbrojtjes, znj. Kodheli vizitë zyrtare në Itali

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datën 17 dhjetor 2013, ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Itali, me ftesë të homologut të saj, z. Mario Mauro. Gjatë takimit, ministri italian i Mbrojtjes, z. Mario Mauro e uroi ministren Kodheli për detyrën, si ministre e Mbrojtjes së Shqipërisë dhe u ndal sidomos në bashkëpunimin mes dy vendeve tona. Ministria Kodheli i kërkoi homologut të saj mbështetjen e Italisë për statusin e vendit kandidat të Shqipërisë. Një tjetër temë e bisedës ishte edhe forcimi i bashkëpunimit mes dy qeverive tona në fushën ekonomike, sidomos në ata sektorë me interes të përbashkët. Duke u ndalur tek bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes, znj. Kodheli kërkoi nga Italia asistencë për ruajtjen e hapësirës ajrore. Një tjetër temë diskutimi ishte edhe mbështetja që Shqipëria kërkon nga Italia për batalionin e motorizuar dhe për ruajtjen e hapësirës detare. Të dy zyrtarët ishin të njëjtit mendim lidhur me forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm në këtë fushë të rëndësishme.

Ministria Kodheli priti ambasadorin e Republikës së Maqedonisë

Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datën 6 dhjetor 2013, priti në një takim ambasadorin e Republikës së Maqedonisë në Shqipëri, z. Stojan Karajanov. Ministria Kodheli e falënderoi ambasadorin maqedonas për vizitën dhe shtoi se detyra e tij është e rëndësishme në një vend mik si Shqipëria. Znj. Kodheli e garantoi diplomatin maqedonas për vendosmërinë e qeverisë shqiptare për ta mbështetur Maqedoninë në proceset e saj integruese, që në momentin e parë kur të ketë një zhvillim politik të situatës atje. Më pas,

ministrja e Mbrojtjes Kodheli u ndal edhe tek situata e shqiptarëve të Maqedonisë. "Kam kërkuar dhe vazhdoj të kërkoj që të punohet më fort që shqiptarët e Maqedonisë të përfshihen drejt një shkollimi më të madh. Shqiptarët duhet të jenë pjesë e lokomotivës që shtyn trenin e Maqedonisë drejt BE dhe NATO", - u shpreh ministrja Kodheli. Ambasadori Karajanov e falënderoi ministren Kodheli për mikpritjen e ngrohtë dhe tha se ekzistojnë hapësirat për të rritur bashkëpunimin mes dy vendeve tona. Z. Karajanov u ndal edhe tek situata e shqiptarëve të Maqedonisë, duke nënvizuar se, çështja e tyre është e rregulluar me kushtetutë dhe ligj, por ka ende hapësira për të punuar. Ai u shpreh se vizita e kryeministrit Rama në Maqedoni dhe një numër tjetër jo i vogël vizitash dhe takimesh të tjera të planifikuara për t'u zhvilluar brenda vitit nga kabineti qeveritar, dëshmojnë për vullnetin e dy qeverive për të bashkëpunuar.

QKMBM, koncert artistik për fëmijët dhe familjet e ushtarakëve

Me rastin e festave të Vitit të Ri dhe në zbatim të kalendarit vjetor për vitin 2013, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes organizoi në datën 28 dhjetor 2013, një aktivitet artistik me temë "Programi i Vitit të Ri 2014", me fëmijët dhe familjet e ushtarakëve të Forcave të Armatosura. Në këtë aktivitet festiv ishin të pranishëm: zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Dritan Hila, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneral brigade Pirro Ahmetaj, kryetari i Komitetit Olimpik Shqiptar, z. Viron Bezhani, ushtarakë të lartë nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, fëmijë dhe familjarë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Aktiviteti festiv u zhvillua në formën e një spektakli artistik, ku u përfshinë një seri elementësh artistikë të interpretuara me nivel e mjeshtëri të lartë nga grupi i fëmijëve që trajnohen në kurse të ndryshme pranë Qendrës Rekreative dhe Sporteve të QKMBM. Në fund të këtij aktiviteti artistik, u ndanë dhuratat e Vitit të Ri. Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Dritan Hila, i dhuroi pakon e Vitit të Ri vogëlushes Egi Vogli, vajzës së Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, si dhe uroi për festat e fundvitit të gjithë fëmijët e ushtarakëve pjesëmarrës në këtë aktivitet. Dhuratat për fëmijët e ushtarakëve që trajnohen pranë QKMBM u mundësuan nga Ndërmarrja Ushtarake e Eksport-Importit, MEICO.

SHSHPFA, priti komandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo priti në një takim të veçantë, në datën 8 janar 2014, komandantin e Gardës Kombëtare të New Jersey, gjeneral brigade Michael Cunniff dhe ekipin që e shoqëronte. Gjeneral Cunniff gjatë vizitës së tij në Ministrinë e Mbrojtjes shoqërohej dhe nga atasheu amerikan dhe shefi i zyrës së ODS në MM. Gjeneralmajor Jeronim Bazo, pasi i uroi mirëseardhjen, e falënderoi gjeneral brigade Michael Cunniff për konfirmimin nga SHBA të mbështetjes politike dhe institucionale për qeverinë dhe popullin shqiptar, për vazhdimin e reformave, e veçanërisht në forcimin e institucioneve demokratike, duke transmetuar në

mënyrë të vazhdueshme mesazhin se rrugët e komunikimit janë të gjitha të hapura.

Ndërrohet atasheu ushtarak i Republikës Popullore të Kinës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 7 janar 2014, ka pritur në një takim kortezie me rastin e përfundimit të detyrës atasheun ushtarak kinez, kolonel i parë Fang Hua, si dhe kolonel i parë Luo Tiefeng, i sapo akredituar në vendin tonë. SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka vlerësuar nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, si dhe është shprehur se Shqipëria vlerëson reformat në fushën politike dhe ekonomike të Republikës Popullore të Kinës gjatë këtyre dy dekadave të fundit, sidomos bashkëpunimin që Kina ka bërë me komunitetin ndërkom-bëtar në luftën kundër terrorizmit.

SHSHPFA takohet me ambasadoren e Francës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 17 dhjetor 2013 ka pritur në një takim kortezie ambasadoren e Francës, znj. Christine Moro. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan reformat në fushën e mbrojtjes në FA të RSH, sidomos për përm-bushjen e objektivave të NATO. Ndër aspektet më të rëndësishme të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve gjeneral Bazo është ndalur në modernizimin i Forcës Ajrore me helikopterët Cougar, arsimimit kryesisht me kurset në gjuhën frënge në Qendrën e Gjuhëve të Huaja, si dhe kurset e ndryshme të ofruara nga pala franceze dhe trajnimi në drejtim të kontingjenteve të pilotëve dhe teknikëve të helikopterëve Cougar.

Gjeneral Bazo, takim me atasheun ushtarak francez, kolonel Henri Sowa

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 11 dhjetor 2013, ka pritur në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Francës, kolonel Henri Sowa. SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka vlerësuar maksimalisht nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e mbrojtjes, sidomos në drejtim të arsimimit, trajnimit dhe këshillimit të pilotëve dhe teknikëve të helikopterëve COUGAR, etj. Të dy bashkëbiseduesit vlerësuan gjithashtu prezencën e specialistit francez pranë Komandës së Forcës Ajrore, i cili realizon në mënyrë tepër profesionale konsulencën për trajnimin e pilotëve dhe mirëmbajtjen e helikopterëve COUGAR

Vizitë kortezie e Ambasadorit të SHBA-së, z. Arvizu

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datë 10 dhjetor 2013, ka pritur në një takim kortezie ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të akredituar në vendin tonë, z. Aleksandër Arvizu. Ambasadori i SHBA, z. Aleksandër Arvizu ka uruar gjeneral Bazon, me rastin e marrjes së detyrës së lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të RSH. Gjeneral Bazo ka falënderuar ambasadorin Arvizu dhe qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetjen që kanë dhënë për Forcat e Armatosura Shqiptare.

BASHKËPUNIMI

Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane dhe nevoja për ri-dimensionimin e tyre

Duke qenë se SHBA, në momentet kyç të ndryshimeve të ndodhura në Shqipëri, kanë mbështetur integrimin shqiptar në familjen Euro-Atlantike, është e rëndësishme që të mendojmë për një ridimensionim të marrëdhënieve dypalëshe



KAP. RANG II
EVEREST HAXHI

Procesi i konsolidimit të marrëdhënieve Shqipëri - Shtetet e Bashkuara duket se ka marrë një ri-vitalizim kohët e fundit edhe pse situata politike dhe ri-formatimi i institucioneve nuk ofrojnë kapacitete të plota mbështetjeje me përjashtim të dëshirës dhe mendimit. Mundësia e mohuar e demontimit të arsenalit kimik të Asad duket se ka krijuar një luhatje fragmentare dhe kjo vetëm në perceptimin e shoqërisë dhe paqartësinë e saj për konsolidimin e një marrëdhënie solide institucionale me partnerin

tonë strategjik. Duke qenë se Shtetet e Bashkuara kanë vlerësuar maksimalisht pro-amerikanizmin proverbial të shqiptarëve dhe në momentet kyç të ndryshimeve madhore të ndodhura në Shqipërinë post-komuniste kanë mbështetur integrimin shqiptar në familjen Euro-Atlantike, është e rëndësishme të mendojmë për një dimensionim të ri të marrëdhënieve midis dy vendeve. Situata gjeopolitike aktuale ofron premisat që dimensionimi i ri i marrëdhënieve SHBA-Shqipëri të ofrojë një "update" të mbështetjes tradicionale, deri tani të ofruar,

me qëllim që së pari të jetë koherent me realitetin shqiptar dhe evoluimin e nivelit të emancipimit të elitës intelektuale shqiptare dhe së dyti të marrë në konsideratë faktorin shqiptar në rajon.

Marrëdhëniet midis dy vendeve dhe ri-dimensionimi i tyre kanë handikapi në situatës ekonomike jo të favorshme duke ditur se SHBA dhe Bashkimi Europian po përballen me një nga krizat e forta ekonomike pasojat gjeopolitike të së cilave nuk mund të anashkalohen. Për këtë arsye duket se është e rëndësishme të gjykohet se si duhet të ri-dimensionohen këto marrëdhënie dhe të konsolidohen më tepër në përfitim jo vetëm të trevave shqipfolëse në Ballkan, por edhe në përfitim të vendeve të tjera të cilat do të kenë benefite nga stabilizimi i faktorit shqiptar në rajon. Situata gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor ka ndryshuar ndjeshëm dhe reformat e ndërmarra kulmuan me anëtarësimin e Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO me tendencën që Bosnja gjithashtu t'i bashkohet Planit të Vepërimit të Anëtarësimit në një të ardhme jo shumë të largët. Kroacia u bë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian, Mali i Zi mund t'i bashkëngjitet shumë shpejt procesit të aderimit dhe Kosova me pavarësinë dhe monitorimin e Forcave të Sigurisë dhe kalimit në një Forcë Konvencionale të Armatosur do ta bëjë atë më pranë procesit të integritimit në strukturat Euro-Atlantike. Ballkani, edhe pse me aspirata pro-perëndimore dhe "input" për të merituar mbështetjen Euro-Atlantike ka tendenca t'i afrohet një skenari jo shumë të qartë. Greqia, si vend i NATO-s dhe Bashkimit Europian, pavarësisht mundësive mbështetëse që gjenerojnë këto organizma, vazhdon të ecë drejt një kolapsi ekonomik dhe shoqëror. Kriza e saj ekonomike, e projektuar jo vetëm në rajon por sipas efektit domino është projektuar edhe në vende të tjera të Bashkimit Europian, mund të prodhojë shumë shpejt ndërlikime gjeopolitike kryesisht për Ballkanin Perëndimor. Edhe pse në krizë ekonomike aspiratat e Maqedonisë për në BE dhe NATO mbeten të bllokuara nga Greqia. Nga ana e vet Maqedonia është e pa qartë nëse politikat nacionaliste me të cilat kërkon të përballlet me problemin janë vërtet frytdhënëse, apo kërkojnë

të ri-formatojnë një identitet kombëtar të vetin, gjë e cila i ka munguar që në themelimin e FYROM në fillim të viteve 1990. Sjelljet e elitës politike në Serbi gjenerojnë shqetësime mbi orientimin e saj gjeopolitik jo vetëm në rrafshin rajonal por edhe në ofrimin e një platforme mbështetëse solide në rrafshin ndër-atlantik. Evropa dhe Shtetet e Bashkuara nuk po ringjallin një imazh të ambicies së përbashkët kjo e kushtëzuar jo vetëm nga problemet ekonomike të së dy vendeve por edhe nga ndryshimi i kursit të SHBA-së e cila ka vendosur prioritete të tjera në rajonet jashtë viseve të Atlantikut të Veriut, kryesisht në Paqësor dhe Azi, kjo e zyrtarizuar me Direktivën e Presidentit Obama 2012. Në këto rrethana duhet t'i jepet një dimension i ri vlerës që marrëdhëniet SHBA-Shqipëri mund t'u japin përpjekjeve që nevojiten për të përforcuar stabilitetin dhe progresin në Ballkanin Perëndimor si dhe për rigjallëruar marrëdhëniet ndër-atlantike. Për t'i shërbyer sa më mirë lidhjes së një marrëdhënie unike mes Shqipërisë dhe SHBA me benefite gjeopolitike rajonale duhet të synohet në rritjen shumë-dimensionale të asistencës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Asistenca dhe rritja e bashkëpunimit midis dy vendeve duhet të përqendrohet kryesisht në:

1. Forcimin e asistencës dhe mbështetjen e reformave në Forcat e Armatosura
2. Forcimin e asistencës dhe mbështetjen në Policinë e Shtetit dhe Agjencitë e Forcimit të Ligjit.
3. Asistencën për ngritjen e kapaciteteve reaguese dhe integrimin rajonal të këtyre kapaciteteve
4. Asistencën në menaxhimin e projekteve madhore energjetike (TAP) në kuadër të sigurisë energjetike dhe implikimeve gjeopolitike që mund të sjellin.

Forcimi i asistencës dhe mbështetja e reformave në Forcat e Armatosura

Forcat e Armatosura shqiptare me asistencën financiare dhe këshillimin e Shteteve të Bashkuara i janë nënshtruar një procesi reformimi dhe modernizimi intensiv. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë qenë gjithnjë ndër të parat që i kanë qëndruar në krah Shteteve të Bashkuara në





operacione të vështira dhe jashtë rajonit, përfshirë Operacionin "Liria e Irakut" dhe "Enduring Freedom" në Afganistan. Sot, në teatrin afgan të luftimeve, ushtarët shqiptarë janë të angazhuar në operacione të forcave speciale, një dëshmi kjo jo vetëm e guximit të tyre, por gjithashtu, edhe e evoluimit të profesionalizmit dhe standardizimit operacional. Jo e pa pritur ka qenë edhe deklarata e ministres së Mbrojtjes Mimi Kodheli në Ministerialin e NATO-s në Bruksel për vazhdimësinë e angazhimit të Shqipërisë në Afghanistan edhe pas vitit 2014, e cila ka treguar edhe njëherë dëshirën për mbështetje të klasës politike shqiptare ndaj partnerit të vet strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mbështetur në gatishmërinë që ka ushtria shqiptare, shprehje kjo e pro-amerikanizmit të mbarë shoqërisë, është e nevojshme që Shtetet e Bashkuara të mos reshtin asistencën ushtarake për Shqipërinë pasi vendi është një kontribuues aktiv në NATO si dhe në operacione të tjera ushtarake ndërkombëtare. Duhet të kemi parasysh faktin që në raport me numrin e popullsisë dhe numrin e Forcave të Armatosura, Shqipëria kontribuon rreth 8% në operacione, shifër kjo e lartë në krahasim me kontributet e vendeve të tjera më të zhvilluara dhe me potencial teknologjik më të lartë. Mbështetja e Forcave të Armatosura duhet të jepet në kontestit gjeopolitik duke pasur parasysh se ato do të shërbejnë jo vetëm si garantuese të sigurisë brenda vendit, por edhe si instrumente të politikës së jashtme duke u ri-dimensionuar në varësi të rolit që duhet të luajnë në rajon dhe rolit strategjik të sigurisë së energjisë. Në këtë kontest për tu përballur me sfidën e sigurisë së energjisë do të ishte e domosdoshme ristrukturimi i Forcave Detare Shqiptare, dhe kjo mund të realizohej me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me qëllim që t'i jepej Forcave Detare një dimension

reagues jo vetëm kombëtar, por edhe rajonal. Zhvillimi i Forcave Detare në funksion të sigurimit të rrugëve dhe investimeve energjetike në një aspekt, dhe ri-dimensionizimi i tyre në funksion të efikasitetit reagues dhe integritetit rajonal duhet të jetë prioritet për Shqipërinë pasi kjo nuk është më çështje dëshire politike por detyrim gjeopolitik për vetë pozicionin gjeografik dhe rolin që i paracakton ky lloj pozicioni Shqipërisë. Një hap i rëndësishëm në thellimin më tej të marrëdhënieve SHBA-Shqipëri në fushën e mbrojtjes, edhe sipas strategjistit amerikan Zbigniew Brzezinski, do të ishte fillimi i programit "exchange officers" ku ushtarake planëzues të Shtabit të Bashkuar Amerikan të Mbrojtjes "Joint Staff" të instaloheshin në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe anasjelltas. Një bërthamë e tillë ushtarake do ndihmonte së pari harmonizimin e proceseve dhe procedurave të planifikimit të përdorura nga institucionet respektive të mbrojtjes dhe së dyti mbajtjen e vazhdueshme të lidhjeve të ngushta ndërmjet dy shtabeve për të garantuar koordinim më të lehtë në kohëra krizash. Përzgjedhja e ushtarakëve për të qenë pjesë e këtij programi do të lehtësohej nga vetë asistencë e pandërprerë amerikane në edukimin ushtarak dhe vazhdimin e financimit të programit të mbështetjes për edukimin dhe trajnimin ushtarak (IMET). Deri tani, në sajë të Programit "IMET" me asistencën e plotë të Shteteve të Bashkuara, janë edukuar në Amerikë një numër i madh oficerësh shqiptarë. Mendohet se ky program të ketë qenë një nga programet më të suksesshme të asistencës që SHBA i ka dhënë dhe po i jep Shqipërisë sidomos në formatimin Perëndimor të elitës ushtarake të ardhshme edhe pse programi IMET ka gjithashtu kontribute të pakontestueshme në formatimin e elitës së ardhshme shqiptare jo vetëm në fushën e Mbrojtjes.

Forcimi i asistencës dhe mbështetjes në Policinë e Shtetit dhe Agjencitë e Forcimit të Ligjit

Duke pasur parasysh dimensionet e reja që po merr mbrojtja dhe ku koncepti konvencional i saj po zëvendësohet ngadalë me konceptin e rrezikut asimetrik, "input" kryesore në sigurinë kombëtare jep Policia e Shtetit. Asistenca e Shteteve të Bashkuara në fushën e mbrojtjes duhet ta bëjë pjesë të paketës së saj asistencën dhe mbështetjen për Policinë e Shtetit dhe Agjencitë e tjera të Forcimit të Ligjit në Shqipëri, kjo e lidhur ngushtë me faktin që objekti i punës së policisë, kryesisht organizatat kriminale, po e humbasin identitetin kombëtar dhe po shfaqen gjithnjë e më tepër transnacionale rajonale dhe ndërkombëtare. Asistenca e Shteteve të Bashkuara dhënë kryesisht në formatimin e paketave ligjore, trajnimin dhe strukturimin ka dhënë frytet e veta por, Policia e Shtetit edhe pse ka bërë hapa cilësorë në reformat dhe ristrukturimin profesional mbetet ende shumë e kontestueshme për vetë natyrën e punës dhe ndjeshmërisë së shoqërisë për këtë shërbim jetik. Një hap i rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve SHBA-Shqipëri dhe njëkohësisht mbështetje për agjencitë e forcimit të ligjit në Shqipëri, do të ishte ardhja në Shqipëri e ekipeve trajnuese amerikane të konceptit "Mobile Teams", por që nuk do të limitoheshin vetëm me trajnimin, por edhe në patrullime të përbashkëta kryesisht në përmirësimin e imazhit të policisë në kontakt me publikun. Lë ende shumë për të dëshiruar për qasja profesionale ndaj qytetarit kjo ende e pa ndihmuar nga veshja policore profesionale dhe mesazhi i pakontestueshëm i ligjit që duhet të përcjellë oficeri i policisë. Asistenca e Shteteve të Bashkuara duhet të konsistojë edhe në mentorimin dhe këshillimin për ristrukturimin e Policisë dhe ndarjen e saj prej disa shërbimeve që janë ende në varësi të Policisë së Shtetit vetëm sepse tradicionalisht kanë qenë aty. Flas për Shërbimin Zjarrfikës, i cili duhet të ristrukturohet në nivel kombëtar dhe të dalë si një shërbim i pavarur.

Asistenca për ngritjen e kapaciteteve reaguese dhe integrimin rajonal të tyre

Një tjetër hap i rëndësishëm, i cili do të konsolidonte marrëdhëniet Shqipëri-SHBA do të ishte lehtësimi i shkëmbimit reciprok të informacionit për problemet e përbashkëta dhe rreziqet prioritare. Do të ishte frutdhënëse të përfitohej nga eksperiencia e Shteteve të Bashkuara për krijimin e një agjencie informacioni ndërinstitucionale e cila do të menaxhonte një bazë të dhënash kombëtare të unifikuar të informacionit duke lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe përdorimit të tij në kohë reale nga agjencitë e forcimit të ligjit dhe mbrojtjes. Unifikimi ndërinstitucional i informacionit do të shërbejë jo vetëm si bazë për unifikimin ndërinstitucional të kapaciteteve reaguese dhe zvogëlimin maksimal të kohës së reagimit, por edhe si bazë për integrimin rajonal të kapaciteteve reaguese. Qendra Ndërinsti-

tucionale Operacionale Detare (QNOD) është shembulli më i mirë i konceptit të unifikimit të informacionit në shërbim të efikasitës së kapaciteteve reaguese ndërinstitucionale dhe një model i mirë i mbështetjes konceptuale të Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Qendra funksionon, edhe pse nevojiten ndryshime ligjore për qartësimin e autoritetit të komandim-kontrollit të kapaciteteve reaguese në funksion të gatishmërisë operacionale të tyre dhe drejtimit të operacioneve. Me të njëjtin koncept dhe duke konsoliduar platformën e vëzhgimit dhe monitorimit të bregdetit me vendosjen në efikasitet të sistemit "Lockheed Martin" në monitorimin e hapësirës detare, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe BE mund të hedhim bazat për krijimin e një qendre rajonale ku të integrohen informacioni dhe komandim-kontrolli mbi kapacitetet reaguese në të mirë të rritjes së sigurisë rajonale dhe asaj kombëtare.

Asistenca në menaxhimin e projekteve madhore energjetike (TAP) në kuadër të sigurisë energjetike dhe implikimeve gjeopolitike që mund të sjellin

Idetë e para për një analizë koherente të marrëdhënieve Shqipëri-SHBA janë kryer nga strategjisti Zbigniew Brzezinski i cili thekson se "...siguria e energjisë duhet të plotësojë mbrojtjen dhe demokracinë si një shtyllë kryesore në marrëdhëniet dypalëshe SHBA-Shqipëri. Këto objektiva shtyllë duhet të përfshijnë nxitjen e investimeve amerikane në Shqipëri dhe garantimin që interesat e sigurisë së Shqipërisë të justifikohen në evoluimin e infrastrukturës energjetike të Ballkanit". Në këtë kontekst, Shqipëria e cila ka depozita domethënëse naftë e gaz në rrafsh rajonal po përjeton një rilindje në këtë industri dhe lajmet e përditshme janë me të vërtetë inkurajuese. Zbulimi në Shpirag i një pusi me kapacitet 1300 fuçi në ditë nga Kompania "Shell-Petromanas" konfirmon epërsinë rajonale në burime hidrokarburesh kjo e rëndësishme për të pasur një bazë për zhvillimin infrastrukturor energjetik dhe ekonominë e vendit. Gjithsesi në kontest të sigurisë së energjisë asistencë e Shteteve të Bashkuara do të ishte shumë e nevojshme pasi Projekti TAP për vetë madhësinë e tij dhe për vetë mungesën e infrastrukturës energjetike lidhëse në rajon mund të sjellë implikime strategjike për Shqipërinë. Ashtu si përmendur edhe më sipër, për tu përballur me sfidën e sigurisë së energjisë do të ishte e domosdoshme ristrukturimi i Forcave Detare Shqiptare, dhe kjo mund të realizohej me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me qëllim që ti jepej Forcave Detare një dimension reagues jo vetëm kombëtar por edhe rajonal. Zhvillimi i Forcave Detare në funksion të sigurimit të rrugëve dhe investimeve energjetike në një aspekt, dhe ri-dimensionalizimi i tyre në funksion të efikasitës reaguese dhe integrimin rajonal, duhet të jetë prioritet për Shqipërinë pasi kjo nuk është më çështje dëshire politike, por detyrim gjeopolitik për vetë pozicionin gjeografik dhe rolin që i paracakton ky lloj pozicioni Shqipërisë.

TRANSFORMIMI

Parimet e stërvitjes ushtarake dhe vlerësimit të stërvitjes



PHD Louis L. Boros

Nevoja për stërvitje individuale dhe institucionale është pranuar që kur ushtritë u organizuan për herë të parë mijëra vite më parë, edhe pse konceptet themelore të stërvitjes ushtarake vazhdojnë të zhvillohen me futjen e kërkesave, teknologjive dhe metodologjive të reja stërvitore. Forma efektive dhe efçiente stërvitore formojnë bazën e gatishmërisë individuale dhe të njësisë, dhe rrjedhimisht suksesin dhe mbijetesën në fushëbetë.

Duke u kërkuar bijve dhe bijave të tij të luftojnë në mbrojtje të tokës mëmë, kombi merr përsipër përgjegjësi për ushtarët e tij. Kombi dhe udhëheqësit ushtarakë duhet t'u sigurojnë bijve dhe bijave të tyre stërvitje shumë të mirë, pajisjet më të mira dhe udhëheqjen më të mirë të mundur.

– Gjeneral Alfred M. Gray,

Ish Komandant, Trupa Amerikane e Marinsave

Stërvitja, pajisja dhe sigurimi i forcave plotësisht të afta është misioni parësor i çdo komandanti njësie në çdo nivel! Matja e saktë dhe reale e statusit të gatishmërisë individuale dhe të njësisë formon bazën e punës së pafundme për të stërvitur, pajisur dhe siguruar forca të gatshme. Të gjitha detyrat e tjera ushtarake vijnë të dytat për nga rëndësia.

Një forcë ushtarake është e organizuar në mënyrë intelektuale, inteligjente, strukturore dhe operacionale. Njësitë ushtarake krijohen gjithmonë për një arsye. Secila ka detyra, funksione dhe objektiva të përkufizuara në mënyrë specifike. Është mendimi analitik inteligjent ai i cili përcakton shtrirjen e përgjegjësive dhe detyrave administrative dhe operacionale të cilat i caktohen dhe kërkohen nga secili ushtar individual (me fjalë të tjera, standardet e sjelljes dhe aftësitë operuese), dhe në mënyrë kolektive (si një njësi e përbërë prej individësh) e çdo njësie ushtarake të veçantë. Ndërtimi intelektual, strukturor dhe operacional i Forcave të Armatosura formon një të tërë kohezive.

Standarde të mirë përcaktuara të performancës formojnë bazën për stërvitjen dhe për matjen e efektivitetit të stërvitjes! Nëse biem dakord me deklaratën e Gjeneral Gray të cituar më sipër, vlerësimi ciklik dhe matja e gatishmërisë individuale dhe të njësisë duhet të jenë të dyja të sakta dhe në kohë. Analizat e stërvitjes, të kryera në mënyrë inteligjente dhe me një proces të plotë, i cili përfshin të gjithë FARSH, përcaktojnë dhe përkufizojnë parimet bazë dhe procedurat e standardizuara të cilat formojnë bazën e operacioneve ushtarake.

Proceset e analizës së stërvitjes nuk janë intuitive dhe nuk duhet të jenë asnjëherë mekanikë. Të gjithë komandantët e njësive kërkojnë trajnim në metodat e analizës së stërvitjes! Komandantët nuk duhet të falsifikojnë rezultatet e analizës së stërvitjes për "ta bërë të duket më mirë nga sa është". Nga ana intelektuale, kjo është një gjë e pandershme, dështon në përmbushjen e përgjegjësive të udhëheqësve dhe mund të çojë në rezultate të rrezikshme. Raportet e pavërteta të gatishmërisë u japin drejtuesve më të lartë një pamje të pasaktë të gatishmërisë së forcës,



dhe më e rëndësishme, mund të çojnë në përdorimin në fushëbetë të ushtarëve të papërgatitur. Pasojat mund të ishin tragjike për ushtarët individualë dhe për Forcat e Armatosura si një e tërë.

Çdo ushtar, çdo njësi ushtarake dhe e gjithë Forca e Armatosur duhet të stërviten përkundrejt standardeve të konsoliduar të performancës. Këto standarde performance duhet të ri-ekzaminohen rregullisht dhe të verifikohen për të siguruar që të gjithë standardet të jenë të përditësuar. Programet e stërvitjes së Forcave të Armatosura duhet të krijohen në mënyrë që çdo ushtar dhe çdo njësi ushtarake të jetë në gjendje të performojë detyrat e caktuara në nivelin e kompetencës më të lartë të mundshëm.

Standardet administrative të Forcave të Armatosura janë përcaktuar në ligje dhe rregullore. Përdorimi operacional (luftarak) i Forcave të Armatosura përcaktohet në doktrina të luftës të cilat përcaktojnë parimet operative dhe objektivat operacionale të Forcave të Armatosura. Ka doktrina të veçanta për secilën degë të FARSH dhe familja kolektive e doktrinave të luftimit përcaktojnë se si operojnë Forcat e Armatosura. Duhet të kuptohet që as rregulloret administrative dhe as doktrinën luftarake nuk zgjasin përgjithmonë dhe që kanë nevojë për rishikime të rregullta dhe të detajuara për të siguruar saktësi dhe përshtatje kohore.

Doktrinën e luftimit duhet të rishikohen minimalisht çdo katër vjet. Kjo kryhet nga një panel ekspertësh të cilët ekzaminojnë vlefshmërinë e parimeve dhe objektivave ekzistues doktrinar dhe paneli rekomandon ndryshime specifike në doktrinë. Çdo ndryshim doktrinar ka një ndikim të rëndësishëm në të gjithë procesin stërvitor të FARSH.

Doktrina e luftimit/përdorimit shërben si bazë për zhvillimin e Listës së Detyrave Themelore për Misionin (LDTM) për secilën njësi. Ky është një proces, i cili përcakton hapa specifike në përmbushjen e detyrave specifike! LDTM gjithashtu përcakton marrëdhënien midis të gjitha hapave që nevojiten për të përmbushur një mision ushtarak të caktuar. Procesi i zhvillimit të LDTM kërkon një panel ekspertësh, të cilët përcaktojnë çdo **detyrë** kryesore, **kushtet** nën të cilat detyra duhet të kryhet dhe **standardet** sipas të cilëve detyra duhet të kryhet. LDTM shërben si baza për vlerësimin e **gatishmërisë së operacionale** të luftarak.

*Një shembull i thjeshtë: Doktrina e luftimit e këmbësorisë kërkon që këmbësoria të kryejë operacione mbrojtëse. Analistët e LDTM përkufizojnë detyrat specifike të cilat nevojiten. Shembull i një prej shumë **Detyrave Themelore të Misionit: Përgatitja e nxituar e një pozicioni mbrojtës të këmbësorisë gjatë ditës.** [Vini re që ushtarët e këmbësorisë dhe njësitë e vogla stërviten nga njësitë e tyre se si duhet të duket një pozicion mbrojtës, si ndërtohet, etj.]. **Detyra** e LDTM është që të përgatitë një pozicion mbrojtës në përputhje me standardet doktrinarë; **Kushti** për përmbushjen e kësaj detyre përcaktohet si "gjatë ditës", dhe **Standarti** i performancës është brenda 15 minutash. Një LDTM i ngjashëm përcaktohet për të gjitha detyrat e lidhura me kryerjen e operacioneve mbrojtëse në Këmbësori dhe gjithashtu në të gjithë Forcat e Armatosura. Në mënyrë kolektive, Detyrat/Kushtet/Standardet e LDTM formojnë bazën për vlerësimin e gatishmërisë së njësisë. Njësia ose mundet të përgatitë pozicionin mbrojtës në përputhje me kushtet/standardet, ose jo. Kjo tregohet në ushtrimet stërvitore. Nëse nuk mund të demonstron, atëherë komandanti i njësisë ka përgjegjësinë e stërvitjes së ushtarëve*

individualë/njesisë që të përmbushin standardet e LDTM.

Kur komandanti i njesisë vlerëson gatishmërinë e njesisë duke kryer të gjithë spektrin e LDTM-ve, ai/ajo në mënyrë konstante vlerëson gatishmërinë e njesisë/strukturës duke kryer funksionet e saj kryesore. Në mënyrë periodike, (zakonisht çdo tre muaj) komandanti i njesisë kryen një Analizë të Gatishmërisë së Njesisë më formale për të përcaktuar nevojën për përshtatje dhe ndryshime në programin stërvitor të njesisë. Gjetjet e analizës dhe ndryshimet e nevojshme të programit stërvitor të njesisë përfshihen në Planet Vjetore dhe Tre Mujore të Stërvitjes së Njesisë në çdo nivel të lartë organizativ. Këto plane janë fleksibel dhe përshtaten për të siguruar që gatishmëria e njesisë të bazohet në aftësinë e njesisë për të kryer LDTM-të në nivelin e kërkuar të performancës. Planet stërvitore të njesisë përfshijnë dhe përcaktojnë pajisjet, furnizimet, poligonet e stërvitjes, transportin, etj, që nevojiten për të mbështetur stërvitjet e planifikuara. Këto kërkesa u identifikohen komandave më të larta duke u bërë atyre të qartë që nëse burimet e kërkuara nuk jepen, atëherë njësia nuk mund të konsiderohet e gatshme për luftim/mision. Kryerja e stërvitjes në nivelet më të larta të mundshme të performancës është një përgjegjësi kyç e komandës!

Nëse një komandant i një njësie të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, në çdo nivel organizativ, nuk ka një listë të përcaktuar të LDTM-ve, është përgjegjësia e tij/saj që ta krijojë një të tillë! LDTM-të jo vetëm përcaktojnë se çfarë duhet të jetë në gjendje të kryejë një njësi, por ata gjithashtu përshkruajnë burimet e nevojshme për të arritur një nivel të caktuar të gatishmërisë operationale. Kjo kërkesë është e vlefshme si për njësitë luftuese ashtu edhe ato mbështetëse në të gjithë FARSH-in.

Si dhe vënë në dukje më sipër, **komandanti i njesisë në çdo nivel është përgjegjës për zhvillimin e një LDTM-je të plotë të njesisë, dhe bazuar në këtë informacion, një Plan Vjetor Stërvitor.** Ky plan përcakton shtrirjen dhe llojin e stërvitjes që nevojitet nga njësia për ta mundur atë që të arrijë nivelin e dëshiruar të gatishmërisë operationale/luftuese. Kërkesa e specifikuar e nivelit të gatishmërisë vjetore operationale për njësi në të gjithë FARSH përcaktohet nga J3/J7 e Shtabit të Përgjithshëm (Operacionet/Stërvitja). Planet vjetore stërvitore të njesisë miratohen nga komandant e larta dhe duhet të përfshijnë llojin, qëllimin dhe burimet stërvitore që nevojiten për të mbështetur programin stërvitor: (pajisje, municione, karburant, ushqim, furnizime, poligone stërvitore, transport, etj.) të cilët nevojiten për të mundur zhvillimin e stërvitjes së planifikuar. Kjo çon në:

Ekzekutimi i **Ushtrimeve Stërvitore** specifike të njesisë në garnizon dhe në fushë, të kryer në përputhje me planin stërvitor dhe Detyrat/Kushtet/Standardet e LDTM. Në mënyrë ideale, programi stërvitor (në garnizon dhe në fushë) rritet për sa i përket kompleksitetit me kalimin e kohës, ndërkohë që edhe aftësitë e njesisë rriten. Është një kërkesë thelbësore që njësive ushtarake t'u caktohen ushtarë të cilët janë trajnuar më parë në aftësi specifike. Kjo eliminon nevojën që komandantët e njësive të kryejnë stërvitje të aftësive bazë për personelin dhe u lejon atyre të kryejnë stërvitje të avancuar individuale dhe të njesisë. Kjo nuk do të thotë që njësitë nuk kryejnë stërvitje të aftësive të nivelit bazë për personelin e emëruar. Megjithatë, kjo nënkupton që individët që i bashkohen Forcave të Armatosura duhet të jenë kontraktuar nga qendra dhe jo nga komandantët të njësive. Njësive u duhet emëruar personel i kon-



Foto arkiv

traktuar dhe i stërvitur. Kjo është një mënyrë tejet e ndryshme nga ajo që përdoret sot në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, ku komandantëve u lejohej të punësojnë dhe pushojnë personelin. Kontrata e shërbimit në Shqipëri duhet të jetë universale (të njëjtat kushte për të gjithë), administrim të përqendruar, dhe duhet të specifikojë detyrimet e shërbimit ushtarak të individit përkundrejt Forcave të Armatosura (dhe Republikës së Shqipërisë) si dhe detyrimet e Forcave të Armatosura (Shqipërisë) përkundrejt individit.

Aftësia e njësisë për të kryer misionet dhe detyrat që i janë caktuar dhe dhënë (si dhe theksuar në LDTM) analizohet dhe raportohet drejtuesve të lartë nëpërmjet **Raporteve të Gatishmërisë** në mënyrë periodike dhe tejet të saktë të përgatitur nga komandanti i njësisë dhe stafi i tij, dhe tregon statusin e **personelit, pajisjeve dhe furnizimeve**. Raportet e sakta të Gatishmërisë u lejojnë komandantëve të lartë të menaxhojnë burimet për të ngritur nivelin e gatishmërisë të çdo njësie.

Kërkesat stërvitore të njësisë, bazuar në standardet dhe kërkesat e LDTM, përmbillen me ekzekutimin e një apo më shumë **Ushtrimeve Stërvitore Kolektive**. Në këto ushtrime gjithmonë e më progresive e gjithë njësia demonstroi gatishmërinë e saj operacionale / luftarake për të kryer misionet/detyrat e caktuara, në përputhje me detyrat/kushtet/standardet e përcaktuara në LDTM.

Raportimi i gatishmërisë i të gjithë stërvitjes kolektive the individuale të njësive të kryer në të gjithë Forcat e Armatosura rezultoi në përgatitjen e **Analizës Vjetore të Gatishmërisë Operacionale të Forcave të Armatosura** nga J3/J7 i Shtabit të Përgjithshëm. Objektivi është vlerësimi i statusit aktual dhe real të stërvitjes në të gjithë FARSH dhe akoma më e rëndësishme, për të përcaktuar llojin dhe shtrirjen e stërvitjes që nevojitet për ta çuar FARSH në një nivel më të lartë të gatishmërisë së përgjithshme të luftimit / operacionale.

Komandanti i njësisë në mënyrë të vazhdueshme monitoron statusin e gatishmërisë së njësisë gjatë gjithë vitit, duke kontrolluar që standardet e performancës të mbahen në nivelin më të lartë të mundshëm. Në këtë proces ai mbështetet nga të gjithë oficerët e njësisë dhe nënoficerët e lartë. Me përfundimin e analizave tre mujore dhe vjetore

të gatishmërisë, komandanti i njësisë identifikon se cilat janë ndryshimet që nevojiten për të përshtatur ciklin e planifikimit dhe ekzekutimit të stërvitjes vjetore për të përmbushur nevojat reale të njësisë. Programet stërvitore përshtaten në mënyrë të vazhdueshme nga komandanti bazuar në mangësitë e identifikuar. Përderisa komandanti konsiderohet përgjegjës për gatishmërinë e njësisë, ai/ajo sigurohet që aktivitetet stërvitore të jenë gjithmonë të orientuara drejt përmirësimit të gatishmërisë operacionale / luftimit. Çdo njësi e Forcave të Armatosura, përfshirë të gjitha njësitë administrative, kanë përcaktuar me saktësi kërkesat e gatishmërisë dhe ata që punojnë në njësi janë stërvitur dhe vlerësuar në përputhje me standardet e vendosura të performancës (LDTM).

Raporti i Statusit të Gatishmërisë së Njësisë, i cili kalohet nëpër zinxhirin e komandës rregullisht, i jep Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të forcave informacionin e nevojshëm për të caktuar, alokuar dhe ri-alokuar burimet e Forcave të Armatosura për të mbështetur stërvitjen e gatishmërisë. Këto burime përfshijnë si njerëz (të mirë stërvitur në detyrat dhe aftësitë e tyre specifike), pajisje ushtarake (të mirëmbajtura dhe gati për t'u përdorur), edhe furnizime (të përshtatshme për të mbështetur programin stërvitor të njësisë).

Stërvitja ushtarake është një proces dinamik i cili përfshin cikle të vazhdueshme vlerësimi, përshtatjeje ekzekutimi dhe rivlerësimi. Komandantët kanë si përgjegjësinë ligjore ashtu edhe atë që është më e rëndësishme, përgjegjësinë morale, për stërvitjen profesionale dhe përgatitjen e vartësve të tyre në përputhje me standardet më të larta të mundshme. Çdo gjë më pak se kaq është një dështim i udhëheqësve.

Para Luftës së Dytë Botërore, Forca e Armatosur e SHBA-ve kishte pak burime dhe shumica e njësive stërviteshin me bishta fshesash dhe jo pushkë. Megjithatë, manovrat operacionale bazë, integrimi i fushave të zjarrit, përdorimi i sistemeve të shumtë të armëve ishin praktika njësoj sikur ushtarët të kishin armë të vërteta dhe municione të mjaftueshme. Komandantët kanë nevojë për imagjinatë dhe dedikim për të siguruar që vartësit e tyre të stërviten plotësisht në aspektet intelektuale dhe praktike të shërbimit ushtarak në garnizon dhe në fushëbetë.

Ky artikull është i pesti i një serie artikujsh nga Ekipi Amerikan i Modernizimit të Mbrojtjes (Cubic) mbi spektrin e koncepteve, parimeve, metodologjive dhe proceseve të integritetit të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). Objektivi i këtyre artikujve është të krijojë një kuptim më të mirë të koncepteve, çështjeve parimore, kërkesave dhe problemeve thelbësore të këtij integriteti.

Arritje e spikatur shkencore...

Përfundojnë me sukses studimet e para, part-time, të ciklit “Master Shkencash”, në Akademinë e Forcave të Armatosura

ZENO JAHAJ

Tre vjet më parë, me përkushtimin dhe përpjekjet e trupit pedagogjik dhe të Akademisë së Mbrojtjes (sot Akademia e Forcave të Armatosura) dhe nën kujdesin e drejtpërdrejtë të drejtuesve të këtij institucioni të mendimit, u arrit të hapeshin për herë të parë kurset part-time për ciklet e studimit të nivelit të dytë për Master Shkencor në fushën e Sigurisë Kombëtare, si dhe ato të Masterit Profesional. Në një jetë të gjatë të kësaj Akademie që daton rreth 55 vjet, hapja e këtyre cikleve shënon një zhvillim tejet të rëndësishëm për shumë arsye. Akademia e Mbrojtjes apo Akademia Ushtarake siç quhej në vite, i kishte aplikuar me sukses përgjegjësinë, detyrimet dhe profesionalizmin për përgatitjen dhe dhënien e titujve të lartë shkencorë sikurse janë ato të docentit, të doktorit të shkencave dhe të profesorit. Një traditë e pasur për këtë qëllim ishte krijuar madje edhe përpara viteve '90, kur në këtë institucion u bë rregull që drejtuesit e tij, si dhe të katedrave e deri edhe pedagogët të kishin patjetër një gradë shkencore për të merituar komandimin, drejtimin

dhe mësimdhënien në të. Pavarësisht nga kufizimet e kohës (informacioni i huaj jo shumë i bollshëm; kontaktet inekzistente me jashtë; ngurtësimi i mendimit për shkaqe ideologjike e politike; ndikimet lindore në mendimin akademik, etj.) fryma kërkimore, inkurajimi i mendimit të lirë dhe të kundërt të paktën në lëmin taktik e deri diku edhe në lëmin operacional ishin vlera të pamohueshme. Në fund të fundit nuk do të ishin kufizimet, por pikërisht këto vlera të cilat do të zhvilloheshin edhe më tej, natyrisht në kushtet e një informacioni e kontaktesh tashmë të lira në Shqipërinë paskomuniste. Plejada e pedagogëve të talentuar, të cilët kishin formësuar individualitetin e tyre akademik, kishin kalitur guximin intelektual dhe kishin zhvilluar frymën e debatit e të mendimit kundër si Prof. Dr. Kostaq Karoli, Prof. Dr. Pajtim Ribaj, Prof. Dr. Pëllumb Danaj, Prof. Dr. Proletar Hasani, Prof. Dr. Ruzhdi Gjatoja, Prof. Asc. Agron Agolli, Prof. Asc. Gëzim Mustafa, Prof. Asc. Agim Sula, Prof. Asc. Qetësor Orhani etj, mbetën dhe janë edhe sot një “kazan mendimi” që pasuron shkollën ushtarake shqiptare. Është krejt e natyrshme që pas vitit 1990 do të hapeshin horizonte të reja, një botë e tërë e panjohur mirë





e mendimit ushtarak strategjik, operacional e taktik perëndimor. Përmes sistemit të arsimit të kualifikimeve si në institucionet tona, ashtu edhe në ato jashtë vendit, profesorati tradicional iu shtuan prurje të reja si Prof. Dr. Kristaq Xharo, dr. Simon Gega, .Dr, Adrian Myslymi, Dr. Mimoza Duka, etj. Nga ana e tij, edhe vetë profesori tradicional azhurnoi informacionin, idetë dhe përgjithësisht mendimin ushtarak e tashmë edhe atë të strategjisë kombëtare për t'iu përgjigjur orientimit të ri politik e ushtarak të vendit mbi bazën e koncepteve, doktrinave, strategjive e vlerave të organizmave evropiane si NATO e BE, si dhe të vendeve aleate e partnere. Kësisoj, "kazani i mendimit" u pasurua si me përvojën tradicionale, ashtu edhe me prurjet e reja për të arritur në atë që sot e dëshmojmë si një institucion të doktrinave e të stërvitjes.

Gjithsesi, u krijua një hendek i madh: deri përpara tre vjetëve institucionet tona të doktrinave e stërvitjes siguronin mësimdhënien dhe përgatitjen e dy niveleve, përkatësisht të nivelit të parë, atë të përgatitjes e të titullimit të oficerit, (i cili është i njëjtë në koncept dhe në kredite me sistemin "bachelor" të arsimit të tërësisë), si dhe të nivelit të tretë, atë të përgatitjes dhe udhëheqjes së doktorantëve e profesorëve. U krijua kësisoj një e çarë e madhe në procesin akademik, sepse u injorua pikërisht hallka lidhëse, niveli i dytë apo siç quhet ndryshe, niveli "Master" i cili, nga ana e vet, ndahet në dy nën-nivele: Master Profesional dhe Master Shkencor.

Prandaj identifikimi i kësaj zbrazëtie dhe marrja e

masave për ta mbushur atë ishin realisht një revolucion, si në organizimin, ashtu edhe në drejtimin, udhëheqjen dhe zhvillimin e tërë sistemit akademik ushtarak. Prandaj edhe përpjekjet e përkushtimi për ta kurorëzuar me sukses hapjen e ciklit të masterave meritojnë një vështrim intelektual, të çliruar nga xhelozitë dhe interesat e ngushta.

E vërteta është se me termin "Siguri Kombëtare" me të cilën janë pagëzuar tashmë ciklet e studimit "Master" që zhvillohen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, kanë qenë zhvilluar e zhvillohen edhe nga qendra të tjera universitare kombëtare. Deri këtu nuk ka asgjë të çuditshme. Vetë termi "Siguri Kombëtare" nuk është më një term kryesisht i sigurisë ushtarake, sikurse konceptohej më së shumti në Luftën e Ftohtë e në të kaluarën e largët në kohë. Siguria kombëtare sot e, përherë e më shumë nesër, ngërthen e do të ngërthejë jo thjeshtë "elemente" të jetës sociale, politike e ekonomike të vendeve, por se shpesh, këto të ashtuquajtura "elemente" mund të prodhojnë e do të prodhojnë efekte drastike në sigurinë kombëtare. Për të mos shkuar larg, ishin pikërisht këto "elemente" të jetës sociale, politike e ekonomike që shkak-

tuan dramën shqiptare të vitit 1997. Madje në atë dramë, si për ironi, vetë ushtria, jo vetëm që u bë pjesa më e pasigurt e shoqërisë, por edhe burimi për të lënë edhe sot madje plagë të hapura.

Problemi, pra nuk është pse zhvillohen cikle të tilla në qendra të tjera universitare. E kundërta do të ishte e gabuar. Por problemi ynë është: a do të thotë ky fakt i difuzionit ndër-dimENSIONAL të sigurisë kombëtare që të mënjanohet njeri nga këto dimensione, sikurse është dimension i Mbrojtjes? Unë mendoj se pikërisht këtu "fle" paqartësia, më saktë xhelozia, edhe interesi i ngushtë. Në doktrinën ushtarake të Luftës së Ftohtë thuhej me të drejtë se "asnjë armë e vetmuar nuk mund ta zgjidhë fatin e luftës." Nëse do të doja ta perifrazoja këtë aksiomë që i qëndronte asaj kohe, mund të thosha krejt i mbështetur intelektualisht se sot, askush nuk mund ta marrë apo ta mbajë i vetëm monopolin e sigurisë kombëtare.

Çështja, pra, nuk është nëse duhet apo nuk duhet të kenë institucionet tona ushtarake cikël të tillë masterash. Çështja është tjetërkund: a jemi të krahueshëm me standardet akademike të mësimdhënies? Me kë i kemi krahasuar këto standarde? A kemi kapacitete të denja profesorati? A kemi kapacitete e mbështetje logjistike, etj? Këtu është një fushë që mund të shikohet e rishikohet. Por kjo nevojë e shikimit apo e rishikimit nuk mund ta përligjë asnjëherë mendimin sa nihilist, aq edhe dashakeqës që mund të jetë frymëzuar aty këtu, se ushtarakët nuk kanë kapacitete për të zhvilluar e udhëhequr mendim shkencor. Kjo jo vetëm që është e pamundur, por edhe sikur

të jetë kështu, është një "DUHET" e madhe që na urdhëron t'i krijojmë më çdo kusht këto kapacitete. Siç e thamë më lartë dhe siç pranohet gjerësisht, ushtria jo vetëm që nuk mund të përjashtohet nga monopoli i sigurisë kombëtare, por përvoja si e jona, ashtu edhe ajo botërore, dëshmon se çështje të tilla si siguria kombëtare janë të paimagjinueshme pa pjesëmarrjen e institucioneve, të mendimit dhe të ekspertizës ushtarake. Është tjetër gjë pastaj se në ç'masë këto institucione, mendimi dhe ekspertiza e tyre evoluojnë apo mbeten në vend. Kjo varet nga kërkesat që shtrohen. Një institucion akademik që nuk i kërkohet mendim dhe që nuk ofron mendim e ekspertizë, kthehet në një organizëm i vdekur. E gjithë çështja është: sa e angazhojmë institucionin akademik me detyra mendimi e ekspertize siç mund të jenë reformat që bëhen e që patjetër duhet të bëhen; vlerësimet e zhvillimeve gjeopolitike e rrjedhimet për sigurinë kombëtare të vendit; parashikimi i detyrimeve apo angazhimeve që mund të rrjedhin për Shqipërinë nga konfliktet e ardhshme në pika të nxeha të botës, sikurse ishte propozimi i komunitetit ndërkombëtar dhe SHBA-së për të konsideruar asgjësimin në territorin shqiptar të lëndëve kimike që u identifikuan në Siri, etj. Për më tepër, dihet që sot, e aq më shumë nesër, Shqipëria është e do të jetë jo vetëm apo thjeshtë e interesuar për zhvillimet globale, por do të jetë e duhet të jetë e pranishme, qoftë edhe në mënyrë simbolike, apo, të themi, proporcionale me mundësitë e veta njerëzore, financiare e logjistike. Por sikur edhe një ushtarak të vetëm të kemi diku, në atë çast e tutje, ne kemi krahas interesit e detyrimit ndaj sigurisë së këtij ushtaraku, edhe interesin për çfarë ndikohemi nga siguria apo pasiguria globale apo rajonale. Njohja dhe interesi ynë nuk mbeten pra këtu tek dera, por shumë, shumë larg dhe ky koncept i sigurisë kërkon edhe ekspertizën e rekomandimet përkatëse, të cilat nuk mund të sigurohen më mirë se sa nga institucionet studimore e shkencore sikurse janë e duhet të jenë shkollat e institutet e mbrojtjes e ato ushtarake. Le të kalojmë te përvoja e krijuar me hapjen në Akademinë e Mbrojtjes (sot Akademia e Forcave të Armatosura) në Shkurt 2011 të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave në Sigurinë Kombëtare." Hapja e këtij cikli ishte e një rëndësie jetësore për Akademinë dhe përgjithësisht për Forcat e Armatosura, jo thjeshtë se u kapërcyen shumë pengesa, por në radhë të parë se u arrit që të plotësohej pikërisht cikli jetësor i studimeve, përkatësisht lidhja e ciklit të parë me ciklin e tretë përmes ciklit të dytë që mungonte dhe madje paragjykohej. Nuk ishte, pra, një zgjidhje thjeshtë burokratike, as një aset luksi apo dëshirash a deliresh, por një zgjidhje e domosdoshme jetësore për një institucion që ligjërisht vlerësohet se bën pjesë në sistemin e arsimit të lartë. Ky është themeli institucional nga i cili niset e duhet të niset çdo diskutim që lidhet me pse-të, minuset apo pluset e hapjes së këtij cikli në strukturat e Forcave të Armatosura. Çdo diskutim tjetër vetëm se e than, si mendimin, edhe vetë organizmin e Forcave të Arma-

tosura. Kurrikulat e këtij Masteri ishin një arritje që meriton një analizë e vlerësim më vete. Moduli "Gjeopolitika" - nga më kryesorët e ciklit të studimeve të këtij Masteri ishte, pa dyshim, shtylla e të gjitha moduleve të tjera. Gjeopolitika, do të thosha, është bërë tashmë mbretëresha e tavolinave akademike në çdo fushë të jetës e të aktivitetit të çfarëdo fushe. Mjafton të përmend se sot kemi deri edhe "Gjeopolitikë të Emocioneve", për të shtuar pastaj se gjeopolitika është çiftëzuar tashmë me hronopolitikën, duke plotësuar kështu mendimin në hapësirë, me mendimin në kohë. Për shumë kohë në historinë tonë kombëtare, Shqipëria e shqiptarët kanë qenë produkt i gjeopolitikës e rrallë herë (sikurse është epoka e Skënderbeut), ka qëlluar të jenë aktorë në gjeopolitikë. Zhvillimet paskomuniste e sidomos zhvillimet e fillim-shekullit të '21-të i kanë prurë Shqipërinë e shqiptarët përgjithësisht në fushën e gjeopolitikës si aktorë të pyetur. Shqipëria e faktorët shqiptar tashmë pyeten për zhvillimet në Ballkan e në çdo vend të këtij rajoni, për shkak të përhapjes dhe lirisë që gëzojnë me përpjekjet e tyre dhe të komunitetit ndërkombëtar. Pa një vizion gjeopolitik, ky rol dobësohet e madje edhe mund të komprometohet, sidomos në përcaktimin jo adekuat të interesave kombëtare, të partneriteteve dhe aleancave. Këtu futen në lojë sigurisht edhe teoritë dhe praktikët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe e Organizatave Ndërkombëtare, të cilat ishin dy module të tjera që u zhvilluan në këtë cikël. Jeta e një vendi, sidomos në kushtet e globalizmit, i cili po e tërheq në vorbullën e tij gjithnjë e më shumë botën, popujt e njerëzit, nuk mund të kuptohet pa marrëdhënie ndërkombëtare. Madje mund të thuhet pa asnjë mëdyshje se e tërë jeta e një vendi, veçanërisht e vendeve relativisht të vogla si Shqipëria, është, në radhë të parë, një marrëdhënie me jashtë. Një vend i vogël veçanërisht, në këtë botë globale, nuk mund të bëjë dot pa Fondin Monetar Ndërkombëtar, pa Bankën Botërore, pa organizatat ndërkombëtare, pa NATO-n, pa BE-në, pa OKB-në. Sot nuk mund të shtrohet çështja të hysh apo të mos hysh në marrëdhënie me këto e të tjera organizma. Çështja shtrohet ndryshe: në këto ne do të hyjmë patjetër në marrëdhënie, por me kulturë strategjike dhe në funksion të sigurisë e prosperitetit perspektiv të vendit dhe jo me diletantizëm apo thjeshtë apo vetëm për synime afatshkurtra. Moduli "Metodologjia e Kërkimit Shkencor" që ishte pjesë e programit të këtij cikli përbën një arsye të fortë pse ky cikël është i domosdoshëm në institucionet tona akademike ushtarake. Kërkimi shkencor zor se mund të arrihet të kultivohet në ciklin e parë të studimeve (bachelor). Por do të ishte gjysmake (sikurse është faktikisht) që aftësimin për kërkime shkencore ta kërkosh nga cikli i tretë, përkatësisht nga ai doktoraturës. Nuk ka kuptim që doktoranti të mësojë metodologjinë e kërkimit ndërsa përgatitet për të mbrojtur doktoraturën. Kandidati për doktoraturë hyn në këtë cikël për të prodhuar, për të kërkuar e sjellë gjetje shkencore me rëndësi kapitale, jo për të mësuar met-

odologjinë e kërkimit. Nga ana tjetër, nga sistemet e mëparshme të studimeve nuk trashëgojmë përvojë, mësimdhënie e as kemi literaturë të mjaftueshme për metodologjinë e kërkimit shkencor. Prandaj parashikimi e përfshirja e këtij moduli në ciklin e dytë të studimeve ishte mjaft i domosdoshëm për të krijuar shtratin e duhur apo për të shtruar një rrugëtim të mbarë e produktiv studimesh e kërkimesh. Moduli "Strategjia" ishte natyrisht një domosdoshmëri, sidomos për të krijuar vizione më të plota e më të qarta për shtrinjen e këtij koncepti që përfshin strategjinë e madhe politike të një shteti e kombi, strategjinë kombëtare, strategjinë ushtarake e deri edhe strategjitë sipas fushave. Secila ka një individualitet, por secila është e pashkëputur nga të tjerat. Prandaj askush nuk mund të jetë efektiv në fushën e tij pa pasur një vizion të plotë për të gjitha këto nivele strategjike. Për më tepër, nga kontingjentet e këtij "Kazani mendimi" do të dalin e duhet të dalin nesër politikanët apo administratorët e të gjitha niveleve. Krahas me modulet si më sipër, pasurimi i kurrikulave të këtij cikli me module të tjerë si: Teoria e Lojës, Operacionet në Mbështetje të Paqes, Inteligjenca dhe Informacioni, etj., e pruri këtë cikël studimesh në parametra bashkëkohorë. Gërshetimi i tezave, ideve, prurjeve, përvojave, anketimeve e vëzhgimeve midis moduleve ishte një përvojë më vete që ndihmoi jo vetëm studentët, por edhe vetë pedagogët e drejtuesit e institucionit për më shumë përgjegjësi e përgjegjshmëri në mësimdhënie. Këtë spektër optimist e pasuroi veçanërisht përbërja e grupit të studentëve. Një risi më vete ishte fakti që në këtë grup, krahas ushtarakëve aktivë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes e Forcave të Armatosura, pati edhe kandidatë nga ushtarakët në rezervë. Nga ana tjetër, krahas këtij kontingjenti, një pjesë e madhe e kandidatëve vinin nga organizma shtetërore që lidhen drejtpërdrejtë më çështje të sigurisë kombëtare, si për shembull, nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme e Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Arsimit, e deri organizata joqeveritare, individë, etj. Ndërkohë, grupi pati një strukturë moshash e përvojash të ndryshme, gjë që e pasuroi akoma më shumë debatin shkencor. Fakti që një pjesë nga kandidatët vinin nga Kosova bëri që përvoja e Shqipërisë të shkëmbehej me shumë efektivitet me përvojën e shtetit të sapokrijuar të Kosovës. Siç është e natyrshe, mësimdhënia e mësimdhënësit përbëjnë shtyllën e çdo shkolle e të çdo sistemi arsimimi. Në këtë kuadër, cikli i studimeve "Master i Shkencave" që nisi në Shkurt 2011, kishte dhe e arriti të institucionalizojë përgjegjësinë e pedagogut. Për këtë, komanda e atëhershme e Akademisë, angazhoi një profesor me kapacitete të spikatura në njohuri akademike, në përvojë mësimdhënieje e jetësore (politike, ushtarake, sigurie kombëtare, etj) e deri në aftësitë azhornuese me ritmet



e zhvillimit. Kështu, p.sh, mësimdhënës si Dr. Leonard Demi, Prof. Dr. Pajtim Ribaj, Doc. Gjen. Zija Bahja, Dr. Simon Gega, Dr. Irakli Koçollari, etj., përbëjnë një pasuri të certifikuar shkencore të nivelit kombëtar. Po kështu, angazhimi i personaliteteve të njohura shkencore si Prof. Dr. Rexhep Mejdati, Prof. Dr. Lisien Bashkurti, Prof. Nikolla Pano, Prof. Bashkim Rama etj, dhe i disa lektorëve nga vende të tjera, i dha këtij cikli një frymëmarrje të gjerë për të zhvilluar ide dhe gjetje të reja. Një gjetje e tillë ishte edhe Konferenca Shkencore për Sigurinë Energjetike, zhvilluar në ambientet e Akademisë, e cila edhe pse nuk ishte nismë e këtij cikli, por pati shtysë iniciativën e Qendrës studimore "Hapësinë", pa të angazhuar thuajse gjithë personat e Masterit. Po kështu, ky grup përgatiti punimet edhe për një tjetër Konferencë shkencore, atë për Gjeopolitikën Shqiptare, konferencë e tilla spikat për tematikën e larmishme e të palëvruar (mbetur të paprezantuar aktualisht). Mendoj se do të ishte me vlerë që të gjendeshin mundësitë për ta zhvilluar këtë Konferencë, sepse nga testimet paraprake të temave të përgatitura, vlerësohet se ka gjetje e vlera që promovojnë vizione të reja mbarëkombëtare. Një vlerë të veçantë sollën temat përfundimtare të Kursit. Serioziteti, formati akademik i arrirë dhe sidomos prurjet e reja ishin vlera e veçantë e këtyre temave. Do mund të sugjeroja që një pjesë e tyre apo një përzgjedhje e ideve të hedhura në këto tema, do të ishte një kontribut me vlerë për të pasuruar literaturën dhe sistemin e referencës, jo vetëm në Akademinë e Forcave të Armatosura, por në tërë sistemin e studimeve ushtarake. Hapja për herë të parë e kurseve part-time për ciklin e studimeve të nivelit të dytë për Master Shkencor në fushën e Sigurisë Kombëtare në strukturat e Forcave të Armatosura jo vetëm që ishte e është një domosdoshmëri jetësore në pikëpamje arsimimi, por praktika e tregoi se ishte edhe një kontribut i jashtëzakonshëm për pasurimin e mendimit në fushën e sigurisë ushtarake, si dhe të llo-bimit dhe gërshetimit të çështjeve të mbrojtjes me të gjitha çështjet e tjera të sigurisë kombëtare dhe me institucionet e tjera shtetërore e jo-shtetërore.

AFGANISTAN 2001-2013

Mësimet e nxjerra nga Afganistani, me një rëndësi të veçantë për FA

Taktikat, teknikat dhe procedurat (TTP) e përdorura nga talebanët gjatë konfliktit shumëvjeçar

KOLONEL DRITAN DEMIRAJ

U pënë rreth 13 vjet që nga koha kur grupet e para të Forcave Speciale dhe të shërbimeve sekrete amerikane u infiltruan në Afganistan dhe në bashkëveprim me trupat e Aleancës së Veriut filluan veprimet luftarake për rrëzimin e regjimit taleban që mbizotëronte në vend që prej kohës që trupat sovjetike u larguan nga konflikti i tyre 10 vjeçar në Afganistan. Meqenëse që prej vitit 2001 e në vazhdim trupa të shumta të ushtrisë amerikane dhe të shteteve të ndryshme të aleancës kanë qenë të angazhuara në misione të shumta gjë e cila ka sjellë si pasojë dhe humbje të konsiderueshme në njerëz dhe mjete, mendoj që një trajtim i TTP-ve të kundërshtarit ndër vite në trajtën e mësimëve të nxjerra do të ishte e një rëndësie të veçantë. Kjo pasi do të bënte të mundur njohjen e tyre nga një audiencë më e gjerë e personelit të FA dhe do të bënte të mundur që të zgjeroheshin njohuritë mbi atë që personeli, i cili do të shkojë në dislokime të ardhshme në Afganistan, të ketë më të qartë se cilat do të jenë sfidat me të cilat do të duhet të përballlet në terren. Nga ana tjetër komandantët të cilët kanë përgjegjësinë e përgatitjes së trupave për dërgim atje, do të duhet të fillojnë dhe të marrin në konsideratë ato mësimet të nxjerra të cilat do të ndikojnë në përgatitjen e programeve të stërvitjes para-dislokuese. Pjesëmarrja e FA shqiptare në misionet luftarake "Eagle" ka rritur ndjeshëm peshën e kontributit të RSH në arenën ndërkombëtare nga ana sasiore, por dhe nga ana cilësore. Angazhimi i drejtpërdrejtë në operacione speciale i forcave tona speciale, ka rritur ndjeshëm kapacitetet e tyre luftarake eksperiencë e cila do të duhet të transmetohet në vazhdimësi në repartet e tjera të ushtrisë në mënyrë që dhe ata të rrisin nivelin e tyre operacional për të qenë të gatshëm të kontribuojnë me të njëjtin nivel.

Rebelët afganë janë të guximshëm dhe këmbëngulës, me prirjen për realizimin e taktikave me njësi të vogla njerëzish. Ata janë përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në luftime me forcat e Shteteve të Bashkuara dhe të NATO-s në mënyrë direkte, shpesh për periudha të gjata duke përdorur me efektivitet zjarrin, manovrat krahëmarrëse dhe rrethimin. Në raste të ndryshme kanë ndaluar dhe rrethuar patrullat për t'i vrarë. Ata kanë kryer qindra sulme mbi baza të fortifikuara dhe kanë rritur koston e mirëmbajtjes së këtyre pozicioneve duke vënë në objektivat linjat e furnizimit të Koalicionit me IED (mina të improvizuara) dhe pritat e ndryshme.

Kur sulmohen, shpesh rebelët afganë kundërsulmojnë, ruajnë kontaktin edhe kur përballen me zjarr të dukshëm superior. Në shumë raste, ata kanë luftuar dhe kur kanë qenë nën sulmet ajrore dhe bombardimeve intensive të artilerisë së koalicionit. Luftëtarët afganë të cilët mbrojnë komandantët e tyre të lartë nuk tërhiqen edhe përpara vdekjes së sigurt. Ata nuk dorëzohen thujse kurrë. Rebelimi në Afganistan është kryesisht rural. Bazat e talebanëve janë të vendosura kryesisht në fshatra të thella dhe në malet e larta të vendit, në luginat e largëta ku ka pak ose aspak prani të qeverisjes. Si rezultat, forcat e Koalicionit janë shpërndarë në zona të gjera me linja të gjata dhe të cënueshme të komunikimit. FOB-et (Bazat e avancuara të veprim-it) veprojnë larg përforcimeve, zonat që i rrethojnë shpesh janë të kontrolluara dhe të pambrojtura nga talebanët. Rebelët, në mënyrë të pamëshirshme, kanë vënë në objektivat rrugët dhe disa herë ndërprerjen e rrugëve të furnizimit të bazave të Koalicionit. Në Afganistan, linjat e komunikimit janë përgjithësisht të vështira për tu ruajtur për shkak të vështirësisë gjeografike, infrastrukturës së dobët



të transportit dhe popullatës rurale të shpërndarë. Taktikat e talebanëve ndryshojnë në thelb nga vendi në vend, në varësi të gjeografisë, demografisë dhe densitetit të forcave të Koalicionit. Luftimet në mallet e ashpra të Kandaharit të veriut, pjesës së tij Jug-lindore përgjatë kufirit me Pakistanin, Zabulit janë të ndryshme nga luftimet në luginat tepër të kultivuara përgjatë lumenjve në distriktin e Helmandit. Disa fshatra janë bërë vendndodhja e pritave të përsëritura; të tjera kanë mbetur të qeta. Në qytete janë më të shpeshta bombat vetëvrasëse, por në zonat rurale mbeten në normë taktikat tradicionale të rebelimit gueril. Rebelët vijojnë të kryejnë sulme të shumta në shkallë të gjerë aty ku prania e Koalicionit është e dobët, ndërkohë që diku tjetër tregohen të kujdesshëm. Gjithashtu, ka grupe të shumta të veçanta të rebelëve në pjesë të ndryshme të Afganistanit, pjesa më e madhe e tyre (por jo të gjithë) e të cilëve luftojnë nën flamurin e talebanëve. Përgjatë viteve të luftës, taktikat kanë ndryshuar. Që prej vitit 2002 e deri në pjesën më të madhe të vitit 2005 talebanët operuan në grupe të vogla në zona të largëta dhe kryen sulme të tipit godit dhe largohu mbi patrullat e izoluar. Talebanët u hodhën në ofensivë në fund të vitit 2005- 2006, u grumbulluan në numër të madh pranë qendrave të populluara dhe u hodhën në sulme frontale mbi pozicionet e fortifikuara rëndë. Pasi pësuan humbje të mëdha dhe dështuan për të zbrapsur forcat e koalicionit, shumë komandantë të rebelëve shpërndanë forcat e tyre dhe u fokusuan mbi operacione më të vogla. Vitet 2007-2008 panë një rritje dramatike në numrin dhe sofistikimin e sulmeve IED dhe atyre vetëvrasëse. Qëllimi i këtij shkrimi është të përshkruajë dhe të analizojë taktikat e njësive të vogla të përdorura nga rebelët në Jugun e Afganistanit që nga viti 2005 e në vazhdim. Audiencia e parashikuar janë operatorët e BFS, ushtarët, nënoficerët dhe oficerët e FT dhe të njësive të tjera të ushtrisë ose policisë, që janë duke u përgatitur për zbarkim në Afganistan. Ideja është që atyre t'ju

ofrohet një hyrje e arritshme dhe për më tepër e saktë dhe analitike e taktikave të këmbësorisë së rebelëve afganë.

Pjesa në vazhdim e këtij shkrimi është një diskutim i përgjithshëm mbi taktikat e ndryshme, duke iu referuar shembujve specifikë. Do të shpjegojmë raste mbi përfshirjet e mundshme të zjarrit direkt, pritave, sulmet mbi pozicionet fikse dhe përfshirjet në luftimet mbrojtëse. Si konkluzion do të diskutohen kundërmasat e mundshme që mund të marrim ne nga ana jonë.

Taktikat afgane gjatë viteve 1980

Taktikat rebele në Afganistan nuk kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore që nga lufta kundër sovjetikëve gjatë viteve 1980-1990. Një përjashtim i qartë është shtimi në mënyrë të madhe i përdorimit të bombave vetëvrasëse, gjë që nuk ishte dëgjuar më parë në Afganistan përpara vitit 2002. Muxhahedinët afganë përdorën IED-të (zakonisht mina që shpërthenin nga telekomandimi në distancë) ndaj autokolonave dhe patrullimeve në këmbë, megjithëse në shkallë më të ulët se në ditët e sotme. Një pjesë e teknologjisë së IED-ve ka ndryshuar që nga vitet 1980, por taktikat bazë nuk janë shumë të ndryshme. Në veçanti taktikat e pritave kanë mbetur konstante. Marrja e krahëve, rrethimi dhe prita në formë L-je të gjitha u perfeksionuan gjatë viteve 1980. Përgjatë vijimësisë së luftës, muxhahedinët u aftësuan në pritat e llojit godit-dhe-largohu. Ishte periudha e viteve 1980 në të cilën rebelët afganë mësuuan të zbutnin efektet e fuqisë ajrore duke përdorur fortifikime dhe nga shpërndarja e forcave të tyre. Në raste të ndryshme, muxhahedinët shkatërruan autokolona të tëra të kundërshtarit. Gjatë viteve 1980 ishin të zakonshme pritat e gjata që shtriheshin për shumë kilometra, veçanërisht nëpër male. Muxhahedinët ngrinin pozicionet e pritave gjatë natës dhe lëviznin përreth të paarmatosur gjatë ditës. Ata përdorën



PRIZRENI, PREMTIM



Vetëtimia dhe gjëmimi i Prizrenit...

Gjithkujt i ka rënë rasti të shohë me qindra herë dritën e vetëtimave dhe disa çaste më pas të dëgjojë krismën e gjëmimit të tyre. Në fillim shfaqet pamja, pastaj zëri. Mbase nga kjo gjë ka dalë edhe ajo shprehja popullore "Do ja ndiesh zhurmën më vonë". Në një paralelizëm të tillë, ngjan se shtrihet edhe Prizreni, qyteti i Lidhjes. Jehona e Lidhjes së Prizrenit i ka shoqëruar shqiptarët qysh nga momenti që

ajo u mbajt e deri në ditët e sotme, ndërsa drita e saj ishte vetëtimia e momentit. Ngjan se zhurma e saj jehon përsëri në formë jehone e mesazhi dhe këtë fuqi e kanë të gjitha ngjarjet thelbësore historike në historinë e kombeve. Kjo Lidhje kishte mision shpëtimitin e kombit dhe ruajtjen e tij – mesazhi që ajo do përcjellë përjetë është pikërisht misioni i saj. Për këtë arsye e për të tjera akoma, edhe mbledhja e parë e përbashkët mes

PËR TË ARDHMEN..



Deklarata e përbashkët shtetërore, mes Shqipërisë e Kosovës, mbështetet në katër shtylla kryesore: Bashkëpunimi në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë; çështjet e brendshme; ekonomia, arsimit dhe kultura, së bashku. Dokumenti i përbashkët është po ashtu, konfirmim i vullnetit të përbashkët për të forcuar dhe thelluar marrëdhëniet me aleatët dhe me partnerët e mëdhenj të përbashkët strategjik, SHBA dhe BE, si dhe i vullnetit të përbashkët për t'u bërë përcues të një modeli të bashkëpunimi dhe zhvillimi për mbarë rajonin

Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, e mbajtur në Prizren në datën 11 janar 2014, është historike. Ajo është historike për mesazhin që përcjell, për atë që krerët thanë, që nuk thanë, që nënkuptuan e së fundi për atë që ata firmosën. Mesazhi, misioni është qëllimi sipëror - aq e vërtetë sa edhe shprehja biblike "unë jam thjesht mesazheri", - ku mesazheri nuk është më i rëndësishëm se sa mesazhi. Në këtë mënyrë vendosja e gur-themelit të ndërtimit të strategjive të përbashkëta mes Republikës së Shqipërisë e asaj të Kosovës, është përgjigje ndaj jehonës historike të Lid-

hjes së Prizrenit, por edhe ky veprim në vetvete është në përputhje më të njëjtin paralelizëm. Sot u pa drita rufesë, u pa zhvillimi i një partneriteti strategjik- të nesërmen do të dëgjohet gjëmimi i kësaj ngjarje historike. Ky "gjëmim" do të jetë detyrimi absolut i ngritjes së nivelit strategjik në shkallën më serioze të kryer ndonjëherë. Mesazhi ishte i qartë: jemi në një rrugë të pakthyeshme, të pashmangshme, të dëshiruar, të shumëpritur dhe shumë natyrale... në rrugën e bashkimit, në Vlorë, në mbledhjen e radhës...

Albert Hitoaliaj



gjithashtu edhe mina ndaj autokolonave dhe patrullave të këmbësorisë. Muxhahedinët vunë në objektiv në mënyrë të vazhdueshme linjat e furnizimit të ushtrisë sovjetike. Sovjetikët luftonin me shumë vështirësi për të siguruar rrugët, por asnjëherë nuk patën sukses. Muxhahedinët, në mënyrë konstante, vunë në objektiv pozicionet fikse të sovjetikëve. Më shumë se 75% e forcave sovjetike në Afganistan ishin të detyruara të ruanin pozicionet dhe të ruanin ri-furnizimin e tyre. Gjatë viteve 1980, muxhahedinët mësuan të sulmonin pozicionet gjatë natës, të godisnin pozicionet e afërta si një mjet për të vonuar përforcimet, dhe të luftonin në grupe të vogla në mënyrë që të evitonin dëmet e mëdha në njerëz. Muxhahedinët rregullisht pushtonin qendrat e rajoneve të largëta, largoheshin, përsëri i pushtonin kur largoheshin forcat sovjetike. Ushtria sovjetike kontrollonte bazat e saj, shumë ndërtesa qeveritare dhe pjesën më të madhe të zonave urbane. Por Muxhahedinët kishin ndikim më të madh ndërmjet pjesës më të madhe të popullatës rurale të Afganistanit, të cilët jetojnë në mijëra fshatra të largët, të cilët vetë-qeverisen. Me raste, rebelët, gjithashtu, ruanin pozicionet e tyre në luftimet mbrojtëse. Muxhahedinët preferonin të ruanin territorin me risk të ulët dhe realizonin me sukses sulme tepër të lëvizshme të llojit godit-dhe-largohu. Megjithatë, pati shumë raste në të cilat rebelët qëndronin dhe luftonin ndaj sulmeve të sovjetikëve – zakonisht për të mbrojtur zonat e bazave të rëndësishme të nevojshme për të lëvizur pajisjet, për të mjekuar luftëtarët e plagosur dhe për të planifikuar operacionet. Rebelët mësuan të ndërtonin fortifikime mbrojtëse dhe zona pritash që rrethonin bazat kyçe, të përdornin me efektivitet raketat “Stinger” kundër forcave dhe sulmeve ajrore, përdorën rojet dhe informatorët që të ruanin forcat sovjetike, për të pasur një informacion sa më të saktë rreth lëvizjeve dhe veprimeve të kundërshtarit. Pritat pranë bazave, i mundësonin muxhahedinëve që të fitonin kohë për të përgatitur mbrojtjen e tyre, të fshihnin armët dhe të largoheshin nga zona. Kur rebelët përpiqeshin të ruanin një zonë të caktuar, ata zakonisht kishin humbje të mëdha. Me kalimin e kohës ata mësuan të vepronin në baza më të vogla dhe më të lëvizshme, për t’i lëshuar këto pozicione në vend që të përpiqeshin për t’i mbrojtur këto.

Pritat

Pritat kanë qenë një pikë mbështetëse e taktikave të rebelëve afganë që nga koha e luftimeve ndaj sovjetikëve në vitet 1980-1990. Afganistani është një vend me popullatë tepër të shpërndarë dhe me rrugë shumë të këqija. Linjat e gjata dhe të shtrira të komunikimit të Koalicionit përbëjnë një objektiv të lehtë për talebanët. Që nga 2001, talebanët kanë përdorur një sërë taktikash të pritave ndaj patrullave në mjete të lëvizshme ose në këmbë, në malet e zhveshur dhe në luginat e harlisura. Pjesa

më e madhe e pritave ishin godit-dhe-largohu, që zgjasnin jo më shumë se 30 minuta. Ndonjëherë, shumë të tilla zgjasnin për orë. Rebelët në vazhdimësi përdornin zbulues për të vrojtuar lëvizjen e forcave të Koalicionit. Vrojtuesit e pararojës shpesh raportonin të gjitha detajet e një autokolone, që kishin të bënin me llojet dhe numrin e automjeteve, prania e kontrolluesve ajrore, nëse autokolona transportonte artileri dhe detaje të tjera. Për shembull, rebelët që qëndronin në pritje në luginën Gulistan në Farah në vitin 2007, dukej se e dinin që nuk kishte mundësi të kishte mbështetje nga ajri, duke ju dhënë atyre kohë të mjaftueshme për të sulmuar, manovruar mbi objektivat e tyre. Rebelët dinin gjithashtu itinerarin që do të merrte autokolona dhe se kur do të mbërrinte në destinacion. Rebelët i kanë mbajtur patrullat e ISAF-it në Provincën Helmand nën vrojtimit të vazhdueshëm. Si rrjedhojë, për forcat britanike ishte thuajse e pamundur që të shfrytëzonin elementin e surprizës. Gjatë vitit 2006, në shumë zona të Helmandit në vitin 2006, ishte fakt i pranuar se nëse një patrullë qëndronte më shumë se dhjetë minuta në ndonjë vend, do të sulmohej. Celulat që vendosnin IED-të në zonën e kultivuar të luginës të lumit Helmand mbështeteshin shumë mbi zbuluesit e pararojës, të cilët gjurmonin lëvizjet e patrullave këmbësore britanike dhe jepnin sinjalin për shpërthim në kohën e duhur. Talibanët kanë mbajtur nën vrojtimit gjithashtu, edhe aerodromet e vegjël; rebelët shpesh e dinin nëse do të vinte mbështetje nga ajri dhe sa kohë do të duhej të mbërrinte. Duke filluar që nga viti 2005, zbuluesit e pararojës pranë Aerodromit të Kandaharit (KAF) mbanin shënim të gjithë avionët që ngriheshin dhe uleshin aty. Talebanët tentonin të lajmëroni civilët përpara se të ndërmerrenin prita pranë zonave të banuara. Civilët që largoheshin, banorë fshatrash ose kur tregjet zbrazeshin zakonisht tregonin për një sulm të afërt, që disa herë pasohej nga njerëz me moshë mesatare për të luftuar të cilët vinin në zonën e luftimit në rimorkio makinash ose me motoçikleta. Kjo ishte më e rrallë në qytetet në të cilat talebanët kishin më pak mbështetje dhe nuk kishin zbulues të tjerë, por që nuk ishte e padëgjuar. Në qytetin e Kandaharit në vitin 2008, rebelët njoftuan popullatën aty pranë një natë përpara se të sulmonin Burgun Sarpoza, megjithatë, fjala nuk mbërriti deri tek policia ose forcat kanadeze. Kurse ndryshe nga këta, trafikantët e drogës, të shqetësuar më shumë për të mbrojtur rrugët fitimprurëse të trafikimit sesa për të siguruar mbështetjen popullore, kishin tendencën të mos shqetësoheshin shumë për lëndimin e civilëve. Pjesa më e madhe e pritave fillonte me një breshëri të granatë-hedhësve (RPG-ve), e ndjekur nga zjarri i armëve të lehta. Në pjesën më të madhe të sulmeve, rebelët ndërprisnin kontaktin përpara mbërritjes së mbështetjes ajrore (megjithëse në raste të pakta, ata kanë luftuar ndaj sulmeve ajrore). Viktimat, nëse kishte të tilla, shkaktoheshin gjatë minutave të para të luftimit. Në pjesën më të madhe të incidenteve, secili rebel e njihte mirë rolin e

tij dhe rrugën e shpëtimit; të gjitha detajet ishin diskutuar shumë kohë më parë për të reduktuar nevojën e komunikimit përpara ose gjatë luftimit. Sinjali për të hapur zjarr ishte zakonisht një e shtënë me RPG e qëlluar nga udhëheqësi i grupit. Ndërkohë që ndaj talebanëve u shtua presioni në vitet 2007-2008, ata nga ana e tyre shtuan përdorimi i minave të improvizuara shpërthyes (IED-të). Kur përdornin IED-të në një pritë, talebanët shkrepnin pajisjen, pastaj lëshonin një breshëri me RPG dhe tërhiqeshin nën mbrojtjen e armëve të lehta. Kjo ishte një taktikë standarde për celulat të cilat vendosnin IED-të të cilat operonin në luginën e Lumit Helmand. Kjo ishte gjithashtu e zakonshme në malet e Kandaharit verior, atje ku dhe ka qenë një nga zonat ku ka vepruar me shume sukses misioni "Eagle-1" në vitet 2010-2011 gjatë operacionit "Mountain run". Një taktikë me IED e përdorur shpesh ishte që një informator i paarmatosur në pararojë ("dicker" në zhargonin britanik) që i jepte sinjal shkrepësit të pajisjes, i cili ishte i fshehur, që të shpërthente IED në momentin kur ajo mund të shkaktonte më shumë dëme gjatë kalimit të trupave të koalicionit. Në Sangin, ka pasur raste të IED-ve të gërmuara në formën e margaritës në muret e qerpiçit në lartësinë e belit, që ishin të drejtuara ndaj patrullave të këmbësorisë. Pjesa më e madhe e sulmeve me IED ndaj trupave britanike ishte kundër patrullave këmbësore. Disa IED u shpërthyen nëpërmjet telave të gjatë që i kalonin 100 metrat, përmes ndërtesave dhe fushave deri tek shpërthyesi i cili ishte i fshehur mjaft mirë. Rebelët afganë shpesh manovruan duke ju marrë krahët ose duke rrethuar forcat e Koalicionit, zakonisht të mbuluar me zjarr. Ata gjithashtu, ndërronin pozicionet kur ishin nën zjarr. Kur luftonin për më shumë se dhjetë ose pesëmbëdhjetë minuta, talebanët kishin prirjen të përdornin të paktën zjarr dhe manovra në të njëjtën kohë. Shumë prej tyre demonstuan një njohje të mirë të taktikave bazë të këmbësorisë. Gjatë një pritë të zgjatur në fshatin Shewan, në provincën Farah në vitin 2008, rebelët i morën krahët një patrulle

të madhe të ushtrisë së SHBA-së dhe afgane duke u mbuluar nga zjarri i mitralozave të vendosur nga një grup mbështetjeje në vende të fortifikuara. Shpesh, rebelët afganë përdorën pritat në formë L-je, duke vënë në përdorim dy vija të pozicioneve të zjarrit, njëren përballë dhe njëren në krahë. Ka pasur raste kur luftëtarët e armikut kanë ndjekur autokolonat pas një pritë. Në luginën Gulistan të Farah, në vitin 2007, rebelët ndoqën një autokolone të ushtarëve të SHBA dhe afganëve në tërheqje, i rrethuan ata në një nënkalim, dhe shkakuan viktima të shumta. Në Sheëan në 2008, luftëtarët armiq i zunë pritë një autokolone të Marinsave të SHBA, e ndoqën autokolonën që largohej për disa kilometra, e rrethuan atë ndërsa po rigrupohej jashtë qytetit pasi një togë e Marinsave bastisi një fabrikë prodhimi të IED-ve të rebelëve në veri të Now Zadit në vitin 2008, rebelët i ngritën pritë patrullës disa herë ndërkohë që udhëtonte në kthimin për në bazë. Pasi ju ngritën pritë kësaj skuadre të Marinsave në Shewan në korrik të 2008, rebelët e ndoqën autokolonën që tërhiqej, e rrethuan atë në një pikë policore të kontrollit dhe shkakuan shumë dëme në njerëz dhe materiale. "Karremi dhe pritat" janë një taktikë e zakonshme. Rebelët do të hapnin zjarr mbi një patrullë, pastaj largoheshin, duke i tërhequr forcat e Koalicionit drejt një pritë të para-përgatitur. Në Daulatabad në provincën Farah në vitin 2008, një grup rebelësh hapën zjarr kundër një autokolone të Marinsave dhe pastaj u tërhoqën në jug, nëpër disa fusha. Marinsat dolën nga mjetet e tyre dhe u vunë në ndjekje. Pas kësaj ata u sulmuan nga një pritë e afërt shkatërruese nga të dyja anët. Në të njëjtin vit, në qytetin e Shewan, rebelët shtinë mbi një togë Marinsash, pastaj u larguan në perëndim drejt një llogoreje plot me luftëtarë armiq. Patrulla i ndoqi dhe u ndalua nga një zjarr i rëndë. Në Gulistan, në 2007, rebelët pushtuan qendrën rajonale në mënyrë që të tërhiqnin një forcë të reagimit të shpejtë në luginën e largët. Më pas rebelët u hodhën më një pritë shkatërruese.





Perandori me
originë ilire,
Justiniani i Madh

Me fytyrë nga ai Perëndim, të cilin dikur e krijuam ne...

Kryengritja më e madhe e ilirëve, që e rrezikoi seriozisht Romën, është kryengritja e Batos. Nëse nuk do të kishte dështuar për shkak të tradhtisë, për punë ditësh Roma do të binte në duart e kryengritësve ilirë. Liburnët, kaonët, japodët, dalmatët, dardanët etj ishin një "kockë" e papërtypshme për legjionet romake. Me rënien e brigjeve ilire dhe fashitjen luftërave të përgjakshme shekullore, ilirët u bënë pjesa kryesore e kastës ushtarake romake. Legjionet romake i bënëin rekrutimet kryesisht nga viset ilire. Arsyeja për këtë gjë ishin tiparet e spikatura ushtarake që kishin ilirët. Këta legjionarë, ushtarë të thjeshtë romakë, arrinin falë aftësive të tyre të dallueshme që të bëheshin deri edhe Perandorë. Në pjesën e fundit të ekzistencës së Perandorisë Romake, ishin ata që u quajtën asokohe "Genii Illyrici", shpëtimtarët e Romës. Perandorët romakë me origjinë ilire, si Diokleciani, Aureliani, Kalud Gotiku, Probi, Maksimiani, Konstandini i Madh, Juliani, Valentiani i Madh, Joviani, Justiniani i Madh, etj, etj, qeverisën thujse për dy shekuj Romën, zgjeruan ku-

fijtë e saj deri në caqet më ekstreme, vendosën ekuilibër të brendshëm, zbrapsën sulmet e barbarëve, vunë në jetë reforma politike të padëgjuaara më parë, lejuan shpërhapjen e fesë së Krishterë etj. Është kontributi, ndikimi dhe roli i tyre, që Perandoria u fuqizua në dy qendra: Lindje dhe Perëndim. Koncepti "Lindje-Perëndim", lindi falë tyre. Në këtë mënyrë ata ndryshuan fatet e Botës, një herë e përgjithmonë. Ishte koha kur paraardhësit e shqiptarëve, shtriheshin nën Danub, më at' anë e këtë anë të Adriatikut e deri në Dardanele, koha kur shqiptarët ishin Perëndimi. Perandoritë e mëpasme, Bizanti e ajo Osmane, patën një zinxhir të tërë ushtarakësh, perandorësh, vezirësh e krye-vezirësh shqiptarë: spikaste përsëri talenti i lindur ushtarak. Ky përshkrim fare i shkurtër që bëra, është një ngacmim prej studimit "Me fytyrë nga Perëndimi", të Prof. Dr. Proletar Hasanit dhe Dr. Edit Kane, për ushtarakët shqiptarë të diplomuar në vitet '13-'44, në Perëndim, në atë Perëndim që dikur e themeluan si koncept paraardhësit e tyre.

Albert Hitoaliaj



Bijtë tanë i duan,
"fshatin" e tyre, jo!



Arsimimi i oficerëve në shtetin e ri
shqiptar, me orientim perëndimor



Me fytyrë
nga Perëndimi

Bijtë tanë i duan, "fshatin" e tyre, jo!

NGA PANO HALLKO

Tetë vjet më parë, u lumturova kur mësova se Gjeneralmajor Ernest Jakova banonte në Durrës, atje ku kaloja pushimet. "Ktheva qiell e dhé", e gjeta, dhe në ballkonin e katit të dytë të godinës nr.8, për tre ditë rresht, "e mola" mirë. Ajo që më intrigonte qysh para se ta njihja, ishte fakti se ai pat mbaruar vitin e dytë në Akademinë e Aviacionit në Itali. E la shkollën si i ri antifashist dhe erdhi e luftoi në vendin e tij, kundër fashizmit. Kuptohet, ai në vitet '50 mbaroi Akademinë e famshme "Voroshilov"-më e madhja e kohës në botë. Ajo Akademi, diplomonte, Komandantë Armate! Gjeneral Jakova shkoi në Itali në mes-vitet '30-të, sepse për fatin e tij babai i vet, ishte mobilieri më i mirë i Shkodrës. Ish-mbreti i vetëshpallur, kishte vendosur që të bënte vilën e tij në Burgajet, ku kishte ardhur familja e tij rreth 150 vjet më parë. Kuptohet, interesoheshin sejmënët e tij, edhe për, fëmijët e argatëve. Shqipëria si "depozitë" nga ku mund të përzgjidheshin djem për t'u bërë ushtarakë, kishte kohë që shikohej nga Perëndimi, e kur themi kohë, nënkuptojmë dhjetëra shekuj. Për fat të mirë të tyre, ata na njihnin ne më mirë sesa e njohim ne veten sot, pa lere atëherë. Në majin e vitit 1408, Senati i Venecias e shpalli Gjon Kastriotin "Qytetar Nderi të Venecias". Papa Eugeni i IV-t, e priti Gjonin në Vatikan, ku edhe i premtoi ndihmë në luftën kundër turqve. Gjoni, e pranoi me mirësjellje ndihmën, duke përqafuar besimin e Papës. Por kur iu desh ndihma e Papës, shumë vite pas kthimit në At-dhe, përgjigja e Vatikanit ishte se "Papa do t'i lutet Zotit për mbarësinë e ecurisë së luftës kundër pushtuesve turq!" Thënë alla Migjeniançe... "Zoti të dhashtë"! Kurse Venecia, pranoi të ndihmonte me "krëk" këtë luftë. Në pranverën e vitit 1415, Gjon Kastriotin e gjeti një tjetër gjëmë. Pasi Stambolli i pat marrë peng djalin e madh, atë vit i mori peng edhe djalin e vogël, Gjergjin nëntë vjeçar! Ky i fundit, do të shkollohej në shkollën e zgjedhur elitë "Ic Oqllan", e cila jo vetëm nuk kishte arsye për zili, por qëndronte shumë më lart sesa shkollat ushtarake të Perëndimit të asaj kohe...Jo rastësisht Gjergjin tonë e mbiemëruan Iskander-Aleksandër. E ai u bë në të vërtetë një Aleksandër i kohës së vet. Por, në vitin 1456, Skënderbeut i vdiq "krahu i djathtë" në luftën kundër otomanëve, mbreti Janosh Huniadi. Po atë vit, "iu tha" edhe krahu i majtë: Nipi i tij i dashur Hamzai dhe Gjergj Balsha, të cilët me paratë e spiunëve të Portës, kaluan

në shërbim të sulltanit! Përkatësisht, në vitet 1926 deri në vitin 1938, vit kur kriza italo-shqiptare kishte kapur kulmin, sipas të dhënave që vijnë nga burime dokumentare italiane të asaj kohe, në Itali kishin studiuar afro 140 studentë ushtarakë shqiptarë. Në vijim, deri në prag të prillit 1939, ishin edhe 180 të tjerë shqiptarë që studionin në to. Prej tyre 167 ndoqën mësimet në Akademinë Ushtarake të Fanterisë (Këmbësorisë) dhe Kavalerisë (Kalorësisë) në Modena. Por ushtarakët tanë i tradhtoi "Komandanti i Përgjithshëm i tyre", i cili pat dhënë Urdhër, që "T'u hiqen shulat pushkëve, e të hidhen në det"!!! Në vitin 2006, në Gjermani u zhvillua një stërvitje e madhe shumëkombëshe, me mijëra trupa. Ish-Shefi i Shtabit të Gjermanisë asokohe, i tha ish SHSHP të FASH, gjeneraljejtënant Pëllumb Qazimit: "-Zoti Gjeneral, merrni drejtimin e Stërvitjes!" Gjeneral Qazimi me modestinë që e karakterizonte, i tha: "Ndoshta nuk jam unë personi i përshtatshëm, pasi i takoj Shkollës Ushtarake të Lindjes... - Po pse ne perëndimorët, çfarë mendoni se kemi studiuar? - iu përgjigj jo pa alarm gjermani..." Duket se Perëndimi ka qenë i interesuar më shumë për materialin gjenetik të këtij kombi, sesa për fatet e vetë atij. Këto të shkojnë ndërmend, teksa njihesh me hezitimin e Perëndimit për të pranuar Shqipërinë, më së paku si...kandidate! E ajo që ngre krye zyrtarisht e "nën zë", është se, qenkemi vend mysliman! Ata e dinë mirë se ç'tha Gjon Kastrioti në vitin (jo aq) të largët 1408... "Zoti është një për të gjithë. Fé ka shumë, e njeriu ka të drejtë t'i besojë të gjitha, ose asnjë prej tyre". Prandaj titulli i shkrimit perifrason shprehjen e goditur nga filmi "Zonja nga Qyteti"... Edhe Mehmet Pashë Dërralla, edhe Ali Shefqet Shkupi, edhe Ali Rizai, edhe Spiro Moisiu, edhe qindra të tjerë, në perëndim u arsimuan si ushtarakë. Shumicën e tyre, ose i hëngri "nana e tyne", ose "paratë e dushmanit"! Libri i Prof. Dr Proletar Hasanit, është kontribut madhor për ndriçimin e arsimimit të ushtarakëve shqiptarë ndër vite, por Profesori ka detyrimin e nderit të shkruajë një libër tjetër. Në të cilin të shpjegojë arsyen: Përse vendi ynë, sot e shumë vjet, nuk ka një shkollë të mirëfilltë ushtarake ku të ngjizë dhe të përgatitë ushtarakët e tij?! Kualifikimet, le t'i kryejnë jashtë. Ashtu siç në gjithë vendet e botës, xhanëm. Nuk do të ishte herëzi kjo, por kontribut kombëtar. E Profesori i ka, edhe tagrin, edhe kompetencën profesionale, edhe guximin intelektual, për ta bërë këtë...Urimit më të mira, nga lexuesi-shkrues, që "firmos" në krye të shkrimit...

Arsimimi i oficerëve në shtetin e ri shqiptar, me orientim perëndimor

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Në kuadrin e 101 vjetorit të shtetit shqiptar, Prof. Dr. Proletar Hasani dhe Dr. Edit Kane përgatitën dhe botuan librin "Me fytyrë nga perëndimi". Libri i kushtohet arsimimit të ushtarakëve shqiptarë në perëndim në vitet 1913-1944. Botimi i tij është një arritje e re e historiografisë ushtarake dhe hedh dritë në arsimimin dhe përgatitjen e oficerëve shqiptarë nga fillimi i shek. XX. Në tërësinë e tij libri është një kontribut me vlera për historinë shqiptare, për të njohur këtë rrugë të bërë për arsimimin ushtarak këtu e një shekull më parë. Autorët theksojnë se nga fillimi i viteve '20 të shek. XX, në vend pothuajse nuk kishte ende gjurmë të ndonjë shkolle ushtarake të mirëfilltë apo të struk-

turave të tjera të arsimimit ushtarak kombëtar. Në libër jepen të dhëna se në ndonjë qytet shqiptar të veçuar ishte ngritur, por vetëm përkohësisht, në kohën e pushtimit dhe të pushtetit osman-turk dhe kryente veprimtarinë ndonjë shkollë e ultë ose e mesme ushtarake. Një e tillë ishte ngritur në qytetin e Shkodrës në fillim të viteve 1900 nga pushtetarët osmanë. Në një nivel më të ulët, vilajet kishte dy ru-zhdije (shkolla) ushtarake, njëra në Shkup dhe tjetra në Prizren. Ndërsa studiuesja franceze Nathalie Clayer sjell të dhëna për një institucion të tretë të hapur në qytetin e Gjakovës pas revolucionit xhon-turk. Por, autorët sjellin edhe një fakt, se një shkollë ushtarake mjaft e njohur për kohën në tërë rajonin e Ballkanit, ishte hapur dhe vepronte që herët në qytetin shqiptar, Manastir, si dhe një tjetër ishte në Selanik. Në këto shkolla mësuan dhe u edukuan disa ushtarakë të njohur shqiptarë, të cilët pas përfundimit të studimeve në akademitë ushtarake të Stambollit patën një karrierë të shkëlqyer ushtarak. Nëpërmjet faqeve të librit shpalosen përpjekjet që janë bërë nga shteti shqiptar për të ngritur shkolla ushtarake, edhe pse të thjeshta e fillestare, nga qeveritë lokale gjatë Luftës së Parë Botërore, por dhe pas përfundimit të saj. Përpjekje të tilla identifikohen në qytetin e Shkodrës, me mbështetjen e ushtarakëve të komandës austro-hungareze dhe në ndonjë zonë tjetër të Shqipërisë. Një përpjekje me ngjyrim kombëtar ka ndodhur në vitin 1919, në kohën e qeverisë së Përkohshme të Durrësit. Këto ishin përpjekje dhe mbetën të vetmuara e as që mund të bëhej fjalë për një sistem arsimor me shkolla apo institucione të tjera përkatëse kombëtare. Libri, i cili është i ndarë në disa kapituj që trajton probleme të tilla si: oficerë shqiptarë të shkollës ushtarake turke, deri në vitin 1912, kur u shpall Pavarësia dhe u krijua shteti i parë i pavarur dhe qeveria e tij, por edhe më tej, më saktë për të vazhduar deri në prag të viteve '20 të shek. XX. Shqipëria nuk kishte asnjë mundësi praktike që të përgatiste ushtarakë, oficerë dhe nënoficerë në vend.



Safa Syrja Vlora

Kjo ndodhte për një arsye fare të thjeshtë. Atë kohë ajo nuk kishte ushtri dhe, për rrjedhojë, as shkollë ushtarake kombëtare, në të cilën të mund të arsimonte dhe të formonte ushtarakë, të cilët do të shërbenin për qëllime mbrojtëse të vendit dhe të popullit shqiptar. Për këto motive, e për pasojë dhe për fat të keq, nuk mund të realizohej në Shqipëri, në ato vite, por edhe gjatë viteve '40 të shek. XX, as edhe kualifikimi i ushtarakëve nëpër akademi apo shkolla të larta pas akademike. Arsyet ishin po ato të mësipërmet, thjesht nuk kishte institucione arsimore të përmasave dhe niveleve kombëtare. Për këto shkaqe, në ato vite, të fillimeve të Fuqive të Armatosura Shqiptare, të ideuara dhe të krijuara me nismën dhe mbështetjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, u formua më 4 Dhjetor të vitit 1912, vit dramatik dhe historik njëherësh për shqiptarët, Ushtria. Masa më e madhe e ushtarakëve shqiptarë vinin nga shkolla ushtarake dhe nga radhët e ushtrisë turke. Nga kjo ushtri dolën dhe u vunë në shërbim të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dhe të Xhandarmërisë në formim e sipër, afro 70 oficerë dhe 150 nënoficerë. Midis tyre në faqet e historisë ushtarake shqiptare u shkruan emrat e shumë prej drejtuesve më të lartë, por edhe të komandantëve të njësive kryesore ushtarake të këtyre viteve, por dhe më pas. Shumica dërrmuese ishin produkt dhe prurje e shkollës ushtarake turke, jo pak të njohur dhe produktive deri në këto vite. Pikërisht nga radhët e saj vinin ata që hodhën themelet e Ushtrisë, të Xhandarmërisë dhe të institucioneve të tjera historike, ministri i Luftës (Mbrojtjes Kombëtare) në Kabinetin e Qeverisë së Vlorës të kryesuar nga Kryetari i saj Ismail Qemali (Vlora), gjeneralbrigade Mehmet Pashë Dërralla (Tetova). Ai pasohej nga një tjetër personazh i njohur i botës ushtarake të pas vitit 1913, Kryetari i Shtabit të Parë Madhor (Madhner) të Ushtrisë Shqiptare, qysh në krijimin e tij, më 4 Maj 1913, me qendër në Vlorë, majori Ali Shefqeti (Shkupi). Më tej autorët theksojnë se kësaj plejade personazhesh historike ushtarake u bashkohen edhe emrat e ushtarakëve shumë të njohur, gjeneralbrigade Esat Pashë Toptani; gjeneralbrigade Ali Riza Kolonja; kolonel Selaudin Said Shkoza; major Mustafa Maksuti (Shehu); kapiten Zija Dibra; nënkolonel Shefik Kosturi; kolonel Ismail Haki Tatzati; kolonel Mustafa Aranitasi; kolonel Kasem Qafëzezi; nënkolonel Rexhep Shala; gjeneral-divizioni Xhemal Aranitasi; gjeneral-divizioni Aqif Përmeti. Këta ushtarakë, nga më të lartët e Ushtrisë Shqiptare të viteve 1910-1944, kryen detyra madhore, qysh në çastet e para të krijimit të Ushtrisë Shqiptare, në fillim të Dhjetorit 1912 dhe më pas gjatë ecurisë dhe veprimtarisë së saj afro tridhjetëvjeçare. Madje, të gjithë këta personalitete të historisë ushtarake shqiptare ishin drejtues kryesorë, ministra të Mbrojtjes Kombëtare (të Luftës) pikërisht gjatë gjithë këtyre viteve. Përkrah këtyre personaliteteve, në drejtimin e një hallke të lartë organizative dhe drejtuese të Ushtrisë, siç ishte Shtabi Madhor (i Përgjithshëm) shërbyen ndërkohë, edhe një grup tjetër ushtarakësh të



Ali Ohri

shquar shqiptarë, që vinin gjithashtu nga shkolla ushtarake turke. Këtë grup e printe Kryetari i parë i Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare, të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës (1912-1914), major Ali Shefqeti (Shkupi). Pas tij erdhën major Xhavid Leskoviku; major Bajram Fevziu, të cilët u përpoqën që të krijonin dhe t'i jepnin këtij organizimi të rëndësishëm ushtarak, një fizionomi dhe fytyrë sa më bashkëkohore dhe aktive. Në këtë kapitull autorët përshkruajnë figura ushtarakësh që kryen detyra të larta në hierarkinë e forcave ushtarake shqiptare, sidomos që prej 4 Dhjetorit 1912 deri në vitin fatal 1939! Siç do të gjeni gjatë leximit të librit këta oficerë mbanin, duke filluar nga grada më e ulët nëntoger deri tek ato më e larta në Ushtrinë Shqiptare, gjeneral-divizioni. Dhe kjo nuk ishte pak për një vend me një popullsi të vogël, prej 1.062.684 banorë, që nxirrte një forcë prej afro 10.000 ushtarakë, 700 prej të cilëve ishin oficerë. Kjo shifër ishte pothuajse e barabartë me afro 1 për qind të krejt popullsisë të Shqipërisë së asaj kohe. Njëherazi, trajtojnë autorët, në këtë galeri personalitetesh të lartë ushtarakë, të ardhur po nga shkollat dhe akademitë ushtarake turke, u vunë në shërbim të Ushtrisë Shqiptare dhe shërbyen me përkushtim në të, në harkun kohor 1912-1913, edhe ushtarakë të tjerë shqiptarë. Numri i tyre ishte i konsiderueshëm. Ndër ta ishin oficerët Ali Fehmi Kosturi, major Banush Hamdiu, kapiten Ali Tetova, major Hysen Hysni Prishtina, toger Ahmet Bejtaga, Kamber Sejдини, Haki Korça, Sali Ohri, Bexhet Ohri, kapiten Et'hem Vlora, toger Meleq Frashëri, major Shefqet Kosova, Tajar Tetova, Hasan Stafa, Hamid Kuçi, major Ismail Kuçi, Mustafa Spathara, Ramiz Dibra etj. Pamja që krijohet nga të dhënat lidhur me përbërjen e oficerëve, në një masë dërrmuese dhe nënofi-



cerëve shqiptarë, deri në fillimin e viteve '20 të shek. XX, dëshmon se ata i përkisnin dhe vinin nga dyert e shkollave dhe të akademive ushtarake turke. Edhe në këto vite, vetëm një numër ende i pakët ushtarake shqiptarë ishin produkt i shkollave ushtarake europerëndimore, kryesisht italiane dhe austriake. Korpusi i madh i ushtarakëve shqiptarë në harkun kohor 1912-1939, pavarësisht shkollës së cilës i përkisnin e cila, gjithsesi, mbetej një shkollë me traditë dhe emër, i dhanë një ndihmesë dhe shërbim të paçmuar ngritjes dhe organizimit të Ushtrisë Shqiptare, veçanërisht në fillimet e saj. Por, pas mesit të viteve '20 të shek. XX, ashtu si në tërë shoqërinë dhe jetën shqiptare, edhe në Fuqitë e Armatosura të saj, kishin filluar të ndiheshin e të frynin gjithnjë e më shumë erëra dhe fryma perëndimore. Vërehej prirja për t'u orientuar drejt perëndimit, në përpjekje për t'u shkëputur nga tradita dhe realiteti tashmë monoton dhe i prapambetur lindor i deriatëhershëm! Për rrjedhojë edhe ecuria e këtyre forcave dhe, veçanërisht arsimimi dhe kualifikimi i oficerëve shqiptarë, u orientuan për herë e më shumë nga shkollat dhe akademitë ushtarake të disa vendeve të Evropës perëndimore. Kjo shënoi një erë të re në historinë e shkollës dhe, përgjithësisht të historisë ushtarake shqiptare, e cila do të kishte ndikimet e veta në tërë ecurinë organizative dhe veprimtarinë e Ushtrisë Shqiptare të viteve '20 -'40 të shek. XX. Njëpërmjet një kreu të veçantë i cili bën fjalë për arsimimin ushtarak midis lindjes dhe perëndimit përshkruan periudhat e viteve 1913-1915, me tej libri në mënyrë të detajuar shkon më në detaje drejt shkollave të perëndimit dhe konkretisht në Itali në vitet 1925-1943, ku jepen të shtjelluara kolegjet, akademitë dhe shkollat në Itali si: të Romës, Napolit, Modena, Torino, Kazerta dhe Livorno. Një kre më vete pasqyron shkollat dhe akademitë ushtarake në Austri, Francë dhe Greqi, ndërsa një kre interesant është ai që përshkruan ushtarakët shqiptarë të karrierës në rrjedhat e fatit të tyre. I pajisur dhe me fotografi të personazheve kryesorë, libri bëhet dhe më interesant, me tej jepen pasqyra me të dhëna, listë emërore e detajuar, si dhe burimet e studimit të këtij libri gjithëpërfshirës për ushtarakët e kësaj periudhe. Autorët në libër theksojnë se shkollat ushtarake me karakter kombëtar u themeluan në Shqipëri vetëm pas vitit 1920, të cilat synuan të plotësonin nevojat e ushtrisë dhe të strukturave të tjera ushtarake të shtetit shqiptar të këtyre viteve me ushtarakë të niveleve të ndryshme. Deri në mesin e viteve njëzet (1920-1925), oficerë me gradat madhore, major e lart përgatiteshin dhe kualifikoheshin kryesisht në akademitë dhe shkollat ushtarake turke, mjaft të njohura të atyre viteve. Por, që pas vitit 1918 dhe më saktë, gjatë vitit 1921, u duk nevoja dhe prirja apo tenden-



ca, që kishte nisur të mbizotëronte edhe në qarqet e larta ushtarake shqiptare të studimeve drejt perëndimit. Pas janarit 1925 u zyrtarizuan të gjitha qëllimet dhe përpjekjet për shkollim dhe kualifikim të ushtarakëve kryesisht në Itali, por mbeti e hapur dhe tërësi edhe në shkollat perëndimore si të Austrisë, të Francës, por më rrallë dhe të Greqisë e pastaj të Turqisë. Për këto arsye në shkollat dhe akademitë ushtarake të Italisë janë më të gjata listat me emrat e nxënësve, të studentëve dhe të oficerëve shqiptar, që studiuin në atë kohë. Përgatitja dhe formimi profesional i shqiptarëve në shkollat dhe akademitë pati rëndësi dhe vlera shumëpaleshe për Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura. Parë në plan më të gjerë, me përmasa kombëtare, edukimi i brezave të këtyre ushtarakëve me koncepte dhe aftësi moderne, solli ndihmesë të dukshme në riorganizimin dhe reformimin e vet ushtrisë dhe strukturave të tjera të FA (Armata) shqiptare, sipas modeleve të kohës, të rregullta dhe më pak të kushtueshme, por edhe të afta e të pajisura me aftësi për të bashkëvepruar me ushtritë e tjera, në pikëpamje konceptuale dhe në veprimtarinë profesionale ushtarake të mirëfilltë. Autorët theksojnë se duhet vlerësuar e rivlerësuar në traditë ndihmesa dhe përvoja që sollën dhe përcol- lën me karrierën dhe punën e tyre, ushtarakët shqiptarë, që u shkolluan në shkollat e huaja ushtarake. Ata, në masë, ndikuan në këto aspekte të shquara dhe të rëndësishme ushtarake, por dhe disa prej tyre, veçanërisht

u bënë propagandistë dhe aktorë të rëndësishëm në periudhat pasuese të historisë së vendit dhe të asaj ushtarake në veçanti. Më të shquarit mes tyre ndikuan edhe në zhvillimet e Luftës Antifashiste në Shqipëri, në krijimin dhe drejtimin e veprimeve dhe formacioneve luftarake çlirimtare shqiptare, ashtu si dhe pas çlirimit të vendit. Në libër theksohet se pavarësisht cila ishte rrjedha dhe ecuria e tyre e karrierës dhe e jetës, secili prej këtyre ushtarakëve ka menduar dhe është përpjekur t'u shërbejë njerëzve dhe atdheut të tij. Libri ka vlera aktuale sepse pasqyron gjithë dinamikën e kujdesin e shtetit shqiptar për arsimimin dhe përgatitjen e kadrove ushtarak për të qenë elita e ushtrisë dhe e shtetit shqiptar. Autorët kanë meritën e madhe që pas kësaj pune do të thosha të vlerësuar, të na japin një tablo të plotë për veprimtarinë mësimore dhe edukative të këtyre ushtarakëve që bënë gjithçka, për të mësuar dhe shkëlqyen si akademikë e shpalosën vlerat atdhetare dhe patriotike të popullit shqiptar. Autorët studimin e kanë shtrirë nga viti 1912 deri më 1944. Ata po punojnë dhe për të dy periudhat e tjera të shtetit shqiptar, të arsimit ushtarak, të periudhës së monizimit, si dhe të periudhës së demokracisë nga vitet '90 i shek. XX dhe deri në vitin 2012.

STUDIMI

Me fytyrë nga Perëndimi

PROF. DR. PROLETAR HASANI
DR. EDIT KANE

Fillesat e shkollave ushtarake

Shkolla ushtarake shqiptare në fillesat e shtetit të ri shqiptar, mbeti në nivelin e një shkolle modeste. Më i konsoliduar arsimit ushtarak shqiptar paraqitej në nivelin e parë, ku përfshiheshin kryesisht përpjekjet për të hapur, përforcuar dhe perfeksionuar institucionet dhe programet mësimore të tyre. Në këtë kuptim, në të bënte pjesë arsimimi në nivelin e shkollave me programe teoriko-praktike nga gjashtëmujore deri njëvjeçare, në të cilat përgatiteshin dhe diplomoheshin oficerë me gradën aspirant deri nëntoger. Këto shkolla, pas një sprove në periudhën 1919-1924 dhe, sidomos, deri aty nga viti 1923, kohë kur ato u hapën me ndërprerje, herë pas here, në përputhje me nevojat e Ushtrisë dhe Gjindarmërisë Shqiptare, nisën të përforcoheshin dhe fituan karakter të qëndrueshëm dhe të përhershëm. Madje, në vitet 1925-1926 dhe në vijim, shkollat e Aspirantëve nisën të krijonin një përvojë dhe traditë të re. Në ato vite, përveç shkollës për Aspirantë të Këmbëorisë, u çelën dhe funksionuan me sukses shkolla edhe sipas disa llojeve të armëve e trupave. Të tilla ishin Shkolla për Aspirantë të Artilerisë, Xhenios

dhe Intendencës. Madje përpjekje u bënë edhe për një të tillë për Aspirantë të Marinës Ushtarake. Ndërkohë, fillimi i viteve Tridhjetë, për shkak të nevojave që Ushtria dhe Xhandarmëria Shqiptare kishin për të përballuar ecurinë e oficerëve të niveleve të ndryshme në gradë, diktoi domosdoshmërinë e një shkolle me programe afatmesme. Kësisoj lindi dhe u promovua Shkolla e Perfeksionimit të Oficerëve, më pas dhe e Nënoficerëve. Në të njëjtën kohë me to, vëmendjen e tërhoqi edhe arsimimi plotësues apo ndryshe ai i oficerëve rezervë, i cili mori përmasa të dukshme dhe u zyrtarizua, gjithashtu me fillimin e viteve Tridhjetë të shekullit të shkuar. Për këtë qëllim ky arsimim, nëpër të cilin u bë e detyrueshme të kalonin pothuajse tërë punonjësit e administratës së shtetit dhe ata që kishin studjuar në universitete apo shkolla të tjera të larta, brenda apo jashtë vendit, u ideua dhe u ngrit një shkollë e veçantë. Ajo u emërtua Shkolla e Nxënës-Oficerëve të Plotësimit e cila, pak kohë më pas, u pasua edhe nga ajo për Nënoficerët. Në prag të pushtimit fashist, në Shqipëri ishin çelur dhe ushtronin veprimtarinë e tyre disa shkolla për edukimin dhe përgatitjen e ushtarakëve shqiptarë. Por, gjithsesi këto shkolla, me një kufi kohor dhe programor të

kufizuar, e kishin të pamundur që të edukonin dhe kualifikonin oficerë sipas niveleve të kohës, me dije dhe të aftë profesionalisht, për t'u përballur me kërkesat e artit ushtarak, të teknologjive dhe të armatimeve të përparura të atyre viteve. Madje, në to ishte e pamundur që të jepeshin në shkallën e duhur as edhe elementët e një kulture të përgjithshme, të domosdoshme për shoqëritë e përparuara euro-perëndimore të asaj kohe. Nga ana tjetër, ndërtimi dhe vënia në punë e një rrjeti skol-





Njazi Çarçani
me uniformë
piloti, Itali

lash të larta ushtarake për arsimimin dhe kualifikimin e oficerëve shqiptarë në vend ishte një barrë tjetër e madhe dhe e kushtueshme për Shqipërinë e vogël dhe të varfër të asaj periudhe. Ndërkohë, ngritja dhe vënia në lëvizje e akademive dhe shkollave të kualifikimit pas-akademik kërkonte edhe përgatitjen e stafëve, me drejtues dhe pedagogë të aftë profesionalisht. Për këto arsye, në Shqipërinë e viteve 1920-1944, madje deri në fundin e viteve Pesëdhjetë, saktësisht 1957-1958 nuk pati kurrë, ashtu si edhe universitete, asnjë akademi ushtarake, ndonëse në vitin 1936 ishte guxuar që të përflietj dhe ëndërrohej ngritja e një akademie ushtarake. Por ajo kishte qenë veçse një ëndërr dhe, për pasojë dhe një mision i pamundur! Me gjithë arritjet e shkollës ushtarake modeste shqiptare, me gjithë përpjekjet, ajo nuk i a doli që të ngjitej në nivelin e kërkesave të asaj kohe për të përgatitur oficerë me formim dhe kualifikimet e duhura, ushtarakë të vërtetë profesionistë. Për këto arsye, mundësia për të prekur këtë nivel, u pa dhe u gjet tek shkollat dhe akademitë ushtarake të huaja, në Evropën Perëndimore, siç është përmendur edhe më herët, në Itali, Francë, Greqi dhe ndonjë vend tjetër. Natyrisht që, midis tyre, vendin kryesor e zuri Italia fqinjë. Kjo shpjegohej për një varg motivesh e rrethanash të gjithanshme gjeopolitike, ekonomike dhe, sigurisht ushtarake, të rregulluara dhe të sistemuara me marrëveshje dypalëshe. Në të njëjtën periudhë, që përfshin vitet 1926-1943, shumë prej nxënësve ushtarakë shqiptarë që kishin përfunduar këto shkolla si dhe ushtarakë të tjerë shqiptarë, që vinin nga shkollat ushtarake të Shqipërisë, kryen studimet në akademitë ushtarake më të shquara të Italisë, por edhe në Evropë. Veçanërisht e ndjekur për ushtarakët nga Shqipëria ishte Akademia e Këmbësorisë dhe Kavalerisë në Modena, ku studiuan pjesa më e madhe e ushtarakëve shqiptarë, Akademia e Artilerisë dhe Xhenios në Torino, Akademia e Këmbësorisë në Romë. Kualifikimet pas-akademike oficerët e dalë nga këto akademi, i kryen në Shkollën e Aplikacionit të

Armës së Artilerisë dhe Xhenios, në qytetin e Torinos dhe fare pak prej tyre edhe në atë të Parmës.

Midis lindjes dhe perëndimit

Me gjithë tendencat, pamjen dhe frymën mbizotëruese lindore, në Shqipërinë e viteve të para të pas shpalljes së Pavarësisë, u vunë re prirje, ndonëse të veçuara, të kufizuara dhe të ndrydhura, për ndryshim. Në se i referohesh të dhënave arkivore dhe atyre të botuara bie në sy dhe ndihet menjëherë "era" e ndikimit të shkollës perëndimore, në tërësi, që kishte nisur të ndihej, madje qysh herët në Shqipëri. Kjo dukuri, përvijoi një prirje të re në radhët e ushtarakëve dhe të Ushtrisë Shqiptare, që synonte të krijonte kështu një traditë dhe një histori të re, gati-gati alternative, përkrah asaj mbizotëruese ekzistuese. Natyrisht, kjo qasje dualiste vinte për shkak të mungesës së plotë të traditës së shkollës ushtarake kombëtare shqiptare, e cila kishte nisur të shfaqej dhe të hidhte hapat e parë vetëm aty nga fillimi i viteve Njëzet të shekullit të shkuar. Por, me gjithë frymën mbizotëruese lindore, përmes një vështrimi të kujdesshëm historik, zbulohet se përvoja e shkollës euro-perëndimore nisi të depërtonte në Shqipëri qysh më herët, në prag të Luftës së Parë Botërore, atëherë për shkak të mungesës së një shteti ekzistent dhe planifikues, në mënyrë krejt vetjake dhe privatisht. Madje, rastet e para zënë fill qysh nga fillimi i viteve 1900.

Në historinë e arsimimit ushtarak të oficerëve shqiptarë ka edhe raste krejt të veçuara që dëshmojnë për shkollimin dhe kualifikimin e tyre edhe në disa shtete evropiane tejet të rralla dhe qysh herët. Një rast i tillë është rasti i Eqrem Bej Libohovës, i cili kishte kryer studimet në Akademinë Ushtarake të Brukselit, në Belgjikë. Një ndër këta ushtarakë ishte edhe një emër i njohur për aviacionin ushtarak turk dhe atë shqiptar. Ai ishte Avni Xhaxhuli, i lindur në vitin 1890, në Leskovik. Krejt ndryshe nga shumë bashkë-atdhetarë të tij nga Shqipëria, ai studioi në një akademi të aviacionit në Gjermani, ku u diplomua

si pilot ushtarak. Pas kësaj Avniu shkoi në Turqi, ku hyri në shërbimin e aviacionit ushtarak turk dhe piloton këtu deri në vitin 1917, kur ende vijonte Lufta e Parë Botërore. Aty nga fundi i këtij viti, në moshën njëzeteshtatëvjeçare, kthehet në atdhe, ku bëhet nismëtar dhe i kushtohet çështjes për ngritjen dhe organizimin e aviacionit ushtarak vendas. Pas vitit 1914, shkollimi i djemve shqiptarë u bë tërësisht me nismën dhe ndërmjetësinë e forcave ushtarake ndër-luftuese të Luftës së Parë Botërore të pranishëm në teatrin shqiptar të kësaj lufte. Në këtë sfond mbizotëruan dy shkolla, ajo italiane në njërin anë dhe ajo austriake në anën tjetër. Sipas të dhënave të kohës, për shkak të lidhjeve të kahershme, por edhe për shkak të afërsisë gjeografike dhe historike, vendin kryesor e zinte shkolla italiane. Më pas në kohë dhe me një numër të vogël u ndie edhe prania e shkollës ushtarake greke dhe asaj franceze. Argumentet për këto raporte bazohen në të dhënat e burimeve të kohës dhe sipas statistikave që vinë prej viteve 20-30 të shekullit të shkuar. Pas mesit të vitit 1920, në Kuvendin Kombëtar të parë të Shqipërisë, krahas të tjerave, nisën edhe diskutimet e para për krijimin e Ministrisë së Luftës. Përmes këtyre diskutimeve, të njohura ndryshe edhe si "Bisedime në Senat" u hodh ideja e parë, " ... për formimin e një ushtrie ... ", ide e cila do të konkretizohej më 27 tetor të këtij viti, me anën e një letre të Kryesisë së Këshillit të Ministrave, që i drejtohej Senatit qysh në Legjislaturën e parë, Sesioni i Parë. Tre ditë më pas, më 30 Tetor, në Senat u bë e njohur një letër e Kryeministrit, me anën e së cilës ai shpallte pëlqimin për formimin e një Ministrie Luftë. Po në këtë mbledhje pasoi një propozim i senatorit, atdhetarit dhe poetit të njohur të asaj kohe, Hil Mosit, me anën e të cilit ai shtronte nevojën e krijimit të Ushtrisë Shqiptare. Argumenti i përdorur nga senatori ishte fakti se " ... ushtria është ajo fuqi, që siguron gjallërinë e shtetit. Në diskutimet pasuese mbizotëroi mendimi pro krijimit të Ushtrisë, por në diskutimet vërehej shqetësimi i diskutantëve "misa" për krijimin e një ushtrie të "pavarshme", të "paanshme e të pandikueshme", që ajo të dilte nga kufijtë e disiplinës ushtarake dhe, njëherëshi të gëzonte një trajtim të mirë ekonomik nga ana e shtetit. Sipas senatorëve duhej marrë parasysh se " ... një oficer, për me rrejt nderin zyrtar duhet të jetë i veshur e mbathur mirë e t'i sigurohet gjendja ekonomike e tij, se për ndryshe s'mbetet nder n'ushtrie. Ushtria vlerësohej si "fuqi kombëtare", e cila nevojitej për mbrojtjen e " ... Nderit kombëtar" dhe se qeveria duhej të mbështetej " ... mbi një fuqi Kombëtare e cila është Ushtria". Për rrjedhojë u vendos që të miratohej formimi " ... i Ministrisë së Luftës mbas Këshillit dhe emërimin e Z. Ali Kolonjës si ministër". Formimi i Ministrisë së Luftës do të pasohej së afërmi nga formimi i trupës së Ushtrisë Shqiptare, tashmë me një fizionomi dhe profil të qartë ushtarak, me gjithë kufizimet. Ndërkohë që po hidheshin konturet e para të institucionit të Mbrojtjes Kombëtare, në mjedisin shqiptar zhvilloheshin debate të shumta midis drej-

tuesve të lartë ushtarakë për të formuar një ushtri të tipit dhe të formatit lindor, ku bazë ishin oficerët e shkolluar dhe të formuar në shkollën turke. Njëherëshi me këtë model ishte hedhur dhe ideja alternative, e cila po mbështetej gjithmonë e më ndjeshëm nga qarqet intelektuale dhe ushtarake, të cilët i përkisnin linjës së përparuar dhe bashkëkohore, që ishte për një ushtri të tipit perëndimor, të drejtuar prej oficerëve me arsimim dhe formim në shkollat ushtarake euro-perëndimore. Oficerë të këtij modeli në fillimin e viteve Njëzet nuk ishin të pakët në Shqipërinë e kësaj periudhe. Ata vinin kryesisht nga shkollat ushtarake austriake dhe italiane. Këtë diskutim, shpesh të ashpër alternativash, e pasqyronin disa gazeta të njohura të kohës, mes të cilave shquhej ajo me titullin "Koha". Me gjithë këto diskutime, me gjithë prirjet properëndimore të disa drejtuesve të lartë ushtarakë shqiptarë, u duk qartë se edhe në fillimet e viteve Njëzet të shekullit Njëzet, tendenca anonte nga oficerët që i përkisnin shkollës turke. Kjo tendencë përshfaqej sidomos tek oficerët e lartë, dukuri që e kishte shpjegimin tek disa argumente të padiskutueshme. Më së pari këta oficerë, në shumicë dhe sidomos ata me grada të larta vinin, për shkak të traditës, pikërisht nga shkolla turke. Së dyti, edhe prirjet dhe parapëlqimi i shumicës së drejtuesve të lartë në krye të Ministrisë së Luftës dhe të Shtabit Madhor anonin për nga oficerët e dalë pikërisht nga bangat dhe auditorët e kësaj shkolle. Nga ana tjetër Ushtria nuk mund të bënte dallim nga orientimi tradicional i shumicës së shoqërisë dhe i politikës shqiptare të fillim-viteve Njëzet, që anonin nga edukimi dhe mentaliteti lindor kryesisht turk, që e kishte mbizotëruar botën dhe shoqërinë shqiptare për qindra vite. Ndërkohë, baza reale teorike mendimore, por sidomos konceptuale, praktike njerëzore, ekonomike dhe fizike, mbizotërohej edhe në fushën ushtarake nga ato lindore-turke. Është kjo arsyeja që, me gjithë diskutimet dhe kahjen properëndimore, preferencat ishin qartazi dukshëm në favor të trupës së oficerëve me shkollim lindor. Në ndihmë të këtij argumenti flasin disa tregues shifrorë që vinë nga ato vite. Kështu, gjatë tremujorit të fundit të vitit 1920, Ministri i Luftës, gjeneral-brigade A. R. Kolonja, propozoi emrat e komandantëve të tre regjimenteve, që përbënin skemën organizative të Ushtrisë Shqiptare në krijim e sipër.

Por, me riorganizimin e Ministrisë së Luftës, kur në krye të saj erdhi një tjetër oficer i lartë dhe shumë i njohur i Ushtrisë Turke, me origjinë shqiptare, por me një formim të plotë ushtarak turk, koloneli i shtatmadhorisë Selahudin Said Shkoza, tabloja e mësipërme shfaqti ndryshime! Të paktën në plan teorik. Kjo shfaqje u duk sidomos në vizionin e qartë e tej-pamës të kolonel Shkozës, i cili jo vetëm ideoi por, për më tepër, i shkoi më tej problemit të rëndësishëm. Ai kërkoi nga Kryeministri i atëhershëm që të nënshkruheshin marrëveshje me ushtritë e vendeve evropiane, lidhur me arsimimin dhe kualifikimin e djemve dhe ushtarakëve shqiptarë në shkollat dhe akademitë

e tyre ushtarake. Pikërisht për këtë, në një shkresë dërguar Kryeministrisë, qysh në muajin Mars të vitit 1921, Ministri i Luftës i Shqipërisë, i shkruante atij institucioni se " ... për me siguruar formimin e oficerëve tonë me qëllim që të zgjeroj mësimet në shkollat ushtarake shtatmadhore si dhe ... në trupa teknike të shteteve, politika e ushtria e të cilave do të shihen të dobishme për shtetin tonë, kam nderin të lutem për me u ba marrëveshjet e duhura". Madje, në një shkresë pasuese, që i përkiste Prillit po të vitit 1921, Ministri i Luftës S. Shkoza, kërkonte nga institucioni i Kryeministrisë të jepte ndihmë dhe ndërmjetësim me qëllimin e mirë për të siguruar të dhënat e nevojshme për oficerët shqiptarë që kishin frekuentuar kurset dhe shkollat ushtarake në Itali. Ministri Shkoza kërkonte ndërkohë edhe disa të dhëna që lidheshin me datat e sakta për gradimet, emërimet dhe transferimet për aftësitë ose kapacitetet e atyre... që kanë pas gradat e nalta që mund të marrin. Por, gjithsesi, me gjithë përpjekjet progresive, edhe gjatë vitit 1921 deri më 1924 dhe, madje edhe në fillimin e vitit 1925, në radhët e Ushtrisë dhe të Xhandarmërisë Shqiptare, mbizotëronin ushtarakët e përgatitur në shkollat ushtarake turke. Më me pakicë vijuan të ishin ata që vinin nga bangat dhe auditorët e shkollave dhe akademive ushtarake të Italisë, Austrisë dhe, edhe më pak të Francës dhe Greqisë. Në muajin Janar të vitit 1925, që përkon me shpalljen e Republikës së Parë të Shqipërisë, në vend dhe në Fuqitë e Armatosura po ndodhnin ndryshime të thella. Për pasojë Ushtria Shqiptare e deri atëherëshme, si rrjedhojë e ngjarjeve të Qershorit dhe të Dhjetorit të vitit 1924 u shpërnda dhe, Ministria e Luftës gjithashtu, tashmë, në bazë të një Statusi Themeltar, që luante rolin e Kushtetutës së vendit, do t'u nënshtroheshin reformimit dhe ndryshimeve në pikëpamje të formës, që kishte të bënte me sistemin e organizimit si dhe të përmbajtjes. Për rrjedhojë, në vend të Ministrisë së Luftës u ngrit Komanda e Përgjithshme e Mbrojtjes Kombëtare me një Komandant të Përgjithshëm të saj në krye i cili, sipas Statutit ishte vetë Presidenti. Ushtria iu nënshtroa riorganizimit sipas sistemit milic. Pikërisht në kuadrin e këtij reformimi dhe riorganizimi, përtej qëllimeve politike dhe ideologjike, ndryshime të posaçme pasuan edhe në përgatitjen dhe kualifikimin e oficerëve dhe nënoficerëve në shërbim të Fuqive të Armatosura shqiptare, Kjo kërkese ishte e natyrshe pasi sistemi i ri kërkonte oficerë me kërkese sa më bashkëkohore, të përshtatshëm për një sistem të ri ushtarak. Në politikat për ri-konceptimin dhe arsimimin e ushtarakëve në shkollat e oficerëve dhe të nënoficerëve, të ngritura në Shqipëri deri atëherë dhe në të ardhmen, krahas tyre u rishikua dhe shkollimi e kualifikimi i tyre, në mënyrë të planifikuar dhe të organizuar, në shkollat dhe akademitë ushtarake të huaja. Veçanërisht në ato të fqinjit detar perëndimor, Italisë. Kjo politikë u shndërrua në përparësi sidomos pas viteve 1925 dhe 1926, kohë kur u nënshkruan dy Traktatet mes Italisë dhe Shqipërisë edhe në fushën ushtarake. Prirja u bë dominuese veçanërisht në vitin



1927 e në vijim, me ardhjen e misionit ushtarak italian pranë Ushtrisë Shqiptare të përbërë nga më se 200 vetë, i kryesuar nga koloneli i Shtatmadhorisë Alberto Pariani, njëherësh edhe atasheu i parë ushtarak në Shqipëri. Kësisoj u pranua, që krahas vijimit të veprimtarisë së shkollave ushtarake ekzistuese në vend, përsosjes së tyre dhe ngritjes së atyre të reja, të dërgoheshin vijimisht për arsimim nxënës dhe studentë shqiptarë në shkolla (kolegje) dhe akademi ushtarake në Itali. Me kalimin e viteve, në segmentin kohor 1925-1926, kur nisi dërgimi i nxënësve, studentëve dhe oficerëve të parë, deri në vitet 1940-1942, që ndoqën studimet studentët e fundit, procesi ka vijuar pandërprerë kurse numri i tyre erdhi në rritje. Në këtë rrjedhë, ndonëse në përmasa më të vogla dhe modeste në krahasim me Italinë, arsimimi dhe kualifikimi i djemve dhe oficerëve shqiptarë pati një zgjerim gjeografik edhe në Austri, Greqi dhe deri në Francë e ndonjë vend tjetër. Në këtë vijimësi, padyshim që kanë ekzistuar raporte ndryshimesh midis nxënësve, studentëve dhe oficerëve shqiptarë, që në të njëjtën kohë, ndoqën shkollat ushtarake, pa ndonjë traditë e përvojë të vendit dhe të atyre që studiuin në shkollat dhe akademitë ushtarake të huaja, kryesisht euro-perëndimore. Megjithëse në Shqipëri u ngritën disa shkolla ushtarake që, ashtu si dhe programet e tyre mësimore, erdhën në përmirësim të vazhdueshëm, niveli i tyre mbeti kryesisht i orientuar te oficerët e gradave dhe të detyrave të rangut taktik. Ndërkaq, me gjithë përpjekjet, sidomos në vitin 1936, në Shqipëri nuk qe e mundur të ngruhej një akademi ushtarake, ku të përgatiteshin oficerë të aftë dhe të formuar me dije dhe aftësi drejtuese për njësitë dhe hallkat kryesore të drejtimit të Ushtrisë Shqiptare. Për këto arsye dhe përballë nevojave në rritje të Fuqive të Armatosura, u mendua dhe u vendos që zgjidhja të gjendej përmes shkollave dhe akademive ushtarake të vendeve të huaja, kryesisht të Italisë, Austrisë, Greqisë dhe Francës.



Në shkollat dhe Akademitë Ushtarake të Italisë, në vitet 1913 deri më 1943

Bazuar në të dhëna dokumentare arkivore dhe të botuara, mund të thuhet se, pas shkollave dhe akademive ushtarake turke, në të cilat u shkolluan dhe formuan ushtarakët shqiptarë deri në vitet Njëzet të shekullit XX, vinin shkollat dhe akademitë ushtarake italiane. Kjo dukuri nisi të dalë në pah, natyrisht në përmasa të vogla, qysh aty nga vitet 1913-1914, për të fituar dimensione të mëdha sidomos pas viteve 1925-1926, duke përfshirë shumë shkolla apo kolegje dhe akademi ushtarake italiane. Sipas të dhënave arkivore dhe literaturës së botuar, nxënës dhe studentë ushtarakë shqiptarë ndoqën studimet në disa shkolla (kolegje) dhe akademi ushtarake të fqinjët të afërm italian. Më të përmendura ishin Shkolla e Trupës e Regjimentit të 10-të të Fanterisë (Këmbëtorisë), në qytetin e Barit; Shkolla e Këmbëtorisë në Modena; Kolegji ushtarak "Nunziatella" në Napoli, Akademia e Aviacionit, në Kazerta, pranë Napolit; Kolegji ose Shkolla Ushtarake në Romë; akademitë ushtarake në Romë, Modena, Torino, dhe Parma, e Detarisë Ushtarake në Livorno etj. Njëkohësisht, një numër i kufizuar oficerësh madhore ndoqën studimet në Shkollën e Luftës në Torino; në Institutin e Gjeografisë Ushtarake, në Firenze. Efekti i këtyre studimeve dhe oficerët e dalë prej dyerve të këtyre shkollave, u ndie në organizimin dhe gjithë veprimtarinë e Ushtrisë Shqiptare, veçanërisht në vitet 1925-1939. Ndërkohë, frekuentimi i shkollave dhe i akademive ushtarake të Italisë erdhi në rritje qysh pas vitit 1925. Të dhënat për të jepen nga ana e zyrtarëve ushtarakë italianë në Shqipëri, në ato vite. Kështu, sipas atasheut ushtarak italian në Tiranë, deri në vitin 1938 kishin përfunduar studimet në këto institucione arsimore ushtarake, 140 nxënës dhe studentë shqiptarë. Ndërkohë, 180 të tjerë ishin në vijim të studimeve. Në krye të "top-listës" së shkollave dhe akademive ushtarake më të ndjekura nga shqiptarët ishin padyshim Akademia e Këmbëtorisë

e Modenës, me studentë që vinin përkatësisht nga Shkolla Ushtarake e Romës, Kolegji Ushtarak i Napolit "Nunziatella" dhe i Milanos. Më tej lista vijonte me Akademinë Ushtarake të Artilerisë dhe të Xhenios në Torino dhe më pas edhe në Shkollën e Aplikacionit të armës, gjithashtu në Torino. Madje, në këtë të fundit erdhën për të vijuar studimet edhe 6 oficerët shqiptarë, të cilët kishin studiuar deri atëherë në Akademinë Ushtarake greke të Athinës.


Drejt perëndimit, vitet 1925-1943

Kolegjet (Shkollat) dhe akademitë ushtarake italiane, në Romë, Napoli, Modena, Torino, Kazerta dhe Livorno. Ashtu siç është shkruar më herët në këtë libër, përgatitja e oficerëve shqiptarë, në mënyrë të veçantë, individuale dhe privatisht, kishte nisur qysh herët, në vitet e largëta 1913, 1914 dhe 1915. Të tillë ishin edhe grupet e të rinjve nga Shqipëria që zbuluan dhe mësuan artin ushtarak në Shkollat Ushtarake të Italisë, si në Shkollën e Trupës së Regjimentit të 10-të të Këmbëtorisë të Barit dhe në Shkollën Ushtarake të Këmbëtorisë të Modenës. Por, era dhe prirjet perëndimore edhe në fushën e arsimit ushtarak shqiptar, nisi zyrtarisht dhe sipas një koncepti krejt të organizuar, pas vitit 1925, në të njëjtën kohë me reformimin e Ushtrisë dhe të Fuqive të Armatosura të Shqipërisë. Zyrtarizimi u vulos me dy Traktate Dypalëshe mes Shqipërisë dhe Italisë edhe në fushën ushtarake, në vitet 1925 dhe 1926. Me gjithë zhvillimet e paorientuara dhe të veçuara, që ndodhën në hapësirën shqiptare edhe me arsimimin ushtarak, deri aty nga vitet 1925-1926, në fillimet e vitit pasues, 1927 në arsimin ushtarak ende të pakonsoliduar dhe të brishtë të Shqipërisë, u duk sikur nisi të zbatohet një strategji më e studiuar. Sipas kësaj strategjie, krahas duhej të vijonin përpjekjet për ngritjen dhe përmirësimin e shkollës vendase, ku përgatiteshin oficerë të gradave të ulëta, aspirantë dhe nëntogerë, por ende me kufizime, që gjithsesi mbulonin numrin më të madh të oficerëve të Ushtrisë dhe të Xhandarmërisë shqiptare. Por, ndërkohë dhe krahas kësaj linje shteti shqiptar parashikoi vendosjen e një linje tjetër, atë të shkollimit të nxënësve dhe të studentëve, si dhe kualifikimin e studentëve shqiptarë, tashmë në mënyrë të organizuar, nga institucionet e shtetit nëpër shkollat dhe akademitë ushtarake të Italisë. Por jo vetëm në to, edhe në vende të tjera, pranë ose më larg. E parë në thelb, kjo strategji ishte përcaktuar për shkaqe që lidheshin me reformimin dhe me tendencat europerëndimore të shtetit shqiptar të pas vitit 1925 dhe, natyrisht, edhe të forcave të armatosura të tij, ku bënin pjesë Ushtria dhe Xhandarmëria. Intensiteti më i lartë në dërgimin e nxënësve dhe studentëve shqiptarë nëpër shkollat dhe akademitë e mësipërme, të huaja, u përshfaq veçanërisht i plotë pas vitit 1927, për t'u kulmuar në fillimin e viteve Tridhjetë të shek. XX. Në Janar të vitit 1925, Ushtria Shqiptare dhe gjithë Fuqitë e Armatosura Shqiptare, i u nënshtruan një reformimi tërësor, në pikëpamje të formës organizative dhe strukturore, ashtu dhe në përmbajtje.


Për këtë risi dëshmonin qartë sanksionimi ligjërish në Statutin Themeltar (Kushtetuta) të Shqipërisë, sipas të cilit organizimi i Fuqive të Armatosura synohet të bëhet sipas modeleve të rregullta perëndimore, bashkëkohore madje, për këtë qëllim u ofrua edhe një organizator ushtarak austriak, koloneli e më pas gjeneral-divizioni Gustav Myrdac (Gustav von Mürdatc), shndërrimi i Ushtrisë nga ajo e sistemit milic në një ushtri të rregullt të kohës. Në ndihmë të projektit të shndërrimit erdhën edhe afro 240 ushtarake (oficerë) italianë. Po kështu, nga viti 1929, në vitet 1931, 1934 dhe 1937, Forcat e Armatosura modeste shqiptare i u nënshtruan procesit të reformimit (rregullimit) sipas standardeve të asaj kohe, në organizim, stërvitje, pajisje dhe armatime. Tashmë ishte kreujt e qartë se, pavarësisht kufizimeve, synimi ishte evropianizimi i Forcave të Armatosura shqiptare me çdo kusht, që t'u jepej atyre jo vetëm një pamje, por edhe një përmbajtje sa më pranë dhe të ngjashme me ato moderne perëndimore. Tërë këto ndryshime kërkoheshin për arsyen e mungesës absolute të akademive ushtarake në Shqipërinë e viteve 20-30 të shek. XX, nga njëra anë dhe nevojave ve të ngutshme për një trupë oficerësh të formuar dhe të aftë, të pajisur me një koncept dhe aftësi profesionale për të përballuar sfidat e ndryshimeve, për të organizuar, stërvitur dhe drejtuar një ushtri të rregullt të kohës, të tipit perëndimor, nga ana tjetër. Këto arsye e nxitën shtetin shqiptar që, edhe për shkak të marrëveshjeve, t'i drejtonte sytë dhe të ngutej në dërgimin e një numri të konsiderueshëm nxënësish dhe studentësh shqiptarë në shkollat dhe në akademitë e Italisë. Për vënien në jetë të këtij plani, nxitës dhe përshpejtues u bënë edhe ushtarakët e lartë italianë që, duke nisur prej viteve 1926-1927 e në vijim, kishin nisur të vinin në Shqipëri, me detyrë për të përforcuar marrëdhëniet në fushën ushtarake, por natyrisht për të ndihmuar edhe në shndërrimin e Ushtrisë Shqiptare në një ushtri të rregullt, sipas modeleve të atyre viteve. Realizimin e këtij shndërrimi ata e shihnin më së pari tek modeli i oficerit, tek i cili u përqendruan mjaft dukshëm.

Shkollat Ushtarake të Austrisë

Një ndër vendet më të parapëlqyera nga shqiptarët për shkollime dhe studime në shkolla apo universitete të njohura dhe me emër, jo vetëm për ta, ka qenë edhe Austria. Përzgjedhja e Austrisë nga shqiptarët i ka fillimet qysh herët, ndoshta që në krye të viteve 1900, jo vetëm për shkollat e mesme dhe universitare civile, por edhe ato ushtarake. Por dokumentimi, të dhënat për ta, në mënyrë më të plotë, nisin të vinë vetëm aty nga viti 1914 dhe më pas. Ndër më të frekuentuarat kanë qenë Shkolla ushtarake në qytetet Innsbruck (Innsbruck), Grac dhe Shkolla e Kadetëve (Kadettenschule), me qendër në Vells, pranë kryeqytetit austriak, Vjenë. Në këtë përzgjedhje ka bërë pjesë edhe Akademia e Shtabit të Përgjithshëm, po në Vjenë, por atë kanë pasur fatin dhe mundësinë e rrallë ta ndjekin vetëm pak oficerë të lartë nga



Shqipëria. Megjithatë, për këta të fundit, përveç të dhënave verbale-gojore, ende nuk ka të dhëna të dokumentuara. Historia e të rinjve shqiptarë që kanë mundur të mësojnë ose të studiojnë në shkollat dhe akademitë ushtarake, mjaft të njohura për traditën dhe veçoritë e tyre. Sipas të dhënave që vinë nga burime arkivore dhe dokumenteve vendase, por dhe të huaja, mësohet se, sidomos në shkollat dhe më pak në akademitë ushtarake austriake, kanë studiuar mjaft ushtarake shqiptarë. Gjithsesi, numri i tyre i vërtetë vështirë të mësohet saktësisht ndonjëherë, më shumë për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe të evidentimit të tij tërësor, që do të mbetet sigurisht një mision i vështirë kërkues i historianëve ushtarake në të ardhmen. Kronologjia e shkollimit të oficerëve shqiptarë, individualisht dhe në mënyrë private në shkollat ushtarake të Austrisë, ka gjasa të ketë filluar më herët, por nuk dihet saktë se qysh dhe nga cili vit. Ndërsa në mënyrë më të organizuar studimet në ato shkolla kanë nisur aty nga viti 1914, në kohën e qeverisjes së Princ Wiedi-t, për të vijuar gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Në këtë kohë, përveç forcave italianë dhe atyre franceze, në "teatrin" luftarak shqiptar të kësaj lufte ishin vendosur edhe forcat ushtarake ndërluftuese austro-hungareze. Këtë hap, komanda austro-hungareze e hodhi me qëllimin për të hapur një erë të re në përgatitjen dhe krijimin e një brezi oficerësh shqiptarë të shkolluar e të formuar profesionalisht sipas koncepteve dhe standardeve evropiane, natyrisht të asaj kohe. Ky brez oficerësh do të shërbente për të hedhur bazat e trupës së kultivuar të oficerëve shqiptarë të cilët, më pas, do të duhej të organizonin, të stërvitnin dhe drejtonin Ushtrinë Kombëtare të Shqipërisë. Dhe koha nuk vonoi të provonte këtë nismë të austro-hungarezëve. Pas përfundimit të Luftës së Parë



Botërore, aty nga vitet 1918 dhe 1919-1920, shumica e këtyre djemve, tashmë të diplomuar dhe titulluar oficerë, nisën të ktheheshin në Shqipëri dhe u futën në shërbim të Ushtrisë Shqiptare. Natyrisht, në jetën dhe karrierën e tyre, ata bënë gjithçka menduan si më të mirën për ushtrinë dhe vendin e tyre, sigurisht brenda bindjeve, botëkuptimit dhe situatave, rrethanave dhe mundësive të kohës kur jetuan dhe shërbyen. Shumica e tyre kishin ndjekur mësimet apo studimet për artin dhe karrierën ushtarake pikërisht në shkollat ushtarake të njohura për traditën e tyre, si në Krems pranë Vjenës, në Innsbruck dhe në Grac të Austrisë.

Në shkollat dhe Akademitë Ushtarake të Greqisë

Nga mesi i viteve Njëzet të shekullit të shkuar shqiptarët nisën t'i drejtonin sytë edhe pranë, tek fqinj jugor, Greqia. Në këtë vend, ka qenë shumë e njohur qysh herët, Shkolla e mesme ushtarake e Selanikut, krahas asaj të Manastirit, në Maqedoni, të cilat ishin, ashtu si dhe Shqipëria, pjesë e Perandorisë Osmane. Pas kryerjes së këtyre shkollave të mesme ushtarake, të rinjtë shqiptarë, por edhe të kombësive të tjera të Ballkanit, vijonin studimet e larta ushtarake në akademitë ushtarake në Stamboll të Turqisë. Por, nga viti 1920 dhe në vijim, të rinjtë të veçuar, në mënyrë private ose edhe me grupe të vogla, të rralla, nisën t'i afroheshin edhe shkollës dhe akademive ushtarake greke, të Detarisë, asaj Ajrore ose Tokësore. Forma më të organizuara dhe përmasa disi më të mëdha këta grupe morën aty nga mesi dhe në vijim të viteve Njëzet të shek. XX. Kjo dukuri ndodhi sepse, në vitet 1925-1926, një ndër personalitetet më të njohur të politikës greke të shek. XX, me prejardhje shqiptarogreke, ish-gjenerali Teodoros Pangallos, ishte zgjedhur President i Greqisë. Pikërisht në këtë kohë dhe si

rrjedhje e nënshkrimit të marrëveshjeve të Gershorit 1926, mes shtetit grek dhe atij shqiptar, u arrit që, "... veç të tjerash, ... të dërgohen djelmosha shqiptarë në Athinë për të studiuar në shkollën e kadetëve dhe atë të marinës". Kështu shkruante në dokumentet e Arkivit personal, vëllimi i dytë, që përfshin vitet 1925-1952, vet politikani i njohur T. Pangallos. Një dërgatë e tillë ndodhte për herë të parë në historinë e marrëdhënieve greko-shqiptare, të cilat, që nga vitet 1912-1920 kishin qenë të mbushur me tensionime dhe konfrontime. Për këtë arsye kjo ngjarje përbente një risi në kuadrin e këtyre marrëdhënieve! Fakti i mësipërm konfirmohet si i tillë edhe nëpërmjet dokumentacionit arkivor dhe atij të botuar shqiptar të vitit 1925 dhe të viteve tridhjetë të shekullit të shkuar. Në to sillen të dhëna specifike që hedhin dritë mbi nxënësit dhe studentët shqiptarë, si dhe për kohën, shkollat apo akademitë që ata kanë ndjekur në Greqi, por edhe më tej. Ky fakt përcillet edhe përmes botimeve të autorëve grekë, por edhe burimeve italiane, që e përshkruajnë atë me të dhëna të përmirësuar, mbi të gjitha të bazuara në të dhëna dokumentare, të besueshme dhe, më së shumti, bindëse. Në këtë rrjedhë, qysh më datën 9 Dhjetor 1925, Legata e Greqisë në qytetin bregdetar të Durrësit, i drejtohej me një shkresë të tipit "notë verbale", Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, ku i bënte të ditur pranimin e deri pesë të rinjve shqiptarë për të ndjekur Shkollën Ushtarake "Evelpidhon" të Athinës. Në përgjigje të kësaj note, Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë kishte vënë në dijeni për këtë notë verbale Ministrinë e Brendshme, me anën e një telegrami të posaçëm që mbante datën 22 Dhjetor po të vitit 1925. Në vijim të praktikës zyrtare Ministria e Brendshme i kthente përgjigje Ministrisë së Punëve të Jashtme, një ditë më pas, po me anën e një shkrese zyrtare në zbatim të porosisë! Në atë shkresë shkruhej: "Kemi nderin t'ju njoftojmë se si mbas Telegramit Nr. 471/I Res. D.22/XII/25 për të hye në shkollën ushtarake të Greqisë janë zgjedhur këta tre studentë: Zenel Muharrem Kazazi, Filip Geci dhe Rasim Boksi. Pra në rast qi prandohen lutemi qi t'na njoftohet se kuer duhet të nisen studentët në fjalë". Por, sipas të dhënave që jep studiuesi i historisë ushtarake shqiptare, Prof. Assoc. Dr. Gjergj Titani, po në këtë periudhë kohore dhe ndoshta, në të njëjtën kohë, viti 1926, në këtë shkollë të kryeqytetit grek, Athinë kanë shkuar për studime edhe dy shqiptarë të tjerë. Ata ishin të rinjtë Dhimitër Dhespoti dhe Gaqo Mosko. Ashtu si tre djemtë nga Shqipëria, të cilët evidentohen në shkresën e Ministrisë së Brendshme Shqiptare të Dhjetorit 1925, edhe dy të tjerë që cituam më poshtë kanë studiuar në Shkollën Ushtarake të mesme "Evelpidhon", prej vitit 1926 deri në vitin 1930. Në përfundim të studimeve, më 1 Gusht të vitit 1930, të pestë të sapodiplomuarit u kthyen në atdhe dhe, sipas dokumenteve të kohës, hynë në shërbimin ushtarak të përhershëm, në përbërje të Ushtrisë Shqiptare, e cila, në ato vite kishte pësuar dhe po u nënshtruhej riorganizimeve të vazhdueshme.

Politikat e sigurisë së tre shteteve kryesore të BE-së

Analizë krahasuese e Dokumenteve të Politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë Gjermane (Weissbuch), Franceze (Livre Blanc) dhe Britanike (National Security Strategy)



“**B**ashkimi Evropian, duhet kësisoj, që të përpunojë një “Libër të Bardhë Evropian të Sigurisë e të Mbrojtjes” . . .”, do të thoshte Karl von Wogau, kryetar i Komisionit për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Parlamentin Evropian, në një artikull të tij në revistën “European Defence”. Dokumentet bazë të politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë u pritën me shumë entuziazëm në Evropë në vitin 2008. Përkrah publikimit të “National Security Strategy” (NSS) britanik në mars të vitit 2008 dhe “Livre Blanc sur la Défense et la Sécurité” francez në korrik të vitit 2008, Këshilli Evropian miratoi, në dhjetor të së njëjtit vit, raportin mbi Strategjinë e Sigurisë Evropiane, i cili u zhvil-

lua më vonë nga i ngarkuari i BE-së për politikën e jashtme Javier Solana. Nëse i hedhim një vështrim të përbashkët NSS britanike, “Livre Blanc” francez me “Strategjinë e Politikës së Sigurisë Gjermane” (Weißbuch zur Sicherheitspolitik Deutschlands und zur Zukunft der Bundeswehr 2006), në kuadrin e Politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë Evropiane (PMSE), duket qartë, që brenda dy viteve të tre vendet kryesore të BE-së i kanë ripunuar bazat konceptuale të politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së tyre. Kërkesat e ndryshme të deklaruara, për një konceptim të një strategjie në nivel evropian do të shfaqej si një konsekuencë logjike, p.sh. nëpërmjet një Dokumenti evropian (Whitebook), i cili do ta zbatonte Strategjinë e Sigurisë Evropiane në nivel



koncepti. Mund të mendohet që, një afrim i kulturave strategjike kombëtare deri në formimin e një kulture evropiane origjinale të Sigurisë, paraqet kushtin "sine-qua-non". Këtu kulturat strategjike nxjerrin në një masë të veçantë shprehinë e tyre dhe e reflektojnë gjatë implementimit, në dokumentet bazë të politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë kombëtare. Si rrjedhim, do të bëhet një krahasim i shkurtër i tre dokumenteve bazë, të Gjermanisë, Francës dhe Britanisë së Madhe, mbi të përbashkëtat dhe ndryshimet e koncepteve të tyre bazë mbi Politikën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë të secilit vend. Që në fillim, madhësia dhe procesi i zhvillimit i këtyre dokumenteve bazë shfaqin ndryshime të mëdha: dokumenti gjerman "Weissbuch" përmban 149 faqe dhe është i formuluar dhe i zhvilluar nga Ministria e Mbrojtjes gjermane, ndërkohë që dokumenti francez "Livre Blanc" përmban 342 faqe dhe është formuluar dhe zhvilluar nëpërmjet një procesi konsultativ, me përfshirjen e shumë ministrive, ushtrisë, parlamentit, akademikëve të fushave të ndryshme, ekspertëve të pavarur dhe përfaqësues të ekonomisë. Ndërsa dokumenti britanik NSS përmban 61 faqe dhe përgjegjës është, Komiteti Ndërmintor, i mbështetur dhe nga kryeministri britanik. Më poshtë do të krahasohen analizimi i kërcënimeve, vlerat, interesat dhe qëllimet e politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe përgjigjet për kërcënimet e mundshme për secilin shtet. Si rezultat do të dalin në pah të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet dokumenteve dhe konkludimet për nivelin evropian.

Analizimi i kërcënimeve

Një numër i madh sfidash dhe rreziqesh, me të cilat politika e mbrojtjes dhe sigurisë duhet të përballë, janë në plan të parë si në "Weissbuch" gjerman, në "Livre Blanc" francez ashtu dhe në "NSS" britanik.

Tek të tre dokumentet bie në sy një listë e madhe kërcënimesh, ku në "Livre Blanc" lista e kërcënimeve është më e detajuar dhe më e përmbledhur. Të tre dokumentet theksojnë, që me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe avancimin e globalizmit - si rrjedhojë edhe ndryshimi i mjedisit të Sigurisë të ditëve të sotme, - politikat e Sigurisë dhe Mbrojtjes së tyre duhet të përballen me këto kërcënime. Kështu, si kërcënim serioz ndër të tjera, perceptohet terrorizmi ndërkombëtar, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, shtetet e dobëta, konflikte rajonale si dhe krimi i organizuar transnacional. Për më tepër, si sfida kryesore shihen dhe ndryshimi klimaterik, shkatërrimi i mjedisit, varfëria, siguria e energjisë, pabarazia sociale, katastrofat natyrore, siguria e informacionit si dhe pandemi të ndryshme. Specifike për "Livre Blanc", përtej kësaj, është që i referohet shpesh "incertitude stratégique", faktit që, kërcënimet direkte janë të paparashikueshme dhe kështu në mënyrë të papritur dhe të befashuar ato mund të shfaqen. Ndërkohë që, "Weissbuch" dhe "NSS" nuk paraqesin një hierarki të kërcënimeve të identifikuara, "Livre Blanc", i trajton një pjesë të kërcënimeve të identifikuara në formë hierarkike. Megjithatë shumë qartë paraqitet, në të tre dokumentet, përputhja dhe ndërvarësia e rreziqeve dhe sfidave të ndryshme, veçanërisht përballë rritjes së mëtejshme të globalizmit. Përkrah shumë të përbashkëtatave në lidhje me sfidat dhe rreziqet e politikës së sigurisë, paraqiten dhe shumë aspekte specifike të secilit shtet: kështu p.sh. "Livre Blanc" i paraqet si kërcënime, sulmet potenciale si dhe pengmarrjet ndaj shtetasve francezë jashtë vendit, ndërsa "NSS" liston si grupime terroriste, aktivistët e IRA-s, si dhe mbrojtësit ekstremist të kafshëve. Për më tepër, Franca dhe Britania e Madhe, ndryshe nga Gjermania, i shohin disa shtete të cilat janë në rritje, si kërcënim i qartë: kështu p.sh. për-

mendet në "Livre Blanc" zhvendosja e fuqisë ekonomike dhe demografike drejt Azisë, rritja e buxhetit ushtarak të Kinës dhe Indisë si dhe varësia nga energjia ruse, ndërsa në "NSS", Kina, India dhe Rusia trajtohen në lidhje me sigurimin e energjisë. Përtej kësaj, "Livre Blanc" i referohet, në kuadrin e sfidave të politikës së sigurisë, ambicieve të Moskës prej superfuqie dhe kursit të saj ofensiv në veçanti në drejtim të vendeve kufitare. Përveç kësaj, si Franca ashtu dhe Britania e Madhe shpjegojnë faktin që, institucionet ndërkombëtare si p.sh. OKB-ja nuk janë mjaftueshëm të afta, t'i bëjnë ballë sfidave aktuale të sigurisë globale. Ndërsa në dokumentin gjerman "Weissbuch", ndryshe nga dy të tjerat, bie në sy vënia e theksit tek migrimi si sfidë e politikës së Sigurisë, ndërsa në rastin e "Livre Blanc" siguria kibernetike ose më saktë rreziqet ndaj "sulmeve kibernetike", janë parësore. Megjithatë kërcënimet e formuluar në "European Security Strategy" (ESS) e vitit 2003 kanë të shumë të përbashkëta me kërcënimet e formuluar në të tre dokumentet.

Vlerat, interesat dhe objektivat e politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë kombëtare

Dokumentet bazë, janë një indikator i mirë për të krahasuar të përbashkëtat dhe ndryshimet e vlerave, interesave dhe qëllimeve, ku shtetet duhet të orientohen për të formuluar politikat e tyre të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Këtu trajtohen gjithashtu dhe misionet, ku ushtritë e secilit shtet duhet të angazhohen si dhe qëllimet përkatëse për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar. Qëllimi themelor i politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë kombëtare është "per definitionem": ruajtja e shtetit, mbrojtja e integritetit territorial dhe mbrojtja e qytetarëve të tij. Nuk është ndonjë risi, që të tre dokumentet këtë gjë e vendosin si qëllim kryesor. Por ky fakt trivial trajtohet ndryshe tek të tre shtetet, i cili rezulton nga e kaluara koloniale e Francës dhe e Britanisë: kështu, si "NSS" dhe "Livre Blanc" thekson që, përkrah mbrojtjes së qytetarëve dhe territorit të tyre evropian duhet të mbrohen dhe qytetarët dhe territoret e tyre jashtë Evropës. Kjo ka si pasojë nga njëra anë përcaktimin e përhershëm të interesave të Sigurisë franceze dhe britanike p.sh. nëpërmjet stacionimit të përhershëm të trupave franceze dhe britanike jashtë kufijve evropianë, nga ana tjetër, ka efekt tek angazhimi i trupave të tyre si p.sh. gjatë misionit uni-lateral të trupave franceze në Bregun e Fildishtë në vitin 2002. Përtej kësaj, postulati i përbashkët i të tre shteteve, është politika Mbrojtjes dhe e Sigurisë e cila si bazë ka vlerat demokratike. Si anëtarë të bashkimit të vlerave evropiane, të tre shtetet vlerësojnë bazat demokratike dhe kërkojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetin e së drejtës në nivel ndërkombëtar. Si pasojë, të gjithë katalogët e vlerave në substancë, janë të lidhura me dokumentet bazë të sigurisë dhe mbrojtjes të secilit shtet.

Katalogu i vlerave

Gjermania: liri dhe drejtësi, demokraci, respektim të drejtave të njeriut, ruajtja e vlerave të ligjit themeltar.

Franca: bazat demokratike, liritë individuale dhe kolektive, respektim i të drejtave të njeriut, solidaritet, barazi.

Britania e Madhe: respektim i të drejtave të njeriut, shteti i së drejtës, qeverisje legjitime dhe të përgjegjshme, barazi, liri, tolerancë, shanse të barabarta.

Një aspekt tjetër i të përbashkëtave është që, të tre vendet ndihen përgjegjës për t'u angazhuar në menaxhimin e konflikteve të ndryshme ndërkombëtare, duke marrë rol drejtues. Ndërhynja ushtarake nuk përjashtohet si mundësi për zgjidhjen e konflikteve si mjet i fundit meqenëse ato pranojnë parimin e "responsibility to protect". Për shkak të vlerësimeve të ndryshme politike dhe interesave të ndryshme kombëtare ndryshe nga Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe janë më të gatshme të ndërhyjnë ushtarakisht në një vend.

Detyrat dhe objektivat e trupave ushtarake

Të tre shtetet, përkrah angazhimeve në mbrojtjen individuale dhe kolektive, theksojnë, që trupat e tyre duhet të angazhohen në spektër të gjerë në operacione multinacionale, duke filluar nga menaxhimet e krizave deri në ndërhyrjet ushtarake. Por Franca dhe Britania e Madhe, do të ndërhyjnë ushtarakisht në një vend n.q.s. do të ishte e nevojshme pa u konsultuar dhe jashtë kuadrin strukturor ndërkombëtar të OKB-së, NATO-s apo BE-së, ndërsa Dokumenti gjerman nuk e parashikon një gjë të tillë. Më tej, si Franca ashtu dhe Britania e Madhe nënvizoj-



në domosdoshmërinë për të ruajtur aftësinë e tyre nukleare për një kohë të gjatë. Në mënyrë të përmblodhur duket qartë që të tre shtetet janë afruar më shumë për sa i përket spektrit të misionëve të mundshme për ushtritë e tyre, por Franca dhe Britania e Madhe, ndryshe nga Gjermania, tregojnë një gatishmëri më të madhe për të angazhuar trupat e tyre si instrument operimi në politikën e jashtme.

Objektivat për një bashkëpunim në nivel ndërkombëtar

Një aspekt i rëndësishëm i dokumenteve bazë, janë dhe objektivat për një bashkëpunim në nivel ndërkombëtar. Këtu bëhet fjalë, nga njëra anë, për idenë se me çfarë strukturash të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes dhe me çfarë partnerësh duhet të kooperohet, dhe nga ana tjetër, cilat janë qendrat e gravitetit gjeografik të secilit shtet. Në të dy dimensionet, të tre shtetet kanë ide pak a shumë të njëjta, por secili shtet vendos qendra graviteti të ndryshme politike, të cilat kanë ndikim në bashkëpunimin e nivelit evropian. Kështu të tre dokumentet theksojnë që, shumanshmëria, e cili është dhe postulat i "ESS", është shumë e efektshme, dhe vetëm dokumenti gjerman "Weissbuch", nuk e pranon në formë eksplicite veprimin e një njëanshëm të një shteti, përveçse në rastin e masave evakuuese. Më kritike ndaj veprimit të përbashkët tregohet "NSS" britanike, e cili "preferohet" nga Britania e Madhe, por realisht nuk është më efektive. Përgjegjësia finale për të garantuar sigurinë kombëtare i mbetet qeverisë britanike, e cila në raste urgjente duhet të veprojë edhe në mënyrë të pavarur. Gatishmëria për të vepruar në mënyrë të pavarur, jashtë strukturave ndërkombëtare, e

parashikuar dhe në "Livre Blanc", të çon në ndarje të bashkëpunimit evropian, veçanërisht, n.q.s një ose shumë shtete operojnë ushtarakisht jashtë strukturave ndërkombëtare si OKB-ja, BE-ja dhe NATO, si në shembullin e Irakut, kundër vullnetit të shteteve të tjera evropiane. Rëndësi të veçantë për bashkëpunimin në nivel evropian janë mosmarrëveshjet ndërmjet Francës dhe Britanisë së Madhe për bashkëveprimet NATO-BE. Një vëmendje të veçantë ka nxitur dhe rikthimi i Francës në strukturat ushtarake të NATO-s. "Livre Blanc" thekson, mbas një diskutimi të mirë-peshuar, për një rivendosje të marrëdhënieve ndërmjet Francës dhe NATO-s, e cila kuptohet si plotësim i strukturave të Sigurisë dhe Mbrojtjes evropiane. Si qëllim i deklaruar, me rikthimin e Francës në strukturat ushtarake të NATO-s, është heqja e barrierave për zhvillimin e mëtejshëm të "Politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë Evropiane" (PMSE) dhe si qëllim afatgjatë është, arritja e një balance të re politike ndërmjet SHBA-së dhe BE-së. Përtej kësaj, duhet të ruhet roli "souveren" i Francës brenda Aleancës dhe në veçanti në sektorin nuklear. Njëkohësisht një vëmendje të veçantë i kushtohet, para së gjithash Gjermanisë, e cila bashkë me Francën, mban rolin e ndërmjetësit ndërmjet BE-së dhe NATO-s, ndërsa në "NSS" britanike, në kornizën e operimit të politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes, BE-ja shihet vetëm në korrelacion me operacionet civile ose misionet "post-conflict stabilization". Por në operacionet ushtarake trupat britanike, do të donin të operonin në kuadrin e NATO-s ose në koalicion me SHBA-në; BE-ja nuk përmendet fare në këtë pikë. Nëse do të krahasonim "ambition européenne" të Francës për një BE, si aktor i politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes, bëhet akoma më i qartë potenciali i konfliktit në këtë çështje ndërmjet Parisit dhe Londrës. *Një tablo goditëse tregohet n.q.s. krahasojmë qendrat gjeografike të gravitetit të politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së tre shteteve. Qendrat gjeografike të gravitetit:*

Gjermania: Rusia, Ukraina, Ballkani Perëndimor, Kaukazi i Jugut dhe Azia Qendrore, Lindja Afërt, e Mesme, Izraeli, Hapësira Azi-Paqësor, Japoni, Kinë, Indi, Saharaja Jugore, Afrika, Amerika e Jugut dhe Karaibet.

Franca: Aksi Oqeani Atlantik, Oqeani Indian, Saharaja Jugore, Afrika, Evropa Lindore përfshirë Ballkanin Perëndimor si dhe Rusinë, Azia

Britania e Madhe: Pakistan, Afganistan, pjesë të Afrikës, të cilat janë të prekura nga konfliktet e armatosura dhe ekstremistët në veçanti në Darfur dhe Afrika e Veriut, Lindja e Afërt përfshirë edhe Irakun, Evropa Lindore.

Kështu ndryshojnë, të paktën në nivel deklarues, interesat në lidhje me hapësirën e kufitare evropiane (Evropa Lindore, Lindja e Afërt dhe Afrika e Veriut), si dhe sub-Saharaja, Pakistani apo Afgani-stani. Kështu, Britania e Madhe i kufizon më së qarti, kufijtë e interesave të saj, ndërkohë që do-



kumenti gjerman "Weissbuch" i lë hapur qendrat e saj gjeografike të gravitetit për shkak, të numrit të madh të rajoneve dhe partnerëve, me të cilët dhe brenda së cilëve ajo është e angazhuar në fushën e politikës së sigurisë. Franca përkufizon në "Livres Blanc" pikërisht katër pika të rëndësishme, nga të cilat e para, aksi Oqeani Atlantik - Oqeani Indian, është përmbledhur shumë gjërë.

Përgjigjet mbi kërcënimet

Çdo analizë e kërcënimeve dhe nga secila vlerë, interesa apo qëllime është e varur ndarja e burimeve të hapura për të ruajtur sigurinë kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare. Qeveritë në Gjermani, Francë dhe Britaninë e Madhe trajtojnë në dokumentet e tyre bazë madhësi ndikimesh dhe kushtesh, të cilat formojnë bazën për një ri-përcaktim të burimeve të sigurisë.

Përshtatja e vazhdueshme si proces

Të tre dokumentet njëzëri theksojnë, që përshtatja me sfidat e shek. 21 është një proces i vazhdueshëm dhe ka si objektiv rritjen e vigjilencës në kuadrin e ndryshimeve të vazhdueshme të klimës politike botërore. Në "Weissbuch" gjerman bëhet fjalë për "Orientim operacional" dhe i fut operacionet me intensitet të lartë në kategorinë "trupa të reagimit të shpejtë" dhe operacionet me intensitet të mesëm apo të ulët në kategorinë "trupa stabilizuese". "Livres Blanc" francez orientohet tek misioni operacional "Intervenir" dhe parashikon për këtë 30.000 ushtarë, të cilët mund të angazhohen brenda 6 muajve dhe për një hark kohor prej një viti deri në një largësi deri në 8000 km. Ndërsa "NSS" britanik flet për "expeditionary operations", që pasojnë trupat fleksibël operacionale. Duke iu referuar pasigurisë së zhvillimeve politike të Sigurisë nëpër botë, të tre dokumentet bazë theksojnë që trupat e secilit shtet duhet të jenë gjithmonë të gatshëm në të gjithë spektrin operacional.

Koordinimi i sigurisë së brendshme dhe të jashtme

Për sa i përket koordinimit të Sigurisë së brendshme dhe të jashtme të tre shtetet mbajnë pothuajse të njëjtin qëndrim, por "NSS" në krahasim me dy të tjerat nuk e trajton shumë gjatë këtë çështje.

Siguria e jashtme dhe brendshme:

"Lidhjet ndërmjet sigurisë së jashtme dhe të brendshme po rriten çdo ditë e më shumë" (Weissbuch 2006 fq.67);

"Dallimi tradicional ndërmjet sigurisë së brendshme dhe të jashtme nuk ekziston më" (Livres Blanc 2008 fq.57);
"Dallimi ndërmjet politikës së brendshme dhe të jashtme nuk është më e dobishme në një botë, ku globalizmi mund të përkeqësojë sfidat e Sigurisë së brendshme" (National Security Strategy 2008 fq.7).

Duke pasur parasysh kërcënimet e sigurisë botërore të tre shtetet pranojnë nevojën për ridiskutim mbi parametrat dhe mekanizmat e bashkëpunimit civilo-ushtarak në kuadrin e "Politikës së Mbrojtjes dhe

Sigurisë Evropiane" (PMSE). Në thelb bëhet fjalë që, masat e efektshme të sigurisë mund të arrihen vetëm nëpërmjet koordinimit dhe kooperimit ndërmjet ministrive apo dikastereve të shteteve përkatëse, ku trupat ushtarake dhe civile duhet të shihen si komplementar apo plotësues. Kjo nuk vlen vetëm për një bashkëpunim civilo-ushtarak brenda vendit, por dhe për misionet jashtë vendit.

Përmbledhje dhe përfundime

Krahasimi i tre dokumenteve aktuale të politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë të Gjermanisë, Francës dhe Britanisë së Madhe (2006-2008) paraqet dy përfundime të ndryshme. Nëse shihet vetëm situata aktuale, paraqiten ndryshime për sa i përket analizimit të kërcënimeve, vlerave, interesave, qëllimeve dhe përgjigjeve mbi këto kërcënimet, të cilat dhe në të ardhmen mund të pengojnë bashkëpunimin ndërmjet tre shteteve. Kështu, pavarësisht të përbashkëtave në lidhje me analizimin e kërcënimeve, përsëri roli i tre superfuqive vlerësohet ndryshe dhe qendrat e gravitetit janë të vendosura ndryshe nga njëri tjetri. Gjermania këtu tregohet shumë më e tërhequr, për sa i përket përdorimit të mjeteve ushtarake. Më tej, ka ndryshime perceptuese ndërmjet Francës dhe Britanisë së Madhe, për sa i përket kuadrin multilateral të bashkëpunimit ushtarak, BE ose NATO. Nëse e zhvendosim vëmendjen në zhvillimet, të cilat kanë ndodhur tek të tre shtetet si dhe në gjithë Evropën, që prej viteve 90, në lidhje me politikën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, dallohen gjurmë të dukshme afrie. Të tre shtetet kanë lëvizur drejt njëri tjetrit. Kështu Gjermania angazhohet aktualisht me trupat e saj në misionet ushtarake dhe është e gatshme të operojë ushtarakisht në rajone të largëta si Afrikë apo Azi (Afganistan). Franca dhe Britania e Madhe e kanë afruar më afër Gjermaninë në rolin parlamentar në politikën e Mbrojtjes dhe Sigurisë evropiane. Para së gjithash, afria e dyanshme në fushën e tensionuar ndërmjet orientimit evropian dhe atlantik, e cila mori një shtytje më shumë me rikthimin e Francës në strukturat ushtarake të NATO-s, ka rëndësi të veçantë për bashkëpunimin në nivel evropian. Vitet e fundit ka pasur një rritje të afrisë së tre shteteve, nëpërmjet bashkëpunimit në misionet e përbashkëta civile dhe ushtarake në kuadrin e OKB-së, NATO-s dhe BE-së. Analizimi i dokumenteve bazë të politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë të tre shteteve, na lejon të bëjmë një interpretim, si pesimist ashtu dhe optimist, në lidhje me zhvillimin e një kulture strategjike evropiane. Dhe pse ka shumë diferencë, afria në shumë çështje të drejton drejt një dinamike pozitive. Në praktikë drejtuesit e tre shteteve edhe në nivel evropian duhet të orientohen tek të përbashkëtat, por njëkohësisht duhet të jenë edhe të vetëdijshëm për diferencat që ato kanë dhe për konfliktet e mundshme potenciale.

Përkthyer dhe përshtatur:

Kapiten Flamur Muharremi

Burimi: www.streitkraeftebasis.de

Tafil Buzi në panteonin e shqiptarizmit

Historia ka evidentuar drejtues e prijësja, kapedanë luftërash, sikurse ka njohur edhe kryetrimin Tafil Buzi, i cili udhëhoqi me sukses çetat anti-osmane në nëntë krahina shqiptare të jugut

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI
MSC. AURORA GOLEMI

Jetë në shërbim të kombit. Gjashtë vjet pavarësi në nëntë krahina jugore shqiptare

Tafil Buzi është lindur rreth vitit 1792 në fshatin Buz-Kalemaj. Prindërit e tij, Kapua dhe Shanisë lindën djalin që u bë luftëtar i njohur për kryengritjet kundër Pushtuesve në krahinat e Shqipërisë së jugut. Tafil Buzi u shqua veçanërisht si organizator i Kuvendit të Beratit në 1828 si dhe në përgatitjen e kryengritjeve anti-tanzimat të viteve 1833-1839. Ai shkroi histori me shpatë si luftëtar i ashpër, diplomat dhe politikan popullor; krijoi marrëdhënie me Muhamat Ali Kavallën e Egjiptit, por edhe politikanë grekë të kohës, si kryeministrin grek me origjinë shqiptare Jani Koletin. Për Tafil Buzin interesi i çështjes shqiptare qëndronte mbi të gjithë interesat. Veprimtaria e tij pro çështjes shqiptare bëri që të kapej dhe të internohej në vitin 1840 nga osmanët në Irak dhe në Siri, por pas dy vjetësh në 1842 atij i'u fal jeta dhe u rikthye në atdhe. Tafil Buzi udhëhoqi nismën luftarake për kryengritje të përgjithshme të përfaqësuesve të krahinave të jugut, të lidhur në një besëlidhje politiko-ushtarake në Berat. Tafil Buzi tregoi patriotizëm të kthjellët e përparimtar, dhe vizion bashkimi të rrallë e të çmuar për kohën. Shpallja që shpërndau gjatë kryengritjes së vitit 1835, ishte një nga proklamatat e para çlirimtare për vendin. Është për t'u shënuar se që në vitin 1835, ishte hera e parë kur flitej në emër të të gjithë vendit dhe jo vetëm të nëntë krahinave kryengritëse të jugut. Lufta e Tafil Buzit bëri që shqiptarët në nëntë krahina jugore për gjashtë vjet rresht (1836-1841) të fitonin vetëqeverisjen. Në verën e vitit 1836 një kryengritje e re filloi në rajonin e Vlorës. Rebelët ishin të udhëhequr përsëri nga Tafil Buzi dhe një vit më vonë në 1837 një



kryengritje e re filloi edhe në Muzeqë nën drejtimin e Alush bej Frakullës. Në gusht të vitit 1839 një kryengritje e re u zhvillua në Berat. Banorët e Beratit sulmuan ushtritë osmane dhe rrethuan kështjellën. Kryengritja u përhap në të gjitha rajonet e sanxhakut të Vlorës. Udhëheqësit e rebelëve i dërgoi një petition sultan Abdul Mexhitit dhe ku kërkohej që drejtimin administrativ si një guvernator i përgjithshëm të vendosej Ismail Pasha, që ishte nipi i Ali Pashë Tepelenës. Në fakt pas gjashtë vjetësh "pavarësie", në shtator 1839 kryengritësit pushtuan kështjellën dhe përsëri qeveria osmane shtyu aplikimin e reformave të tanzimatit në Shqipëri. Nën dritën e dokumenteve të reja, ka një ridimensionim të figurës së Tafil Buzit si udhëheqës i madh i kryengritjeve shqiptare anti-os-

mane, si veprimtar patriotik, prijës i lëvizjeve të mëdha popullore në vitet 30 të shek. XIX; por që arkivat osmane kanë informacion të bollshëm në lidhje direkte me trojet shqiptare sidomos për vitet 1833-1836 që përbëjnë edhe kulmin e kontributit të tij në lëvizjen kryengritëse. Veprimtaria e tij vijoi edhe pas vitit 1836, kur lidhja me kryengritësit ishte në distancë. Referenca kryesore për Tafil Buzin ngelet Kuvendi i Beratit i nëntorit 1828 si dhe fitorja dinjitoze në marrjen e kalasë së Beratit në vjeshtë të vitit 1834. Në gusht të vitit 1834 Tafil Buzi zbriti në Pashaliman, pasi ishte arratisur prej gjashtë vjetësh në Greqi për t'i shpëtuar përndjekjes osmane. Në vitin 1835 shqiptarët i shkëputën autoriteteve vendore osmane disa të drejta vetëqeverisëse por që nuk u njohën nga Stambolli. Në 1836 Tafil Buzi u orvat që të riorganizonte një kryengritje të re ndërsa në 1837 mori pjesë në kryengritjen e vitit 1847 dhe pas saj pranoi amnistinë dhe hyri në shërbim të shtetit osman. Rrezikshmëria e këtij shqiptari rebel duket kur Sulltanati osman zot në tre kontinente i lutet tre perandorive europiane: Austrisë, Anglisë dhe Francës, që: "mos lejoni Tafil Buzin të strehohet në perandorinë tuaj.". Tafil Buzi ka ndërruar jetë në vitin 1866 në moshën 74 vjeçare jashtë atdheut në dhe të huaj në Siri, për të cilin edhe të dhënat e publikuara janë kontradiktore. Emri i Tafil Buzit u nderua pas 170 vjetësh në 12 tetor 2013, ku banorët e Komunës Buz-Kalemaj të Tepeles u nderuan nga Presidenca. Një ndër heronjtë e kësaj treve, Tafil Buzit ju akordua "Nderi i Kombit" me motivacion "Për kontribut të shquar atdhetar, si një nga drejtuesit kryesorë të kryengritjeve anti-osmane në Shqipërinë e Jugut në vitet 1828-1847". Titulli "Nderi i Kombit" për Tafil Buzin është nderim figurës së trimërisë dhe mençurisë si dhe ngritja në pedestalin e duhur që i takon, jo vetëm si një prijës të kryengritjeve më të para mbarëshqiptare, por edhe si një pararendës të madh të vetëdijes sonë kombëtare.

Kuvendi historik i vitit 1828 në Berat.

Tafil Buzi – komandant ushtarak

Dokumente mbi përpjekjet e shqiptarëve për pavarësi "fshihen" në arkivat e fqinjëve. Kështu fondi dokumentar "Hatt-i Hümayün" ose Arkivi Osman i Kryeministritë, Stambollit, flet edhe për Beratin si një nga qendrat urbane më të rëndësishme të periudhës osmane. Në këtë fat historik gjatë kësaj periudhe, një rol vendimtar ka luajtur pozicioni i tij gjeografik si qendra kryesore e fortifikuar prapa qytetit të Aulonës. Sanxhaku osman emërtohej sanxhaku i Vlorës, qendra administrative e tij ishte Beratit. Ky është rast specifik në historinë e institucioneve dhe administrimit territorial osman, që ka lidhje jo vetëm me pozicionin gjeografik të qytetit të Beratit në raport me Vlorën si qytet me skelë, por edhe të Vlorës si çelësi i Otrantos dhe një nga pikat kryesore të planifikuara për nisjen e inkursioneve ushtarake nga Perëndimi kundër Osmanëve. Kështu qendra e sanxhakut administrativisht u zhvendos nga Vlora në Berat, e bashkë me të edhe elita drejtuese e këtij sanxhaku. Pozicioni gjeografik i Beratit, në raport me trevat e brendshme shqiptare dhe me rrugët e komunikimit e të tregtisë e rriti edhe më shumë peshën e këtij qyteti. Në dekretet e sulltanit që nise-



shin nga Stambolli për të identifikuar këtë qytet, zyrtarisht është përdorur emri "Belgradi shqiptar" ose "Arnavud Belgradi", ndërsa autoritetet lokale qytetin e identifikonin thjesht "Berat". Fakt historik është se Porta e Lartë vazhdimisht u ka bërë thirrje myslimanëve të perandorisë përfshi edhe atyre shqiptarë të rrëmbenit armët për të mbrojtur "fenë e shtetin". Duke parë trazirat dhe rebelimin shqiptar Osmanët e Mehmet Reshid pashës urdhëruan që krerët feudalë të Shqipërisë Jugore të paraqiteshin në Janinë bashkë me luftëtarët e tyre. Këtij urdhri nuk iu bind së pari Zyliftar Poda. Për këtë Zyliftari, Tafil Buzi, Ismail bej Vlora, Shahin bej Delvina etj., vendosën të thirrej një kuvend i gjerë i përfaqësuesve të krerëve shqiptarë. Në 6 deri në 8 nëntor 1828 u mbledh në Berat kuvendi i krerëve shqiptarë, që u quajt "Lidhja shqiptare". Kuvendi i zhvilloi punimet fshehtas për tre ditë nën kryesinë e Ismail bej Vlorës, Iljaz Podës, Shahin bej Delvinës si dhe krahu i fuqishëm ushtarak i Tafil Buzit. Në fakt udhëheqës politik u zgjodh Abaz bej Lushnja dhe komandanti ushtarak Tafil Buzi, që administroi me mjeshtëri Kalanë e Beratit. Kuvendi mori disa vendime të rëndësishme për qeverisjen e Shqipërisë. Vendimet e kuvendit të Beratit ishin të qarta e të prera: jo më asqer për Sulltanatin osman; të dëbohen qeveritarët osmanë; shqiptarët t'i mbrojnë vetë trojet e tyre, qoftë edhe kur të "sulmoheshin" nga grekët apo francezët siç pretendonin osmanët; Shqiptarët nuk do



TOP I VOGËL
PËRDORUR NGA TAFIL BUZI

Topi i Tafil Buzit i ekspozuar në Muzeun e Forcave të Armatosura. Në tetor 2013, Presidenti i Shqipërisë, z. Bujar Nishani, i akordoi Tafil Buzit dekoratën “Nderi i Kombit” me motivacion “Për kontribut të shquar atdhetar, si një nga drejtuesit kryesorë të kryengritjeve anti-osmane në Shqipërinë e Jugut në vitet 1828-1847

të ndihmonin më forcat osmane në qoftë se futen në luftë me kryengritësit grekë në Tërhallë, në Aegos, në Jenisher dhe në Mesollongjë; luftëtarët të mbaheshin me bukë, fishekë dhe duhan sanxhaku i Vlorës dhe i Delvinës. Më 9 nëntor 1828, të dërguar nga veziri Mehmet Reshid pasha, mbërritën në Berat, Sulejman bej Konica e Tahir Abazi nga Dragoti, që kërkuan përgjigjen e shqiptarëve ndaj thirrjes së vezirit për luftë krah osmanëve. Krerët e kuvendit i kthyen prapa duke u kumtuar se përgjigjen do t'ia jepnin vezirit me gojë në Zicë, ku do të paraqiteshin me forca luftarake. Kështu Lidhja Shqiptare hodhi poshtë çdo opsion për mbështetje të perandorisë dhe nuk mori pjesë në ekspeditat e saj. Ashpërsia arriti kulmin kur Ismail bej Vlora ra në kurthin e kurdisur dhe shkoi në Janinë, për të “marrë fermanin e emërimit të tij si qeveritar i sanxhakut të Vlorës e Beratit me gradën pashë me dy tuja”. Ndërkohë që Zyliftar (Silahtar) Iljaz bej Poda refuzonte që të “merrte fermanin për komandant të Janinës derisa të vinte aty Ismail bej Tepelena”. Faktikisht atë e priste pabesia osmane. Sulltanati bëri përpjekje që t'i bindte krerët e Jugut e bashkë me ta dhe Tafil Buzin se, “Sulltani do t'i shpërblente, në se hiqnin dorë nga vendimet e Kuvendit të Beratit”.

Në shërbim të çështjes shqiptare

Kushtet dhe rrethanat historike e poqën herët djaloshin tepelenas Tafil Buzin. Kështu në fillim të vjeshtës së

vitit 1834, në moshë tashmë të pjekur 42 vjeçare e gjeti Tafilin në fshatin e tij, në Buz-Kalemaj të Tepelenës. I kushtëzuar nga rrethanat e krijuara në gusht, gjatë përplasjes në afërsi të Tepelenës, ai kishte hequr dorë nga kryengritja masive për realizimin e së cilës kish planifikuar të grumbullonte nga Toskëria e Labëria rreth 25 deri në 30 mijë luftëtarë këmbësorë e kalorës. Tërheqja e mençur taktike për të mos sulmuar në drejtim të Janinës ishte të fitonte kohë. Rreth vetes mbante një eskortë prej 100 luftëtarë me bashkëluftëtarë, oficerë e ushtarë nga njerëzit e tij më besnikë, sa për vetëmbrojtje në kohë paqeje. Planet e luftarake përpunoheshin në Buz. Efektet e tërheqjes së Tafil Buzit do të ndiheshin më vonë në kryengritjet e mëvonshme, sepse nga njëra anë ai u njoh dhe krijoi mbështetje të plotë të njerëzit që e rrethonin, dhe nga ana tjetër, me praninë e tij këtu, inkurajoi rritjen e revoltës në zonat e influencës. Tafil Buzi nuk u “çmall” me bashkëfshatarët e bashkë-krahinorët, por njohu dhe depërtoi tek njerëzit, ndjeu nga afër shkallën e urrejtjes ndaj pushtuesit dhe vuri re gatishmërinë e tyre për të rrëmbyer armët. Në këtë periudhë Tafil Buzi filloi të shtonte gradualisht numrin e ushtarëve me pagesë, dhe nga fundi i muajit tetor në forcat e tij të gatishmërisë së përhershme numëroheshin deri në treqind luftëtarë. Shënjestra e parë e Tafil Buzit ishte Berati, qytet i cili furnizohej me karvanë mushkash të ngarkuara që e bënë rrugën një deri dy herë në javë.

Nëpërmjet këtij korridorit kalonte informacioni për çdo detaj të lëvizjeve të Portës së Lartë. Në këtë funksion realizohej kombinimi i veprimeve anti-osmane në qendër të sanxhakut të Beratit. Nga kuvendi historik i vitit 1828, Berati ishte kthyer vërtet në një qendër rezistence kundër reformave osmane që binin në kundërshtim me interesat e shqiptarëve. Gjithë rezistenca shqiptare në këtë kohë kishte si qëllim futjen e elementëve të vetëqeverisjes. Osmanët bënë vetëm miratim formal në praktikë sepse herë vononin, herë "harronin" duke zvarritur problemet, duke i deformuar e ndonjëherë duke i shkelur në mënyrë të hapur e të kamufluar të drejtat e shqiptarëve. Një eveniment që citohet edhe nga ana dokumentare është se, Mahmut Hamdi pashës, urdhëroi regjistrimin e ushtarëve të rregullt për të zëvendësuar garnizonin e kalasë që përbëhej deri në atë kohë nga ushtarë shqiptarë me pagesë. Porta e Lartë po e shtrëngonte gjithnjë e më shumë darën për zbatim të reformës ushtarake, kufizimin e të drejtave të shqiptarëve dhe kombinonte veprimet si në Berat ashtu edhe në Shkodër, Janinë e Manastir. Por të drejtat e shqiptarëve ishin fituar me luftë. Regjistrimi i ushtarëve të rregullt, shkaktoi revoltë në sanxhakun e Beratit. Osmanët futën në veprim mjeshtërinë shekullore të përçarjes, frikën si mjet për nënshtrim. Në fakt kishin vetëndezur zjarrin e kryengritjes. Kërcënimet dhe ndëshkimet e rënda në Jug nuk bënë gjë tjetër veçse i dhanë hov kryengritjes. Në krye të saj u vendos njeri nga themeluesit e Lidhjes së Beratit, Tafil Buzi, i cili kishte një mbështetje të fuqishme ndërkrainore.

Veprime energjike anti-osmane

Gjithë trevat shqiptare ishin në alarm. Krahinat shqiptare prisnin sinjalin duke qëndruar në gatishmëri. Kaq e madhe ishte gatishmëria e banorëve të krahinës, sa që një alarm i rremë i përhapur gjatë atyre ditëve, kishte grumbulluar brenda pak orëve te Hani

i Gllavës rreth 800 burra. Kjo ngjalli alarm të menjëhershëm tek autoritetet osmane të kalasë së Beratit. Gatishmëria e burrave për luftë tregonte qartë se pjesëmarrja në një kryengritje të mundshme do të ishte shumë e madhe. Në vendlindjen e Tafil Buzit përgatiteshin planet e kryengritjes. Me 300 luftëtarë Tafil Buzi mori rrugën drejt Beratit, kaloi Qafën e Gllavës, la mbrapa Çorogjafin e Rehovën, zbriti luginës dhe vazhdoi marshimin drejt qendrës së sanxhakut. Trupa kishin zbritur në brigjet e Osunit dhe kishin kapur lagjen Goricë si dhe kishin marrë urën e Beratit. Veprimet e Tafil Buzit vërtetohen në letrën që ai i shkruan pashait të Kretës: "Pleqtë e kazasë më dërguan lajm. Unë mbërrita me 300 vetë. Rrethuam kalanë e Beratit dhe brenda 24 orësh erdhën krah meje 10.000 luftëtarë..". Forcat kryengritëse u hodhën në luftime të ashpra nëpër lagjet e qytetit dhe përreth kështjellës. Kryengritësit u vunë në zotërim të magazinave shtetërore ku mbahej drithi i grumbulluar prej detyrimeve dhe i'a shpërndanë popullsisë kryengritëse. Kryengritja u shtri në të gjitha krahinat dhe u krijuan lidhje të forta bashkëpunimi ndërmjet popullsisë të krahinave. Veprimet energjike të Tafil Buzit bënë që të ngrihej ndërgjegjja politike dhe solidariteti popullor. Besëlidhjeje politike dhe ushtarake e Beratit ndonëse për nga pjesëmarrja ishte e ngjashme me atë të viteve të tjerë, për sa i përket organizimit, ngrihej në një shkallë të re më të lartë. Besëlidhje politike udhëhiqej nga një organ i vetëm që ishte pleqësia, e cila në shtypin e kohës u quajt "trup legjislativ", ku si përherë Tafil Buzi u ngarkua me drejtimin e veprimeve luftarake dhe për lidhjet me botën e jashtme e sidomos me Mehmet Kavallën e Egjiptit. Udhëheqja luftarake tashmë ishte me një përvojë si kapedan trim e i njohur, por ishte aleat me Mehmet Kavallën e Egjiptit, ku përputheshin interesat e kryengritjes kundër armikut të përbashkët. Në gatishmëri ishte edhe ndihma e flotës nga deti. Kjo e alarmoi Sulltanatin, prandaj u



bllokuan brigjet e Shqipërisë Jugore, duke dërguar disa anije luftime me synim që të parandalohet çdo orvatje ndihme nga deti prej flotës egjiptiane. Kryengritja shqiptare i kishte synimet të qarta dhe shkonte më larg nga ç'e pandehte Osmanllati. Rruga paqësore ishte rrugë kurthi. Në një letër të 9 dhjetorit 1834, që flet për kërkesat e kryengritësve, Mahmut Hamdi pasha shkruante: "Meqenëse janë bashkuar me ta disa gegë fqinjë dhe Ibrahim bej Kavaja, del se duan të zbatojnë qëllimet e fshehta, të mos japin ushtarë të rregullt e gjëra të tjera dhe të shpallin pavarësinë". Tafil Buzi përfshiu në radhët e Besëlidhjes kryengritëse edhe dy krahina të Elbasanit: Vërgjën e Sulovën. Kështu numri nga shtatë shkoi në nëntë krahina dhe ku numri i kryengritësve arriti në 25000 luftëtarë. Porta sipas interesit përdori me shqiptarët sikurse me gjithë pjesët e tjera të perandorisë "kulaçin dhe kërbaçin", "amnistinë" duke përjashtuar vetëm komandantin ushtarak, Tafil Buzin, por dhe "lëshime" të tjera ndryshe kryengritjet shtypeshin me gjak. Katër pashallarë Valiu i Rumelisë, Daut pasha i Shkodrës, Emin pasha i Thesalisë dhe Mahmut pasha i Janinës nuk mundën të gjakosnin një popull të tërë kryengritës sepse Besëlidhja shpërfilli vendimet e Portës, mbajti peng Vehip efendi Janinën, kryetarin e delegacionit të dërguar në Berat. Fermanët perandorak ishin shpërfillur nga Tafil Buzi. As forca, as dredhitë, as "marrëveshjet", as "arsyet" e stërholluara nuk mundën të përkulnin krenarinë e "të mallkuarit Tafil Buzi, kryetarit të kryengritësve". Osmanët ju drejtuan përsëri armës tradicionale të përçarjes, për të ndarë pak nga pak masën kryengritëse nga udhëheqja e saj dhe ta bindnin atë me të gjitha mjetet që të largohej nga lufta.

U vendos në veprim një makinë e tërë shtetërore për izolimin e komandantit ushtarak të kryengritjes, Tafil Buzin; kërkoheshin gjithashtu mjete për zhdukjen e tij; u falën gjithë të tjerët. Tafil Buzi nuk e kishte lënë asnjë minutë të qetë vezirin e Janinës e për rrjedhojë as vetë padishahun. Osmanët thirrën edhe një herë në ndihmë krerë me influencë si Tahir Abazi, Xhelil aga Picari, Ahmet aga Çami, Ahmet bej Zagoria, Haxhi Tahir Vlora, Laze bej Vlora, Sheh Vasjari etj. Disa prej tyre ishin detyruar të pranonin përkohësisht bindjen dhe nënshtrimin ndaj osmanëve edhe pse ishin pro kryengritjes. Synimet e Portës ishin prova për besnikërinë e secilit, "krerë besnikë", apo "krerë që hiqen si besnikë". Por prova e besnikërisë ishte "zhdukja e Tafil Buzit të mallkuar.". Shigjetat e përçarjes po e mësynin frontin e kryengritjes nga shumë drejtime, ku edhe helmi i tyre dalëngadalë filloi të jepte efekte me mosmarrëveshjet e para. Por Tafil Buzi arriti të mbajë gjallë frymën luftarake të masës kryengritëse. Ja si e përshkruan Mexhit Kokalarit: "Ata, mbasi e hëngrën sëbashku tainin (racionin) e ushqimit në mbrëmje në

lagjen Murat Çelepias, pritën sa u errësua mirë dhe pastaj filluan sulmin për të marrë kalanë. Në muret e kësaj kështjelle u vendosën nga kryengritësit me dhjetëra shkallë. Sokëllimat e luftëtarëve shqiptarë me ja-ja-të e tyre tradicionale dëgjoheshin kudo në mes të errësirës së natës. Këta zëra ngjethës u futën tmerrin mbrojtësve osmanlinj të kalasë. Me qindra e mijëra kryengritës, me rrobat karakteristike shqiptare të bardha, të ngjitur nëpër shkallët e drunjtja, u quajtën si fantazma nga ushtarët osmanë që mbronin kështjellën. Një pjesë e mirë e luftëtarëve arritën të mbështetnin këmbët e tyre sipër në bedenat e kalasë dhe u përleshën grykë për grykë me mbrojtësit osmanlinj të kështjellës. Të panumërta janë heroizmat e bijve të vegjëlisë shqiptare në këtë betejë". Në mbrojtje të kalasë së Beratit u ngrit një garnizon i ri i përbërë nga 100 ushtarë të zgjedhur, nga nëntë krahinat shqiptare të Besëlidhjes. Administrata u zëvendësua me shqiptarë kryengritës, që ishte hapi i parë i vetëqeverisjes, që historianët i mësojnë faktit



të "pavarësisë së parë". Ja çfarë shkruan vetë Tafil Buzi: "Të rrethuarit i dërgova pranë zotërinjve të tyre. Pastaj biseduam me pleqtë dhe vumë nga dhjetë njerëz për çdo kaza brenda në kala dhe nga dy vetë në derën e kalasë. Ndryshuam edhe bylykbashët e qytetit. Në fillim ishin bashkuar shtatë kaza, por unë u bëra shkak që t'u shtoheshin atyre, pas dy muajsh, edhe dy kaza. Të gjithë ashtu siç thamë më lart, u vëllazëruan". Fitorët në Berat ishin një sidë e vërtetë ndaj Sulltanatit osman dhe politikës së saj centralizuese në të gjithë perandorinë. Në ditët e para të janarit të vitit 1835 marrëveshja ishte një akt historik, ku çdo gjë bëhej me pëlqimin e popullit të Toskërisë: Skrapari, Dëshnica, Tepelena, Mallakastër, Vlora e Tomorica; Sulovë; Vërgjë. Fitorja e popullsisë kryengritëse të nëntë krahinave bëhej nën drejtimin e komandantit trim Tafil Buzin. Kjo kryengritje e fuqishme që ishte një vazhdim në rritje i lëvizjes anti-osmane, u kurorëzua me vetëqeverisjen e nëntë krahinave të Shqipërisë jugore dhe krijoi kushtet e një kryengritje të përgjithshme e mbetur në tentativë.

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT, 10 QERSHOR 1878



PRIZRENI, JEHONË NGA E SHKUARA